

**V. Probleme të
qeverisjes ekonomike.
Menaxhimi**

Hyrje

Makro dhe mikro-ekonomia

- **Makroekonomia** (nga greq. μακρύς / e madhe, e gjere, dhe οικονομία / ekonomia), ndryshe nga ajo qe quhet mikroekonomi, është një degë e ekonomisë, që ka të bëjë me performancën, strukturën dhe sjelljen e ekonomisë kombëtare apo vendore **si një e tërë**. Ajo studion indikatorë apo agregatë të tillë si:
 - GDP-ja,
 - përqindja e papunësisë apo
 - treguesit e çmimitpër të kuptuar si funksionon **ekonomia si e tërë**.
- Makroekonomistët synojnë të shpjegojnë p.sh. lidhjet midis faktorëve të tillë **si të ardhurat kombëtare, outputi, konsumi, papunësia, inflacioni, kursimi, investimet, tregtia nderkombëtare, financat ndërkombëtare, etj.**
- Në të kundërt, **mikroekonomia** fokusohet në rradhë të parë në veprimet e **agjentëve individualë**, si firmat dhe konsumatorët, dhe, mbi të gjitha, se si sjellja e tyre përcakton:
 - çmimet dhe
 - sasi të tregje të veçanta.

Makroekonomia



Pse disa vende rriten me shpejt nga ana ekonomike? Perse kemi nje fluktuacion te inflacionit? Sepse me to lidhet gjendja e makroekonomise. Ajo afekton gjithsecilin ne nje menyre apo tjetren. Ajo luan nje rol te konsiderueshem ne **sferen politike sepse ajo ndikon mbi politiken publike dhe mireqenien sociale.**




Aktualisht, ka debate te shumta mbi **recesionin**, ku GDP-ja bie pas dy trimestrave suksesive apo mbi **depressionin** ku GDP-ja bie ne menyre dramatike. Makroekonomistet merren po ashtu me ceshtje te tilla si **inflacioni, papunesia, politikat fiskale dhe monetare.**

Makroreforma përfshin:

- **Politikat ekonomike dhe sociale:** planizimin e zhvillimit me elementë të decentralizimit dhe të pjesëmarrjes, implementimin e ligjeve konkrete të lidhura me investimin, parashikimin makroekonomik dhe analizën.
- **Financat publike:** menaxhimin e buxhetit në standarde ndërkombëtare.
- **Zhvillimin e sistemit financiar:** reformimin strukturor të bankës qendrore, zhvillimin e tregut të kapitaleve, restrukturimin e bankave tregtare dhe të fondeve të kreditit.

Cikli i Biznesit



Akoma

- - Kerkesa permanente per **stabilitet makroekonomik** dhe **politika fiskale elastike**, ne sherbim te zhvillimit
- - Qendrushmeri te financave publike duke rikonsideruar:
 - pensionet,
 - kujdesin shendetesor apo
 - cilesine e shpenzimeve (financave) qeveritare
- -Zbatimin e **reformave te edukimit**, perfshire dhe ate terciar, per t'iu pergjigjur tregut te punes dhe kerkesave te tij, dhe ne menyre te vecante **per rritjen e konkurrences**. Ne kete kuader kerkon **ridimensionim edhe edukimi profesional**.

Kejnezianizmi

- **Kejnezianizmi** apo **teoria kejneziane** eshte nje teori makroekonomike e mbeshtetur ne idete e ekonomistit britanik te shekullit te 20-te John Maynard **Keynes** (1883-1946).
- Sipas saj argumentohet se **vendimmarrjet e sektorit privat ne raste te vecanta mund te cojne ne rezultate makroekonomike joeficiente** prandaj ajo si teori makroekonomike behet nje avokate e pergjigjeve te politikave aktive nga sektori publik, perfshire **veprimet e politikës monetare nga banka qendrore dhe ato te politikës fiskale nga qeveria** per te stabilizuar rezultatin apo output-in ne lidhje me ciklin e biznesit.
- Idete e tij perfshinin disa **politika ekonomike intervencioniste** gjate **Depresionit te Madh**, ndersa teoria e tij ekonomike bazohej ne **qarkullimin rrethor te parase: shpenzimet e njerit lidhen me fitimet e te tjereve, dhe kur nje individ i shpenzon te gjitha fitimet, ne fakt ai po mbeshtet fitime te tjera.** Ky cikel vazhdon dhe mbeshtet keshtu nje ekonomi qe funksionon ne menyre normale.
- Ne rastin e **Depresionit te Madh**, reaksioni normal i njerezve ishte per te ruajtur parane, gje qe nderpreu qarkullimin e saj, duke e mbajtur ekonomine ne stanjacion apo stopim. Zgjedhja ndaj kesaj shtate ishte **pompimi (“mbushja e pompes”)** qe, sipas Keynesit, ishte qe **qeveria te rriste shpenzimet, ose duke zmadhuar oferten e parase ose duke blere vete gjera ne treg.**

- Ne periudhen e **Depresionit te Madh** kjo konsiderohej si **nje zgjidhje jopopullore**, megjithate pretendohet se **shpenzimet e medha** ne mbrojtje te inicuar nga Ruzveldi (Franklin Delano Roosevelt) ndihmuan ne kurimin e ekonomise amerikane.
- Por, meqe ekonomia kejneziane ishte nje **avokate e perfshirjes se sektorit publik, ajo influenconi ne uljen e ndikimit te kapitalizmit “laissez-faire”**, qe kerkonte e propagandonte **perjashtimin e sektorit publik ne treg**.
- Besimi ishte se duke i “hequr prangat” mund te arrihej vete balancimi i tij. Partizane te ketij **kapitalizmi te tregut te lire** ka qene dhe shkolla ekonomike austriake me themelues **Friedrich von Hayek**, qe jetoi ne Angli po ne kohen e Kejnezit. Te dy ata ishin ne rivalitet publik me **mendimet e tyre te kunderta mbi rolin e shtetit ne jeten ekonomike te individeve**.
- Sidoqofte, Kejnezi kerkon ekuilibër midis nenkonsumimit dhe shpenzimeve ne ekonomi. Ai mbeshteste po ashtu **rishperndarjen e pasurise**, kur ishte e domosdoshme, madje sipas tij ka arsye pragmatike per nje shperndarje masive te pasurise. P.sh., **nese segmenteve te varfera te shoqerise u jepet nje sasi paraje, qe ata jane te prirur ta shpenzojne, por jo ta kursejne ate, atehere nje gje e tille e nxit rritjen ekonomike**.
- Nje ide tjeter qendrore ne kete teori ekonomike eshte se tendencat apo prirjet ne **nivelin makro mund te ndikojne ne menyre disproporcionale sjelljen e konsumatorit ne nivelin mikro**. Prandaj ajo shpesh quhet dhe **makroekonomi (macroeconomics)** per veshtrimin e saj makro mbi ekonomi, qe ndeshet ne te gjitha shkollat ekonomike me te rendesishme te diteve tona.


Per Hayek rigjenerimi kerkon likuidimin e investimeve te teperta dhe nje rritje ne kursimet e konsumatoreve; **per Keynes duhen reduktuar kursimet dhe rritur konsumi qe te mbahen gjalle pritshmerite e perfitimit te kompanive.**

Hayek kerkon me shume kursime, Keynes me shume shpenzime.



Mos harroni!
Nderhryrja
qeveritare – ne te
gjithe jemi
kejneziane- te
pakten
perkohesisht.

Sidomos ne kushte
krize, nderhryrja
qeveritare per
ceshtje te tilla si:



- **Likuiditeti dhe garancia e borxhit**
- **Garantimi i depozitave**
- **Rikapitalizimi i bankave/ nacionalizimi**
- **Normat e interesit**
- **Blerja e asetëve, etj**

Dy “kanale” makroekonomike te qeverisjes ne ekonomi

- Pra, teper problematik, deri diku dhe kontradiktor, eshte roli i qeverise ne ekonomi. Ajo ndikon mbi makroekonomine nepermjet dy **kanaleve te politike-berjes: politikës fiskale dhe politikës monetare.**
 - *Politika fiskale eshte “manipulimi” i shpenzimeve qeveritare dhe taksave.*
 - *Politika monetare ka te beje me sjelljen e Bankave Qendrore (ne SHBA te Rezerves Federale) ne lidhje me oferten e parase ne nivel kombetar.*
- Percaktimi dhe niveli i taksave kontrollohet nga qeveria, por te ardhurat prej tyre varen nga ndryshimi i te ardhurave familjare dhe masa e perfitimit te ndermarrjeve e korporatave, qe **qeveria nuk mund t’i kontrolloje ne teresi.**
Politika fiskale diskrecionale eshte ajo qe u referohet ndryshimeve ne taksa apo shpenzimeve qe jane rezultati i ndryshimeve te paramenduara ne politiken qeveritare.

Deficiti buxhetor eshte diferenca midis asaj qe shpenzohet (G) dhe asaj qe grumbullohet si taksa (T), ne nje periudhe te dhene:

$$\text{Deficiti buxhetor} = G - T$$

Nese G e kalon T, qeveria merr hua nga publiku per te financuar deficitin. Kjo arrihet me ane te shitjes se boneve te thesarit (Treasury bonds). Ne kete rast, nje pjese e kursimeve familjare (S) i kalon qeverise.

Kur shpenzimet qeveritare kalojne te ardhurat e mbledhura (pa perfshire parate e marra hua) kemi deficit buxhetor apo fiskal, ndryshe nga borxhi qe shpreh akumulimin e deficiteve vjetore. Deficiti fiskal per partizanet e Kejnesit shihet si pozitiv per ekonomine . Vete Kejnesi besonte se deficiti e ndihmon ekonomine per te kapercyer recesionin ekonomik. Ndersa, per partizanet e konservatorizmit fiskal, qeverite duhet ti reduktojne apo shmangin deficitet ne favor te nje politike financiare me buxhet te ballancuar.

Mbi deficitin dhe borxhin do te flasim me hollesisht pak me vone.

Mikroekonomia

- **Mikroekonomia** (nga greq. Greek: μικρό-ς / i vogel dhe οικονομία/ ekonomia) është ajo pjesë e ekonomisë që studion si individët, familjarët dhe firmat marrin vendime për të alokuar burime apo mjete monetare të kufizuara, sidomos në tregje ku shiten mallra e shërbime. Pra, mikroekonomia ekzaminon si këto vendime dhe sjellje ndikojnë në **kerkesën e ofertën, për mallrat dhe shërbimet, që përcakton çmimet dhe si këto çmime, nga ana tjetër, përcaktojnë ofertën e kerkesën për mallrat dhe shërbimet**. Ajo është në kontrast me makroekonominë që përfshin **“shumën e plotë të aktivitetit ekonomik, të lidhur me rritjen, inflacionin dhe papunesinë, dhe politikat ekonomike kombëtare përkatëse”**, dhe që tregon se kjo makroekonomi ka të bëjë me efektet e veprimeve qeveritare, si p.sh., **ndryshimi i niveleve të taksimit** mbi to.
- Aktualisht, në një pjesë të konsiderueshme teoria moderne makroekonomike është ndërtuar mbi mikrofondamente, apo supozime bazike të sjelljes ekonomike **në nivelin mikro**. Një nga qëllimet e mikroekonomisë është për të analizuar **mekanizmat e tregut** që përcaktojnë çmimet relative midis mallrave e shërbimeve dhe alokimin e burimeve të kufizuara midis përdorimit të shumta alternative.
- Mikroekonomika analizon dhe **falimentin apo deshtimin e tregut**, sidomos atje ku tregjet nuk arrijnë të prodhojnë rezultate eficiente, përfshirë dhe shqyrtimin e kushteve të nevojshme për një konkurrencë apo garë sa më perfekte dhe të drejte.

Nje parim fundamental: **Ligji i kerkeses**

Ligji i kerkeses:

Ka nje lidhje te permbysur midis cmimit (P) dhe sasise (Q)

Cmimi

P_2

P_1

Q_2

Q_1


Sasia

Ligji i kerkeses:


Kur rritet kostoja e nje malli, ai do te kerkohet me pak

Ligji i kerkeses:


Kur rritet kosotoja e nje malli, konsumatori e zevendeson ate me mallra te tjera.



Nje kurbe “elastike” per kerkesen




Nje kurbe “joeleastike” per kerkesen



Modeli i kerkese-ofertes

Ky eshte modeli i famshem ekonomik, qe pershkruan lidhjen midis bleresve dhe shitesve ne treg. Ne grafik pika e nderprerjes (P^* , Q^*) quhet **ekuilibër**.




Ekilibri kerkese-oferta ("Market Clearing")

"Market clearing" apo rregullimi (pastrimi) i tregut eshte procesi kur arrihet ne ekuliber midis ofertes dhe kerkeses –

(Kerkesa gjithsej per mallra, sherbime te sigurta, etj., qe barazon oferten gjithsej ne nje nivel ekuliber cmimi)


Marrim, p.sh., rastin e kurbes se CD-ve. Pendenca e kurbes se kerkeses ben qe kur rritet cmimi (duke levizur gjate kurbes se kerkeses), zvogelohet sasia e kerkuar. Dhe anasjelltas, pendenca e kurbes se ofertes ben qe kur rritet cmimi (duke levizur gjate kurbes se ofertes) rritet sasia e ofruar. **Pika A eshte ajo ku arrihet ekilibri nga vete tregu. Vete tregu sheshon diferencat kerkese-oferte**



Supozojme tani qe ndodh nje rritje e menjehershme e kerkeses per CD-te. Kerkesa zhvendoset nga **D** ne **D'**. Rritja ne kerkesa e ngre presionin mbi cmimin per ne P' ne piken **B**, pra cmimi fillestar P^* nuk i pergjigjet me tregut ("market clearing").




Kerkese-oferta



Zhvendosja ne kerkese: Supozojme qe po ju rriten te ardhurat. Kerkesa e juaj per nje prodhim te dhene, p.sh., nje pice do te rritet. Kjo perkthehet ne nje zhvendosje djathtas ne kurben e kerkeses nga **D** ne **D'**. **Rezultati: si cmimi P ashtu dhe sasia Q behen me te larta**

Zhvendosja ne oferte: Nje renie e cmimeve te materialeve e rrit oferten e pices, per nje cmim te dhene; pronari e sheh qe shitja e pizes jep nje perfitim me te madh, prandaj ai dhe rrit oferten e pices. Kjo perkthehet si zhvendosje djathtas ne oferten S drejt S'. **Rezultati: bie cmimi P, rritet sasia Q**



Çmimet: Fleksibël ndaj atyre të ngurtësura

Pra, sipas ekonomisteve, është tregu që vendos **ekuilibrin midis kerkese-ofertes** (ky proces është **“market clearing”**). *Sidoqofte*, supozimi që tregu i nënshtrohet këtij procesi në mënyrë të vazhduar nuk është realist. **Per një vazhdueshmeri të tillë do të kërkohej një axhustim i castit në ndryshimet e kerkese-ofertes.** Në fakt, sic dhe konstatohet, **çmimet dhe pagat shume me shpesh axhustohen teper ngadale.** Prandaj ai ka shkallezimet e veta

Pra, edhe pse modeli i balancimit të kerkese-ofertes (**“market clearing”**) presupozon që çmimet dhe pagat duhet të jenë **fleksibel**, në të vërtetë në shumicën e rasteve, ato, sidomos pagat, janë **te ngurtësuarat!...**

Kostoja

- Ne nje kuptim te zakonshem kosto shpreh vleren e dickaje te dobishme apo te perdorshme. Pra, **kosto eshte vlera monetare e perdorur (ose ekuivalente e saj) per te prodhuar nje mall apo sherbim.** Ne rastin e veprimeve te shumefishta ajo eshte shuma e kostove te vecanta (perfshire dhe transaksionet shoqeruese) qe shprehet dhe ne cmimin perfundimtar. **Ky cmim krahas kosos totale permban dhe fitimin perkates.** Kurse kosto private eshte ajo qe bleresi per nje mall apo sherbim ia paguan shitesit.
- Ne pergjithesi, **kosto** (apo **kostoja e oportunitetit**) **eshte vlera e alternatives me te mire.** Keshtu, p.sh., nje oportunitet investimi e ka koston e oportunitetit te konsideruar si alternativen me te mire. **Nje cmim nen koston e oportunitetit reflekton nje humbje te qarte ekonomike.** Nje cmim mbi koston e oportunitetit mund te terheqe perfshirje aktoresh ne tregje kompetitive.
- **Kompetiviteti apo konkurrenca tenton te fuse koston e oportunitetit brenda nje vlere apo cmimi minimal dhe maksimal.**
- **Kujdes monopolet!**

Llojet e kostove

Kostoja totale e prodhimit te nje malli te manufakturuar permban 3 lloje kostosh: kostoja e materialit te perdoruar, kostoja e punes se bere dhe kostoja FOH (Factory overhead). E para eshte kostoja e materialit te perdorur apo e komponenteve qe do te behen pjese e prodhimit (mallit) te dhene, e dyta eshte kostoja e punes qe lidhet me punen apo angazhimin e burimeve njerezore ne kryerjen e ketij prodhimi, kurse termi i trete perfshin kostot qe nuk lidhen drejtpersedrejti me materialin dhe punen, por kane te bejne terthorazi me prodhimin e tij. **E thene ndryshe, nese zbriten kostoja e materialeve te perdorura apo ajo e punes nga kostoja totale e fabrikes per nje periudhe te dhene, rezultati eshte FOH.**

Shenim: COH (**Corporate overhead**) perfshin kostot e drejtimit te kompanise dhe sektoret mbeshtetes te e saj. P.sh. i tille eshte nje aktivitet apo departament i kompanise qe nuk e manifikuron prodhimin por ofron sherbimet e tij. Pra, COH perfaqeson koston e ofrimit te sherbimit te perqendruar per sektoret e prodhimit. Shembuj te COH jane **administrata e kompanise, sherbimet qe lidhen me planifikimin, financat, shitjet, apo sherbimi ligjor dhe ai ifutjes apo mirembajtjes se teknologjise se informacionit.** Meqe keto sherbime jane jashte funksioneve te drejtperdrejta te prodhimit apo te pajisjeve te tij, ato nuk perfshihen ne FOH, prandaj kostot e ketyre sherbimeve llogariten veças FOH.

Kostoja primare = material i perdorur (drejtperdrejt) + puna e kryer (drejtperdrejt)

Kostoja e konvertimit = Puna e kryer (drejtperdrejt) + FOH

Formula e llogaritjes se kostos

**Kostoja primare = material i perdorur (drejtperdrejt) +
+puna e kryer (drejtperdrejt)**

**Kostoja e konvertimit= Puna e kryer (drejtperdrejt) +
+FOH**




**Kostoja e plote = Kostoja primare + FOH = material i
perdorur (drejtperdrejt) + puna e kryer (drejtperdrejt) +
+FOH**

Mikroekonomia në Makroekonomi

Mikroekonomia

*Mikroekonomia është ajo degë e ekonomisë që studion se si **familjet dhe firmat marrin vendimet e tyre, dhe më tej si ata bashkëveprojnë në treg.** Në mikroekonomi, sipas buxhetit të vet, një individ zgjedh apo synon maksimizimin e dobisë apo fitimit.*

Mikroekonomia përfshin implikimet e mundshme me supozimin që njeriu është një maksimizues racional i synimeve e interesave të veta.



Makroekonomia


*Makroekonomia lidhet me **bashkëveprimin e shumë njerëzve për të arritur maksimumin e mirëqenies së tyre.** Por, ama për të studiuar makroekonominë duhet të konsiderojmë vetë bazat mikroekonomike*

Mikroekonomia në Makroekonomi

Mikroekonomia

Mikroekonomia është ajo degë e ekonomisë që studion se si familjet dhe firmat marrin vendimet e tyre, dhe më tej si ata bashkëveprojnë në treg. Në mikroekonomi, sipas buxhetit të vet, një individ zgjedh apo synon maksimizimin e dobisë apo fitimit.

Mikroekonomia përfshin implikimet e mundshme me supozimin që njeriu është një maksimizues racional i synimeve e interesave të veta.



Makroekonomia

Makroekonomia lidhet me bashkëveprimin e shumë njerëzve për të arritur maksimumin e mirëqenies së tyre. Por, ama për të studiuar makroekonominë duhet të konsiderojmë vetë bazat mikroekonomike

Makroekonomia versus mikroekonomise- shembull

Ceshtje mikroekonomike	Ceshtje makroekonomike
Cfare e percakton koston e nje kursi te ri?	Cfare e percakton nivelin e pergjithshem te cmimeve ne ekonomi si nje e tere?
C' politika shteterore (qeveritare) duhet te adoptohen per ta bere te mundur studimin ne universitet te nje studenti me te ardhura te pamjaftueshme?	C' politika qeveritare duhet te adoptohen per te promovuar punesimin teresor dhe rritjen e ekonomise ne teresi?

Mikroekonomia fokusohet ne ate se si merren vendimet nga individet apo firmat dhe pasojat e tyre.- p.sh., kostoja e kursit, lehtesite e ndryshme, akomodimi, energjia elektrike, sherbime sekretarie, pagesat akademike dhe administrative, etj. Ne perputhje me to, duke krahasuar koston me perfitimet (qe mund te jene jo patjeter materiale) percaktohet dhe vendim-marrja konkrete.

Makroekonomia ekzaminon sjelljen agregate te ekonomise (pra dhe veprimet e te gjitha individeve dhe firmave ne ekonomi per te prodhuar nje nivel te vecante te performances ekonomike si nje e tere)

P.sh.,: **Niveli total i cmimeve ne ekonomi** (sa me te larte apo sa me te ulet jane ata ne krahasim me cmimet e nje viti me pare) **por jo ai nje cmimi te vecante, i nje malli apo i nje sherbimi.**

Kater tipare qe e diferencojne makroekonomine nga mikroekonomia

1. Ne makroekonomi, **sjellja e makroekonomise si e tere eshte ne fakt, me e madhe se shuma e aksioneve individuale dhe e rezultateve te tregut.**
2. Makroekonomia shihet deri diku dhe si nje **nderhyrje e vazhdueshme qeveritare** per te menaxhuar fluktuacionet e perkohshme dhe dhe t'u pergjigjet ngjarjeve problematike (p.sh., **politika monetare dhe ajo fiskale**)
3. Makroekonomia eshte rezultati, (apo dhe studimi) i nje **rritje me kohe te gjate**. P.sh.: Cilat jane faktoret qe cojne ketu? A jane politikat qeverisese te afta per fuqizimin dhe shpejtimin e kesaj rritjeje?
4. Fokusimi mbi **agregatet ekonomike** (te ardhurat kombetare, shpenzimet qeveritare dhe kerkesa agregate). Te tilla jane matjet ekonomike qe shumojne te dhenat **nepermjet tregjeve** te ndryshme per **mallrat, sherbimet, fuqine punetore, asetet konkrete**, etj.

Shenim: Kerkesa agregate (AD) eshte kerkesa totale per mallra dhe sherbime perfundimtare ne ekonomi per nje kohe te dhene dhe cmim nivel (mase hipotetike e te gjitha cmimeve per nje mori mallrash e sherbimesh ne nje rajon te dhene dhe gjate nje intervali te dhene, te normalizuara sipas nje baze te dhene). Nje cmim nivel mund te perafrohet me indeksin e cmimeve).

Disa sfida shqiptare zhvillimi

(ne kuader makro- dhe mikro-ekonomik)

- **Politike:** Demokracia parlamentare funksionon ende dobet *pergjegjshmeria dhe pergjigja ndaj nevoja lokale*
- Ekonomike:** **Probleme te qeverisjes ekonomike.**
 - Eshte arritur deri diku stabilizimi,
Transformimi strukturor nuk konsiderohet i mjaftueshem
 - **Menaxhimi makro-ekonomik**
 - **Axhustimi mikro-ekonomik dhe zhvillimi i sektorit privat**
 - o **Zhvillimi i ndermarrjeve te vogla, krijimi i shtreses se mesme**
- Probleme:** Varferia dhe zhvillimi njerezor - **Rritja ekonomike e ka theksuar pabarazine, diferencen midis zonave urbane dhe atyre rurale.**
- **Anetaresimi ne BE dhe menaxhimi publik:** Nevoja per nje politike evropiane (jopartiake, nepotike, etj.) dhe reforma ne sistemin publik, sidomos ne sherbimin mjekesor, sigurimin shendetesor e ate social, dhe kerkesa per nje konkretizim te metejshe ne fushen e pensioneve.
 - Adoptim ne vazhdimesi te legjislacionit te BE-se**
 - Reforma ne sektorin publik**
 - Decentralizim, pjesemarrje qytetare dhe qeverisje vendore**

**Nje sfide shqiptare eshte dhe
struktura ekonomike ende e dobet.
Bujqesia ze akoma 23% te GDP-se**

	B u j q e s i a perqindje GDP (%)	Bujqesia p e r q i n d j a buxhetit (%)	S h p e n z i m e n t bujqesia si perqindje e GDP
Shqiperia	23	1.8	0.5
Maqedonia	12	1.7	0.6
Serbia	11	2-3	0.9-1.5
Polonia	3	8	3.5
Turqia	12	6	1.1
Azerbaixhani	18	6	3.1
Moldova	25	3	0.9
Nikaragua	30	8	3.5
Armenia	35	9	1.2
Republika e Kyrgistanit	47	7	1.8

V.1. Qeverisja ekonomike

Ç' kerkohet te dihet nga qytetaret?

- **Ne lidhje me qeverisjen :** Qytetari duhet te jete i informuar, pjesemarrës apo te luaje rolin e tij ne shoqeri ne menyre te rregullt, pra dhe te garantoje keshtu vete zhvillimin demokratik. Ai duhet te jete, pra, me pjesemarrjen e tij te drejtperdrejte apo te terhorte pjese bazike e ndertimit te qeverisjes.
- **Ne lidhje me çeshtje te jashtme:** Qytetari ka nevojë per nje perspektive historike per te kuptuar filozofite dhe konceptet qe percaktojne rrjedhjet kryesore te ngjarjeve, perfshire dhe ato qe ndodhin neper bote. Sot, edhe ne ndertimin e nje baze te shendetshme ne te kuptuarit e zhvillimeve boterore brenda nje perspektive globale.
- **Ne lidhje me ekonomine:** Qytetari ka nevojë te kuptoje rendesine e ekonomise dhe rolin e saj ne zhvillimin shoqeror, qe nga prodhimi i te mirave deri ne shperndarjen e burimeve. Te ndjeke, zbatoje apo kuptoje parimet ekonomike qe furnizojne nje strukture nepermejt se ciles arrihet qe **sistemi ekonomik te jape rezultate ne nje mjedis gjithmone e global.**

Cfare eshte qeverisja ekonomike

- **Ajo kombinon filozofinë, vizionin dhe “arkitekturën” e politikë-bërjes ekonomike me institucionet, ligjet, regullat, makinerinë dhe praktikat që i japin formë zhvillimit të ekonomisë.**
- **Çfarë është qeverisja ekonomike?**
Pra, një sistem referimi legal, institucional – strukturor për të mbështetur aktivitetin ekonomik dhe transaksionet ekonomike me anë të mbrojtjes së të drejtave të pronës, njohjes dhe fuqizimit të kontratave dhe marrjes së veprimeve kolektive për të përmirësuar infrastrukturën fizike dhe organizative.

Qeverisja ekonomike- disa faktorë me ndikim

- Disa faktorë ekonomikë që ndikojnë:
 - **Përmasa e vendit**, që matet si nga **shtrirja territoriale** ashtu dhe **popullsia** që ndodhet aty. “Matja” e tyre është **gjeografike** dhe **ekonomike**.
 - **Burimet natyrore**
 - **Niveli i pasurisë së arritur** (zhvillimi ekonomik nënkupton aftësi dhe kapacitete për të transformuar burimet natyrore **në mallra e shërbime të përpunuara**). Këtu vlen, në mënyrë të veçantë:
 - **Ndarja e punës**
 - **Progresi teknologjik**
 - **Faktorë të tjerë** (edukimi i popullsisë, niveli i lidershipit, shëndeti, mjedisi, etj.)

Si vendimet politike përcaktojnë vendim-marrjen ekonomike?

Ushtrimi i fuqisë (pushtetit) shfaqet në:


- Politikat e taksimit
- Mënyrën e shpenzimeve, përfshirë dhe **subvencionet**
- **Rregullat e sjelljes së biznesit (pagat, lejet, masat e ndryshme, etj.)**
- Politikat e emetimit dhe vlerësimit të monedhës
- Përcaktimin e përqindjeve (normave) të interesave, yield-i i boneve të thesarit, etj.
- Marrëveshjet ekonomike me vendet e tjera
- Politikat e hyrjes dhe daljes së njerëzve dhe mallrave, kapitaleve dhe monedhave të tjera. Kontrolli doganor, etj.

Nderhyrje per:

- **Politikat e pagave minimale dhe të pensioneve**

Nje shembull: “Trajektorja” e ekonomisë – me reforma ekstensive apo pa reforma madhore (Kurba e reformës e tipit “j”)

Performanca





Orientime

- Makro-stabiliteti mbetet çelësi kryesor
- Qeverisje e mirë politike&ekonomike

(Qeverisja e mirë ekonomike mbulon sektorin publik dhe privat)



Parime bazë

- Pjesëmarrja, demokratizimi dhe transparencia
 - Mbështetja tek ligji dhe zbatimi i tij
- Promovimi i barazisë dhe i ekuitetit (përfshirë barazinë gjinore)
 - Promovimi i sintetizimit të perspektivave të ndryshme
 - Shfrytëzimi me nikoqirllëk, me aftësi dhe zhvillimi i burimeve, por dhe i metodologjisë demokratike të qeverisjes
 - Funksionimi i një shërbimi publik efektiv
- Nje strukturim e rekrutim që vë në plan të parë meritokracine e aftësimin, ndihmen dhe jo kontrollin
- Zhvillimi dhe mbështetja e një mjedisi ekonomik për rritjen dhe progresin social
 - Orientimi drejt një zhvillimi të qendrueshëm

GDP-ja

- Një tregues i dorës së parë në rritjen ekonomike është **GDP-ja (Gross Domestic Product)** apo ne shqip **PBB-ja (Prodhimi i Brendshëm Bruto)**. Ajo përcaktohet si **vlerë e rezultatit (output-it)** të mallrave dhe shërbimeve, gjatë një viti. Megjithatë, GDP-ja nuk arrin të na tregojë plotësisht nëse mallrat dhe shërbimet e krijuara gjatë një viti janë, p.sh., një **pasqyrim i zgjerimit real të pasurisë kombëtare**. Kështu, nëse qeveria i futet ndërtimit të një piramide (që, në thelb, **nuk i shton asgjë mirëqenies së qytetarit**), ajo, megjithatë, në kuadër të GDP-së, e sheh këtë piramidë si pjesë të rritjes ekonomike. Ndërkohë, ndërtimi i kësaj piramide mund të zhvendos fonde reale nga aktivitete bazë të gjenerimit të pasurisë, pra dhe duke prekur prodhimin e saj. E njëjta vlen dhe **për mirëqenien e popullit** (të matur nga të ardhurat kombëtare). **Pra, duhet të konsiderohet ndryshimi midis sasisë e cilësisë së rritjes, midis kostove e kthimeve, midis ndryshimeve kohë shkurtër e atyre kohë gjatë, apo, në përgjithësi, midis ndryshimeve “hardware” e “software” ...**
- Për ilustrim, le të marrim shembullin e sugjeruar nga një ekonomist me emër. Ky i fundit merr në analizë rastin (më tepër “imagjinar”) të një ishulli, në zonën e Karaibeve. Një ishull i tillë është një vend fantastik për të jetuar, ka një klimë tropikale, plazhe rëre dhe, mbi të gjitha, një GDP të vlerësuar me disa mijëra miliardë dollarë. Pra, apriori, ky ishull është ndër vendet e mira për t’u jetuar. Por, nga pikëpamja e të dhënave, situata vlerësohet ndryshe nëse në këtë ishull banojnë dy njerëz: njëri- ndër të pasurit në botë dhe tjetri- praktikisht një skllav. Me këto të “dhëna”, në fakt, ky vend nuk duket më aq i mirë: **shkalla e papunësisë është 50%, vdekshmëria 50%, etj. Edhe pse shembulli i mësipërm është një rast ekstrem, ama, ai manifeston një nga “shqetësimet” e vetë GDP-ja, kur matet mirëqenia brenda një vendi...**

Çfarë shpreh GPD-ja

- Në fakt, kur u “sajua” GDP-ja, ajo nënkuptonte thjesht matjen apo masën e prodhimit të brendshëm dhe asgjë më shumë. Por, sot ajo, përfshirë **GDP-në për frymë**, shfrytëzohet dhe si mënyrë për të përcaktuar se cili vend jeton më mirë. Ndërkohë, ka dhe një mori gjërash, që duhen marrë në konsideratë kur përcaktohet një **standard jetese** (apo dhe radhitja e një vendi). Parë në një dritë “sociologjike-filozofike” **paraja nuk është, pra, gjithçka**. Bile, vetë **GDP-ja mat (në njëfarë niveli) rritjen ekonomike**, por jo patjetër **gjithçka të lidhur me të**.
- Ndërkohë, që pranohet se sipas “metodës së shpenzimeve” kemi:
 $GDP = konsum(C) + investim(I) + shpenzimet qeveritare(G) + [eksporte(X) - importe(M)]$.
- Ajo, në shkurtimin simbolik, ka pamjen:
 $GDP = C + I + G + (X-M)...$

Equilibrium

- Po ta shprehim me thjeshte:


$$Y = C + I + X - M$$

- Ky ekuacion tregon e se e **ardhura e pergjithshme e vendit Y** duhet te jete e barabarte me shumen C te konsumit privat dhe publik (qe me siper **shprehej me nje pjese te G-se**) plus nivelin e investimeve Y si private ashtu dhe publike (**me pjesen tjeter te G-se**) dhe balancimin tregtar X-M.
- Pas nje transformimi te thjeshte ekucioni i mesiperm rishkruhet ne trajten:

$$Y - (C+I) = X - M$$

- Ky ekuacion tregon se diferenca midis **konsumit te huaj (X-M)** duhet te jete e barabarte me diferencon **midis te ardhures se plote Y** dhe **absorbimit te brendshem (C+I)**.
- Nese te dy anet e ekuacionit nuk jane te barabarta, ekonomia nuk konsiderohet ne pozite ekuilibri.

Rritja e GDP-së (EBRD, jan. 2010)



GDP-ja per fryme ne vendet e BP

Vendi	Poz.	FMN	Poz.	BB	Poz.	CIA	Viti
Shqipëria	94	6797	85	6385	103	6400	2008
Bosnja	91	7618	76	7468	102	6600	2006
Kroacia	52	16474	40	15516	56	16900	2008
Kosova	-	-	-	-	156	1800	2007
Mali i Zi	-	-	63	10225	80	10600	2008
Maqedonia	80	9128	68	8543	85	9200	2008
Serbia	73	10911	62	10393	94	8200	2008

Procesi i anëtarësimit në BE ndërlihdh në mënyrë të thellë reformimin politik e demokratizimin institucional (ku një vend parësor ka institucioni i votës së lirë dhe të ndershme), zhvillimin social, arsimor e kulturor e progresin ekonomik, liritë dhe të drejtat e njeriut, sigurinë njerëzore e mjedisore, etj. Pra, si i tillë ai bëhet shumë më i prekshëm dhe dobishëm për vetë qytetarin e qeverisjen e tij. Në kushtet aktuale dhe në vazhdim, nën ndikimin e krizës globale, të pasojave të saja (ndoshta, dhe disa vjeçare), duket e vështirë që procesi i ardhshëm i integritimit apo, më saktë, vendimmarrja kolektive ndaj një zgjerimi të mëtejshëm të mund të arrijë që të vërë në plan të parë aspektin politik përkundrejt atij ekonomik, për ta përsheptuar këtë proces. Bile, përkundrazi! Por ky aspekti i fundit, sipas ritmeve konkrete të një progresi ekonomik të pranueshëm, e mundëson anëtarësimin për Shqipërinë në mos paralel pak më vonë se të gjitha vendet e mbetura të Ballkanit Perëndimor me përjashtim të Kosovës .

Ky është realiteti ekonomik dhe i pazbukuruar i gjërave. Ai pasqyron, në një mënyrë apo tjetër, jashtë çdo propagande elektorale e çdo retorike euforike politike, mundësinë ekonomike konkrete të anëtarësimit. Pse jo dhe kërkesa të reja në rritje, pengesa shtesë që mund të vijnë si pasojë e procesit të diferencimit brenda BE-së apo e ndikimeve më të thella të krizës globale...

Por po aq i rëndësishëm mbetet për qytetarin dhe vetë reformimi i sistemit politik, thellimi i procesit të demokratizimit, me ritmin e përmirësimit të cilit lidhet po aq ngushtë dhe vetë anëtarësimi i vendit në BE.

GDP-ja per fryme. Koeficienti Xhini (Gini)

GDP-ja eshte vlera perfundimtare e te gjitha mallrave dhe e sherbimeve te prodhuara ne vend brenda nje vit.

GDP-ja per fryme jep pjesen mesatare te ekonomise, produktivitetin ekonomik per person, nese do te punonte cdo individ i vetem (nga femija e sapo lindur deri tek me i moshuari). Natyrisht, kjo nuk mund te ndodhe, por dhe vete pagat (pagesat) nuk jane (as nuk mund te jene) kurre te barabarta. Megjithate, disa vende e kane kete diference me te ngushte se te tjerat. Per kete vlen dhe koeficienti Xhini (Gini).

Verejtje: Koeficienti Xhini(Gini), kur e ka vleren 0, nenkupton barazine totale (nje ndarje te njejte te pasurise tek cdo individ ne vend), ndersa vlera 1 shpreh pabarazine e plote (nje person zoteron te gjitha pasurine e vendit). Disa vlera te ketij, koeficienti, ne fillim te ketij mijejvecari, per disa vende jane p.sh.:

Meksika: 0.491, Rusia : 0.434, SHBA: 0.368, Estonia : 0.361, Mbreteria e Bashkuar: 0.345, Spanja: 0.340, Greqia: 0.338, Italia: 0.333, Irlanda : 0.323, Kanadaja : 0.302, Zvicra: 0.280, Belgjika: 0.277, Gjermania: 0.264, Austria : 0.260, Luksemburgu : 0.260, Suedia: 0.252, Norvegjia: 0.251, Finlanda : 0.247.

Produktiviteti real.

Produktiviteti per punetor per ore

- Nje “mesatare” me e sakte e te ardhurave ne nje vend mund te merret duke pjesetuar GDP-ne per fryme me perqindjen e punesimit. P.sh., ne vitin 2005, Danimarka ka nje GDP per fryme (PPP) ne dollare: US\$ 34,740. E pjesetuar me perqindjen prej 75.9% te njerezve te punesuar, cdo njeri prej tyre do te prodhonte ne mesatare nje shume prej US\$ 46,381. Nese marrim tani Belgjiken me nje punesim te rendit 61.1% do te gjejme vleren: $31,244 / 61.1 \times 100 = \text{US\$ } 51,135$. Kjo do te thote se produktiviteti per punetor eshte me i larte ne Belgjike se sa ne Danimarke, edhe pse Danimarka e ka GDP-ne per fryme me te larte.
- Nese e pjesetojme kete te fundit me numrin mesatar te oreve te punes, merret produktiviteti per punetor per ore. Nje rruge tjetere per ta llogaritur ate do te ishte GDP(PPP) per fryme per ore e pjesetuar me perqindjen e punesimit.
- P.sh., nga te dhenat, ajo qe prodhohet per ore dhe per punetor, sipas vendeve te ndryshme rezulton:
Luksemburgu: 57.5 ,France : 56.6, Belgjika: 55.9, Irlanda : 51.8, Italia: 50.3, Austria : 46.4, Gjermania: 45.0, Hollanda: 44.5, Suedia: 42.6, Finlanda : 42.6, Mbreteria e Bashkuar: 42.0, Danimarka : 40.4, Malta : 35.7, Spanja: 34.2, Estonia : 34.0, Greqia: 33.1, Sllovenia : 30.7, Sllovakia : 27.8, Qipro: 27.3, Portugalia : 25.6, Letonia: 23.9, Hungaria: 23.1, Polonia: 22.4, Lituania : 21.5, Rep. Ceke: 18.6, Bullgaria : 17.8, Rumania : 10.0

Po ashtu, Islanda : 29.4, Norvegjia: 53.0, Zvicra: 35.6, Turqia: 28.5, Japonia: 37.3, SHBA: 49.6


	Euro*	Monedha kombëtare
Belgium	1 259	1259
Bulgaria	92	180
Czech Republic	288	8 000
Estonia	230	3 600
Greece**	668	668
Spain	666	666
France	1 254	1 254
Ireland	1 403	1 403
Latvia	172	120
Lithuania	174	600
Luxembourg	1 570	1 570
Hungary	258	65 500
Malta	585	251
Netherlands	1 301	1 301
Poland	246	936
Portugal	470	470
Romania	114	390
Slovenia	522	522
Slovakia	217	7 600
United Kingdom	1 361	916
Turkey	298	563
USA	676	893

Paga minimale statutore ne janar 2007

Nje page minimale eshte ajo me e ulte ne ore (por dhe ditore e mujore) qe i lejohet punedhenesit ne pagimin e punemarresit. Ndryshe, mund te themi se kjo **eshte pagesa me ulet qe punonjesi mund te shese punen e tij**. Per here te pare, ligji i pages minimale eshte zbatuar ne Australi dhe Zelanden e Re nga fundi i shekullit te 19-te. Aktualisht, ndeshet nje legjislacion i tille ne me shume se 90% e vendeve. Po ashtu, ky ligj i pages minimale varion nga vendi ne vend, jo vetem **per pagesen** (p.sh., dy vite me pare: \$6.55 per ore ne ligjin federal apo \$8.55 ne shtetin e Vashingtonit, apo £5.80 per ata me moshe mbi 22 vjec ne Britanine e Madhe), por dhe ne terma te periudhes se pageses (p.sh., **mujore** ne Kine, Rusi, Shqiperi, etj.) apo qellimin e mbulimit.

Obama desheron te arrije ne pagen minimale federale \$9.50 ne ore ne vitin 2011, nisur nga ajo \$7.25 ne vitin 2009

Paga minimale federale (SHBA)- 2009



**Paga minimale ne janar ne BE (20 vende ne 27)-
(Statutory agreed minimum wages).**













Vendi (Euro)	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008 (1)
Belgjika	1,118	1,163	1,163	1,186	1,210	1,234	1,259	1,336 (1)
Bullgaria	44	51	56	61	77	82	92	112
Estonia	.	118	138	159	172	192	230	278
Franca	1,083	1,126	1,154	1,173	1,197	1,218	1,254	1,321 (1)
Greqia	544	552	605	605	668	668	668	681
Irlanda	945	1,009	1,073	1,073	1,183	1,293	1,403	1,462
Letonia	.	107	116	121	116	129	172	228
Lituania	120	120	125	125	145	159	174	232
Luksemburgu	1,259	1,290	1,369	1,403	1,467	1,503	1,570	1,610 (1)
Malta	.	552	534	542	557	580	585	612
Hollanda	1,154	1,207	1,249	1,265	1,265	1,273	1,301	1,357 (1)
Polonia	196	212	201	177	205	234	246	334
Portugalia	390	406	416	426	437	450	470	397
Romania	.	62	73	69	72	90	114	137
Sllovakia	.	114	133	148	167	183	217	267
Sllovenia	.	.	451	471	490	512	522	567 (1)
Spanja	433	516	526	537	599	631	666	700
Rep. Çeke	.	.	199	207	235	261	288	329
Hungaria	.	202	212	189	232	247	258	285
Mbreteria e Bashkuar	1,130	1,118	1,106	1,083	1,197	1,269	1,361	1,148

. =
Vlere
e panjohur
apo e
paperfshire

(1) Ne
korrik

Burimi:
Eurostat
Online-
database.

Europa 1

Shtete (51)	Paga minimale
 Shqiperia	16,000 lek
 Andora	897.87 euro
 Armenia	n/d
 Austria	1,000.00 euro
 Azebajxhani	n/d
 Bjellorusia	229,000 rubla bjelloruse
 Belgjika	1,387.49 euro
 Bosnja-Hercegovina	n/d
 Bullgaria	240 leva
 Kroacia	2,747 kuna
 Qipro	789.00 euro
 Republika Çeke	8,000 korona
 Danimarka	?
 Estonia	4,350 kruna
 Finlanda	n/d
 Franca	1,321.02 euro
 Gjeorgjia	n/d

Europa- 2

 Gjermania	n/d
 Greqia	740.00 euro
 Hungaria	71,500 forinta
 Islanda	n/d
 Irlanda	1,499.33 euro
 Italia	n/d
 Kazakistani	n/d
 Kosova	n/d
 Letonia	180 lats
 Lihtenshtajni	n/d
 Lituania	800 litai
 Luksemburgu	1,641.00 euro
 Maqedonia	n/d
 Malta	634.75 euro
 Moldavia	766.1 lei
 Monako	n/d
 Mali i Zi	55.00 euro

Janar 2011

- **Paga minimale kombëtare** aplikohet për të gjithë punonjësit ose tek pjesa më e madhe e tyre. Ajo **zakonisht është bruto** d.m.th. **para heqjes së taksës së të ardhurave dhe kontributeve të sigurimeve shoqerore**. Vecse këto reduktime variojnë nga vendi në vend. Po ashtu, paga minimale kombëtare ose **detyrohet me ligj**, shpesh në konsultim me partnerët socialë ose me **marrëveshje të drejtpërdrejtë** ndërsektoriale (si në Belgjikë, Greqi, etj.) .
- Ne janar 2011, 20 vendet anëtare të BE-së (**Belgjika, Bullgaria, Republika Çeke, Estonia, Irlanda, Greqia, Spanja, Franca, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Hungaria, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovenia, Sllovakia, dhe Mbretëria e Bashkuar**) dhe 2 vende kandidatë (**Kroacia, Turqia**) kanë legjislacionet e tyre, **me pagë minimale me statut apo me marrëveshje ndërsektoriale**. **Gjermania, Qipro dhe Maqedonia** kanë **paga statutore minimale që nuk aplikohen për të gjithë** apo tek pjesa më e madhe e punonjësve, por vetëm për grupe specifike, p.sh. me sektorë apo profesione. Prandaj ato përjashtohen nga koleksionimi i të dhënave.

- Të përjashtuar janë dhe vende që nuk kanë pagë të tillë minimale statutore në nivel kombëtar si: **Danimarka, Italia, Austria, Finlanda, Suedia, Islanda, Norvegjia dhe Zvicra**. Në këto vende, pagat ose përcaktohen me **marrëveshje midis partnerëve socialë** në nivel kompanie apo në nivel të kontratave individuale. Në mënyrë tipike, marrëveshjet në nivel sektorial janë aplikuar gjerësisht dhe kanë aplikim **erga omnes** (**si të detyrime apo të drejta për të gjithë**), duke krijuar kështu **de facto** pagat minimale. Shtojmë se pagat minimale mujore variojnë nga vlera 123 euro në Bullgari në 1758 euro në Luksemburgu. Duke i axhustuar ato sipas fuqisë blerëse (mallrave e shërbimeve), diferencat e vendeve anëtare të BE-së reduktohen kështu në raportin nga 1 në 14 në euro, në raportin nga 1 në 6 sipas fuqisë blerëse standarde (**Purchasing Power Standard - PPS**). Kështu, duke marrë skajet e kësaj shkalle të re kemi: Luksemburgun (1452 PPS per muaj) dhe Bullgaria (233 PPS).

Politika fiskale dhe monetare

■ Politika fiskale (buxhetore)

Institucioni përgjegjës- në Shqipëri: **Qeveria (Ministria e Financave)**

- Ndryshim në taksa
- Ndryshim në shpenzime (**ulja e shpenzimeve qeveritare**)
- Buxheti miratohet në parlament (**Ne Shqiperi, hedhja poshte e buxhetit ne kuvend nuk shoqërohet me dorëheqje qeverie!**)
- Deficiti dhe suficiti (buxhetor)
- Deficiti tregtar.

Reduktimi i borxhit, huazimi nga publiku, etj.

■ Politika monetare

- P.sh., në SHBA: **Rezerva Federale** (Federal Reserve System apo FED); në Shqipëri: **Banka e Shqipërisë**

Politika fiskale

- **Politika fiskale.**

Ndikon ne nivelin e aktivitetit ekonomik nepermjet administrimit te te ardhurave dhe shpenzimeve, (lidhur dhe me kerkesen kejneziane te politikave te menaxhimit). Ketu perfshihen **regjimi i taksave**, qe ndikon mbi konsumin (**C - consumption**) dhe investimin (**I-investment**) dhe shpenzimet qeveritare (**G- Government Spending**). Po ashtu, ajo lidhet dhe me **objektiva jo ekonomike**, duke furnizuar nje sistem referimi per politika te tilla si edukimi dhe shendeti, reduktimi i varferise, mireqenia sociale, investimet publike, politikat rajonale, promovimi i ndermarrjeve, etj.

- **Te ardhurat qeveritare :**

- Te ardhura nga taksat,
- Shitja e sherbimeve qeveritare, pasaporta, dokumenta, etj.,
- Huazimi.

Ne lidhje me shfrytezimin e politikës fiskale, te kihet parasysh:

- Qe te behet me shpesh **axhustimi** i te ardhurave nepermjet taksave sesa ai i **perqindjeve** te taksave perkatese.
- Nje zgjerim apo amendim i intervalit te mallrave qe mbulohen nga TVSH (**VAT-value added tax**)
- Te ndryshohen apo korrigjohen rregullat apo procedurat nen te cilat behet pagesa e taksave (p.sh. lidhur me martesen, trashegimine, etj.), certifikatat, detyrimet e vulosura apo me pulle, etj. **Pagesat elektronike.**
- **Te hiqen disa taksa jo rentabel, qe frenojne zhvillimin ekonomik, etj.**

Te kihen parasysh po ashtu:

-Shpenzimet qeveritare

-Shperndarja e shpenzimeve ne drejtime te ndryshme si: **Siguria Sociale, Rendi dhe ligji, Sherbimet e emergjences, Shendeti dhe edukimi, Mbrojtja, Ndihma apo asistenca e huaj, Mjedisi, Agrikultura, Industria, Transporti, Rajonet, Kultura, Media dhe sporti.**

Nje sistem reference

Ky sistem bazohet ne keto parime celes per stabilitetin fiskal:

- **Transparenca, Stabiliteti, Pergjegjesia , Ndershmeria e barazia, Efektivitetit (eficiencia).**

Ky kod i tille kerkon nga qeveria per te percaktuar si **objektivat ashtu dhe rregullat** nepermjet te cilave do te operoje kjo lloj **politike fiskale**.

Objektiva te tille jane: ne nje afat mesatar, per te garantuar financa te shendosha publike, nje impakt shpenzimesh e taksash qe **u pergjigjet gjeneratave te sotme dhe atyre te neserme**; ne nje afat te shkurter, te mbeshtese politika monetare, ne vecanti, per te lejuar funksionimin e **stabilizatoreve automatike** ne zhvillimin e bute ekonomik. **(Te ardhurat nga taksat varen nga gjendja e ekonomise. Po ashtu, disa nga shpenzimet qeveritare varen nga gjendja e ekonomise. Vete stabilizatoret automatike jane ato aspekte te te ardhurave dhe shpenzimeve qe ndryshojne ne menyre automatike me gjendjen e ekonomise ne menyre te tille qe te mund te stabilizohet GDP-ja)**

- Keto objektiva zbatohen me ane te rregullave fiskale, sipas te cilave mund te vleresohet performanca e politikës fiskale .Te tille jane :

- **Rregulli i arte**, ne ciklin ekonomik, qeveria mund te marre hua vetem per te investuar por jo per te mbeshtetur shpenzimet korrente,

- **Rregulli i investimeve te qendrushme**: defciti publik apo borxhi neto ne sektorin publik si perqindje e GDP-se duhet te mbahet ne ciklin ekonomik ne nje nivel stabel . Bile rekomandohet, ne shume raste, nen 40% e GDP-se.

- **Rregullat fiskale ne terma afatmesme per te garantuar financa publike te shendetshme** duhet te lejojne fleksibilitet ne dy aspekte :


Te veprojne ne nje cikel ekonomik (gje qe lejon balancim fiskal ne vite, paralel me pozicionimin ciklik te ekonomise, duke mundesuar stabilizimin e lire automatik perkundrejt variacioneve te kerkeses)

- **Rregullat te funksionojne se bashku per te promovuar investimet kapitale krahas garantimit te financave publike te qendrushme, ne nje kohe te gjate.** Rregulli i arte kerkon qe buxheti korrent (i llogarise rrjedhese) duhet te jete ne balancim apo suficit (surplus) ne cikel, duke lejuar keshtu qeverine te huazoje vetem per mbeshtetjen e **shpenzimeve kapitale**. Kurse rregulli i investimeve te qendrushme ka te beje me **mbajtjen e huazimit ne nje nivel te kujdesshem.**

Qarkullimi rrethor i te ardhurave

- **Qarkullimi (rrjedhja) rrethor(e) i (e) te ardhurave** apo thjesht **qarkullimi (rrjedhja) rrethor(e)** (**circular flow of income** apo **circular flow**) pasqyron nje model ekonomik te thjeshte qe përshkruan **qarkullimin e ndersjelle te te ardhurave** midis **prodhuesve dhe konsumatoreve**. Ne kete model, njesite e ndërvarura te prodhuesit dhe konsumatorit paraqiten perkatesisht si “**firma**”(kompani) dhe si “**familje**” (shtepi). Ato zoterojne faktoret apo pajisen me kapacitetet e nevojshme per te lehtësuar qarkullimin e te ardhurave. Keshtu, firmat apo kompanite furnizojne konsumatoret **me mallra e shërbime** ne shkembim te **shpenzimeve te konsumatorit dhe te “faktoreve te prodhimit”** nga vete familjet.
- **Modele me te plota dhe realiste te qarkullimit te te ardhurave jane shume me komplekse**, mbi te gjitha ne ta duhet te përfshihen ne **menyre te qarte** roli i qeverive, tregjeve financiare, krahas importeve e eksporteve, raporteve te tyre.

Pamje e thjeshtë e lidhjes midis vendimmarrësve në modelin e qarkullimit rrethor. Shigjetat e përkulura më të trasha pasqyrojnë faktorët kryesorë, ndërsa ato të holla faktorët e dorës së dytë.



Instrumenta te politikës fiskale

Taksat

- E drejtperdrejta
- Te terthorta
- Subvencionet



Shpenzimet

- Te mirat publike
- Te mirat gjysme-publike

Deficiti / borxhi

- Huazuar nga sektori privat
- Huazuar nga bankat qendrore

Ekonomia e tregut



Balanca e buxhetit


Balanca e buxhetit publik (balanca fiskale publike) është rezultati total i buxhetit të përgjithshëm të një vendi gjatë një periudhe të caktuar (zakonisht një vit). Ai përfshin të gjitha nivelet e qeverisjes (nga qendrore tek ajo lokale) dhe fondet publike të sigurimeve sociale. **Balanca e buxhetit qeveritar është diferenca midis të ardhurave qeveritare (p.sh., taksave) dhe shpenzimeve.** Një balance pozitive është quajtur : **surplus buxhetor** dhe një balance negative: **deficit buxhetor**. Balanca e buxhetit qeveritar përdoret për të vlerësuar shëndetin fiskal të një vendi. Ajo diferencohet më tej nga **balanca primare** (paresore) dhe **balanca strukturore** (te njohur si **balance e axhustuar në mënyrë ciklike**). **Balanca primare është para pageses së interesave.** Balanca strukturore tenton të axhustohet për impaktet e GDP-së reale në ekonomine nacionale. Në përgjithësi, mbështetësit e Keynesit janë avokate të deficit buxhetor gjatë recesionit apo rënive të ekonomisë me synim arrijtjen e një balance pozitive buxhetore.

Deficiti

Kuptimi i “deficitit” ndryshon nga ai i “borxhit”, që është një akumulim i deficiteve vjetore. **Deficit buxhetori (deficiti fiskal apo thjesht deficit)** ndeshet kur shpenzimet e qeverisë kalojnë të ardhurat e mbledhura. Pra, kjo diferencë, në përqindje të PBB-së, është **deficiti buxhetor**. Ai na tregon nëse qeveria ka kursyer para apo ka marrë hua. Ai “matet” në mënyrë të plotë **me përfshirjen e pagesave të interesave të borxhit** në zërin shpenzime (**deficiti i plote**) ose pa i përfshirë ato (**deficit i parë**).

Per deficitin mund të flitet për **elementin ciklik** dhe **atë strukturor**. Dhe vete deficit buxhetor është shuma e tyre. P.sh., në kushte krize, në pikën më të ulët të ciklit të ekonomisë (biznesit) rritet papunësia, pra aty kemi **të ardhura më të ulëta nga taksat dhe shpenzime më të larta (p.sh., për sigurimet shoqërore)**. Dhe anasjelltas. Veçse, në rastin e parë, kërkohen **huazim shtesë**. Ky është dhe **deficiti ciklik, që mund të shlyhet i gjithi kur kalohet në “pikun” (në pikën më të lartë) të ciklit të ekonomisë (biznesit)**. Kurse, **deficiti strukturor është ai që ndeshet gjatë gjithë ciklit me tejkalimin e shpenzimeve (niveli i shpenzimeve i kalon të ardhurat e përftuara)**. Në fakt, kur ndodhesh në “pikun” e ciklit ekonomik, problemet gjejnë lehtë zgjidhje. Ndërsa, kur bëhet fjalë për deficitin strukturor, tepër larg “pikut” duhet detyrimisht të ridimensionohen disa nga premtimet qeveritare.


Deficiti dhe Suficiti



Deficiti fiskal i Greqise

Global Economic Perspectives

Greece Fiscal Deficit
(annual, % of GDP)



Source: Eurostat, 2009, 2010, 2011 EU Commission Autumn 2009 Forecasts

Deficiti tregtar

Ballanca e tregtise eshte diferenca midis vleres monetare te eksporteve dhe asaj te importeve ne rezultatin ekonomik per nje periudhe te dhene (zakonisht nje vit). Nje **ballance pozitive tregtare** apo **surplusi tregtar** nenkupton qe eshte eksportuar me shume sesa eshte importuar, ndersa nje **ballance negative** apo **deficiti tregtar** pasqyron “hendekun” tregtar, d.m.th. qe po importohet me shume se sa eksportohet.

Ballanca tregtare mund te ndahet po ashtu edhe ne ballance te mallrave dhe ate te sherbimeve.

Borxhi publik

Një çështje tjetër e lidhur ngushtësisht me deficitin buxhetor është **borxhi publik**. Ai shpreh **sasinë e plotë të parave që qeveria ua ka borxh kreditorëve** dhe zakonisht shprehet **në përqindje të PBB-së**. **Këto para qeveria ua ka borxh kreditorëve brenda vendit (kreditorëve të brendshëm, shqiptarë apo të huaj) apo ndërkombëtarë (kreditorëve të jashtëm)**. Ato huazohen nëpërmjet lëshimit të bondeve, boneve të thesarit, etj., apo duke marrë hua në mënyrë të drejtpërdrejtë nga organizma ndërkombëtarë të tilla si FMN-së, BB-së, etj.


Sipas CIA World Factbook, në vlerësimet e fundit, të ardhurat për Shqipërinë ishin: 3.3 miliardë dollarë, shpenzimet 3.7 miliardë dollarë, kurse deficitin në vlerë absolute 0.4 miliardë dollarë apo në % të PBB-së: 3.5% . Po sipas CIA-së, Shqipëria, në lidhje me borxhin publik është radhitur e 42-ta; me vlerë borxhi: 59.70 % e PBB-së (2011). Ndërsa, për borxhin e jashtëm (nga jashtë Shqipërisë), të dhënat janë: në vlerë absolute: 2,810,000,000\$ (2009), për frymë: 882\$; dhe në përqindje të PBB-së: 23%. Pjesa tjetër, afro 37%, mbetet borxh i brendshëm...

- **Ky borxh mund të jetë bruto ose neto.** Në rastin e parë përfshihen detyrimet e të gjitha institucioneve (përfshirë dhe ato për ecurinë kohore të pensioneve, për pagesat e të përndjekurve dhe të pronarëve; për trajtimin e ushtarakëve, apo pagesat për shërbime apo mallra të kontraktuara, ende të pashlyera). Kurse, borxhi neto është ai bruto minus të gjitha asetet financiare. (Për krahasim, përgjithësisht, merret **borxhi bruto në përqindje të PBB-së**).
- Pra, një pjesë e parave të grumbulluara nga taksat po harxhohen për të paguar pjesën e detyruar të borxhit publik. Por, kur kjo shumë është e madhe, ajo mund të ketë ndikime negative, madje të dëmshme në zhvillimin e vendit dhe rritjen afatgjatë të ekonomisë. Në vend të investimeve në infrastrukturë, shkolla, shërbimin shëndetësor, ruajtjen e mjedisit, etj., apo në sektorë që favorizojnë rritjen, qeveria është e detyruar të heq një pjesë të madhe të parave të grumbulluara për shlyerje borxhi. Me rritjen e tij kjo pjesë e hequr bëhet më e madhe!
- **Sidoqoftë, në rastin e Shqipërisë, një problem serioz për borxhin bruto, në një të ardhme të afërt, do të jetë ai i pagesave të shtyra jo vetëm për bizneset (p.sh., kompanitë private që janë marrë me ndërtimin e rrugëve pretendojnë disa qindra milionë euro ende të papaguara nga qeveria), por dhe kategoritë e ndryshme të popullsisë, në përputhje me legjislacionin e miratuar.**

Borxhi Publik i Greqise

Global Economic Perspectives

Greece Gross Government Debt
(annual, % of GDP)



Source: Eurostat, 2009, 2010, 2011 EU Commission Autumn 2009 Forecasts

Disa Komente

Prirjet pozitive të ekonomisë ndikojnë në rritjen apo kufizimin e deficitit. Një nivel në rritje i zhvillimit ekonomik çon në përgjithësi në të ardhura më të larta, ndërkohë që shpenzimet e qeverisë shtohen në situata krizash, sidomos ato që lidhen me asistencën sociale, p.sh., në kushtet e rritjes së papunësisë. Ato kanë ndikimet e veta në borxhin publik. **Pra, një borxh publik i lartë është një pengesë e drejtpërdrejtë për rritjen ekonomike, duke u pasqyruar më tej në përkeqësimin e politikave sociale.** Kurse, vete inflacioni, në përgjithësi, e redukton vlerën reale të borxhit të akumuluar. Bile, **nëse investuesit e “ndejnë” apo parashikojnë një inflacion, ata mund të kërkojnë interesa më të larta për borxhin e qeverisë, duke e bërë huadhënien publike shumë më të shtrenjtë. Dhe, njëkohësisht, e bën më pak të manovrueshme politikën monetare.** Në tabelën pasuese jepen të dhëna të borxhit për intervalin kohor (2005-2013) për Shqipërinë. Natyrisht, aty, të dhënat e vitit 2013 janë thjesht një parashikim (më shumë brenda variantit të thjesht të projekt-buxhetit 2013). Siç shihet nga tabela, **borxhi publik si përqindje e PBB-së**, gjatë kësaj periudhe 8-9 vjeçare, ka lëvizur “shumë pak”: nga vlera 56.7% deri në vlerën 59.7%. Por, po të shihet **reshti i parë i tabelës**, ky borxh ka lëvizur nga vlera 4.61 miliardë dollarë (2005) në vlerën e vitit 8.05 miliardë dollarë (2012), me **parashikim të pritshëm për vitin 2013 vlerën 8.35 miliardë**. Pra, bëhet fjalë për një rritje prej afro 4 miliardë dollarësh, gjatë 8 vjetëve të fundit. Nuk është pak, përkundrazi! Këtë e ilustron më së miri reshti i dytë që jep **vlerat e borxhit publik për frymë në dollarë. Ai lëviz nga vlera 1,478\$ (2005) në vlerën 2528\$ (2012). Kurse për vitin 2013 pritet një rritje prej afro 100 dollarësh të tjerë.** Rreshti i fundit shpreh ndryshimin vjetor të borxhit! Ai flet për mundësi programimi apo të ndonjë plani konkret në trajtimin e borxhit publik, madje dëshmon për një “luhatje” financiare në periudha parazgjedhore e zgjedhore. Një gjë e tillë, po të jetë e vërtetë, është larg të qenit disiplinë fiskale.

Borxhi publik- rasti shqiptar

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Borxhi publik miliarde \$:	4.61	5.19	6.15	6.55	6.76	6.71	7.63	8.05	8.35
Borxhi publik për person (\$):	1,478	1,666	1,968	2,093	2,151	2,128	2,398	2,528	2,624
Popullsia (mil.):	3.10	3.10	3.10	3.10	3.18	3.20	3.18	3.19	3.21
Borxhi publik si % e PBB-se	56.7%	55.9%	53.8%	53.5%	56.7%	57.1%	59.3%	59.7%	59.7%
Ndryshimi vjetor i borxhit (%):	0.4%	12.6%	18.4%	6.6%	3.3%	-0.8%	13.7%	5.5%	3.7%

Një tabelë me të dhëna nga “*The Economist. The Global debt clock*”,

Taksimi

1. Taksat e terthorta (indirekte).

Jane ne kompetence te qeverise qendrore:

-TVSH (VAT)

-Ekciza: qe lidhet me prodhime te tilla si pijet alkolike, cigaret, etj.

2. Taksat e drejtperdrejta (direkte).

Ato lidhen me **dy nivelet e qeverisjes**, qendrore apo vendore. Paguhen ne **menyre te drejtperdrejte** dhe nuk zhvendosen tek te tjere.

-Taksa e te ardhurave

- Taksa e shtepise, etj.

Taksat proporcionale, progresive e regresive

Thjeshtim i sistemit te taksimit

Menjanimi i perjashtimeve.

Ne disa raste zbatohen regjime speciale (p.sh. kontribut i ndonje bashkesie fetare, etj)

Futje e perqindjeve nominale


-10% taksa e sheshte e te ardhurave individuale

-10% - honoraret

-20% e TVSH se unifikuar per te gjitha mallrat dhe sherbimet, pa perjashtim (10% per ilacet dhe disa sherbime po ne kete fushe)

• Zhvendosje nga taksat e drejtperdrejta ne ato te terthorta.

Diagrame qe ilustron efektin e taksave



Bosnje- Herzegovina futi normën më konkurruese 10% në 2004; Shqipëria e pasoi në 2007, Bullgaria në 2008. Rumania futi taksën e sheshte më të lartë në 16% në 2005, pasuar nga taksa e sheshtë e Malit të Zi prej 15% në 2007. Serbia ka patur një taksë të sheshtë prej 14% që nga 2003. **TVSH-ja në Serbi është 18% për shumicën e mallrave dhe 8% për "mallrat bazë" të tilla si buka, qumështi dhe ilacet.**

-2-



Ne taksim duhet te zbatohen disa parime si:

- Barazia, drejtesia dhe ndershmeria
- Prodhueshmeria, fuqizimi,
- Prosperiteti ekonomik
- Promovimi i qytetareve te edukuar mire, te shendetshem dhe familje te forta
- **Kufizimi i bezdive administrative**

Taksat dhe barazia (drejtesia, paanesia apo ekiteti (equity)):

Barazia horizontale:

Te barabartet duhet te taksohen ne menyre te njejte.

Barazia vertikale

Te pabarabartet (te ndryshmit) duhet te taksohen ne menyre te ndryshme.

Politika monetare

- Perpjekje per te ndikuar **nivelin e aktivitetit ekonomik** (sasine e asaj qe shitet dhe blihet ne ekonomi) nepermjet ndryshimeve te **sasise se parave ne qarkullim** dhe te **cmimit te parase** (normave kohe-shkurter te interesit).
- **Normat e interesit** jane element kyc i politikës monetare. Norma zyrtare apo Repo-te jane ato qe percaktojne strukturen e te gjitha perqindjeve te tjera te interesit. **Baze e politikës monetare eshte dhe marredhenia kohe-gjate midis sasise se parase dhe inflacionit.**
- **Kerkesa e parase** – eshte sasia qe njerezit preferojne ta kene apo ta mbajne si “kesh” (Cash) dhe jo si asetete te tjera.
- **Oferta e parase** - eshte sasia e parase ne qarkullim ne ekonomi.
- Nje formule sipas teorisë klasike: **$MV = PY$**
 - (ku M = stoku i parase, V = shpejtesia e qarkullimit, P = niveli i cmimit dhe Y = niveli i te ardhurave kombetare).
- (Me sakte: **$M_d = k PY$** , ku P eshte niveli i cmimit, Y ai i te ardhures reale kombetare, M_d eshte kerkesa per para per qellime transakcionesh, k = proporcioni i te ardhurave kombetare qe mbeshtet balancat e transakcioneve. Ne ekuiliber **$M_d = M_s$**
 - Keshtu: **$P = 1/kY \times M$**
 - Nje rritje ne M_s do te coje tek nje rritje proporcionale ne P).

Nderhyrja banke qendore/qeveri

Ne pergjithesi, nderhyrje te ketij lloji (nderhyrje banke qendore/qeveri) jane te domosdoshme per te parandaluar **krizat. Keshtu, nga 1945-1971 jane eliminuar krizat bankare, por jo **krizat e parase****

Shume nga krizat e parase u jane detyruar inkonsistencave ne politikat makroekonomike qeverisese. Pra, shpjegimi i krizave te parase eshte bazuar sidomos ne keqadministrimin e qeverisjeve.

Disa koncepte praktike shprese

- **Komision administrimi** - është një kosto fikse e cila paguhet për çdo kredi të aprovuar përveç **normës së aplikuar të interesit**. Ky komision paguhet nga klienti dhe përfshihet në normën efektive të interesit, të cilën klienti e ka të pasqyruar në kontratën e tij të kredisë dhe në planin e pagesës.
- **Kuotim**- është **norma e interesit** nëpërmjet të cilit banka e nivelit të dytë shpreh gatishmërinë për të vendosur depozitë dhe për të pranuar depozitë në tregun ndërbankar të parasë. Kuotimi shprehet me dy shifra pas presjes dhjetore.
- **Tregu ndërbankar i parasë**- është tregu ku bankat e nivelit të dytë kryejnë midis tyre veprime **huamarrjeje dhe huadhënieje në monedhën vendase** (p.sh. Lekë në Shqipëri).
- **TRIBOR** (*Tirana Interbank Offer Rate*)- është norma fikse e interesit e llogaritur, bazuar në kuotimet e bankave referencë për të vendosur depozita në tregun ndërbankar të parasë.
- **EURIBOR** (*European Interbank Offered Rate*)- është norma e interesit për huadhënie për 12 muaj në Euro, në tregun ndërbankar ndërkombëtar apo vendet e Europës.
- **LIBOR** (*London Interbank Offered Rate*)- është norma e interesit për huadhënie për 12 muaj në dollarë amerikanë, në tregun ndërbankar ndërkombëtar apo vendet e Europës,

Consumer Price Index (CPI)

apo

Indeksi i Cmimeve te Konsumit (IÇK)

CPI (Consumer Price Index) apo IÇK (Indeksi i Cmimeve te Konsumit) mat ndryshimet ne nivelin e mallrave dhe sherbimeve te konsumit te kryera nga familjaret .

Ky indeks percaktohet si mase e nje ndryshimi mesatar ne nje kohe te dhene e cmimeve te pagauara nga konsumatore urbane per nje shporte te dhene mallrash dhe sherbimesh.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (INSTAT)

Metodologjia: Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) mat ndryshimin e çmimeve të konsumit të një shporte fikse mallrash e shërbimesh në periudhën korrente krahasuar me një periudhë tjetër e konsideruar si periudha bazë. Periudha bazë e indeksit është muaji Dhjetor 2007.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit përdoret: - Matës zyrtar i inflacionit në Shqipëri; - Deflator vlerash për sektorin e Llogarive kombëtare; - Deflator për llogaritjen e indekseve të volumit; - Variabël për analizat makro ekonomike; - Deflator për indeksimin e pagave, pensioneve dhe të ardhurave kur është e nevojshme; - Për hartimin e politikave monetare për Bankën e Shqipërisë.

Historiku: Indeksi i parë zyrtar u llogarit në muajin Dhjetor 1991 duke patur si periudhë bazë muajin dhjetor 1990. Në vitin 1991 u llogarit edhe indeksi për muajin dhjetor 1989 dhe 1990. Nga viti 1992 e në vazhdim është llogaritur IÇK **me frekuencë mujore**. Në vitin 1993 për herë të parë INSTAT realizoi Anketën e Buxhetit të Familjes (ABF), rezultatet e të cilës u përdorën për rinovimin e **Shportës së Mallrave të Indeksit** dhe llogaritjen e **Peshave të Mallrave**. **Muaji dhjetor 1993 u përdor si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit**. Shporta e mallrave përmbante **221 artikuj dhe shpenzimet u klasifikuan të ndara në 8 grupe kryesore**. Në vitin 2000 INSTAT realizoi një ABF, rezultatet e të cilës u përdorën për rinovimin e shportës së artikujve. Pas rinovimit indeksi u llogarit duke përdorur **muajin Dhjetor 2001** si periudhë bazë. Shporta përmbante **262 artikuj dhe shpenzimet për herë të parë u klasifikuan në 12 grupe kryesore**.

Struktura e IÇK-së

Klasifikimi

Indeksi Ilogaritet sipas një strukture të klasifikimit COICOP (Klasifikimi i shpenzimeve individuale sipas qëllimit), i përputhshëm plotësisht me strukturën e shpenzimeve që përdor EUROSTAT.

Bazuar në këtë klasifikim shpenzimet janë klasifikuar **në 12 grupe kryesore** (në **272 artikuj**) si:

- Ushqime pije alkolike dhe duhan
- Pije alkolike dhe duhan
- Veshje dhe këpucë
- Qera, ujë lëndë degëse dhe energji
- Mobilim, paisje shtëpie dhe mirmbajtje
- Shëndetësi
- Transport
- Komunikim
- Arsim dhe kulturë
- Shërbim arsimor
- Hotele, kafe dhe restorante
- Mallra dhe shërbime të tjera

Indekset që llogariten

Indeksi jepet sipas kesaj hierarkie: - Indeksi Total; - Indeksi sipas grupeve kryesore; - Indeksi sipas grup-mallrave; - Indeksi në nivel të detajuar sipas artikujve.

Mbulimi:

Mbulimi Gjeografik: Shqipëria ka 12 prefektura, dhe për qëllimin e llogaritjes së IÇK-së janë përdorur 11 prefektura, ku prefektura e Kukësit është e përfaqësuar nga prefektura e Dibrës. Peshat janë ndërtuar duke marrë në konsideratë zonën urbane dhe rurale (fshat qytet), ndërsa çmimet mbliidhen vetëm në qytet. Për zgjedjen e dyqaneve që do të përdoren për mbledhjen e çmimeve jemi bazuar në dy kritere: - **Tipin e dyqanit, - Vendin ku ndodhet.** Bazuar në tipin e dyqanit në mbledhim çmimet në dyqane të specializuar, mini markete, supermarketete, tregje të hapura e tjera. Ndërsa bazuar në vendin e ndodhjes çmimet mbliidhen në dyqane që janë në qendër të qytetit dhe në periferi.

Mbulimi i produkteve: Shporta e mallrave përmban 272 artikuj të ndryshëm përfshirë mallra dhe shërbime. Për zgjedhjen e këtyre mallrave dhe shërbimeve jami bazuar në rezultatet e Anketës së Buxhetit të Familjeve (ABF). Për zgjedhjen e produkteve është ndjekur si me poshtë: - Fillimisht u krijua një skedar me 375 artikujt të klasifikuara sipas klasifikimit COICP i detajuar në nivel 6-shifror; - Më pas u llogarit pesha (përqindja) që zë çdo produkt në totalin e shpenzimeve të familjes. Të gjithë produktet me peshë më të madhe se 0.05 përqind në totalin e shpenzimeve u përzgjedh në shportë; - Për artikujt e tjere të mbetur u bë agregimi në nivel 5-shifror i klasifikimit COICOP. Në këtë hap u bë një kombinim (bashkim) i artikujve të ngjashëm dhe në këtë mënyrë u zgjedhën edhe disa artikuj të tjerë në shportë; - Më pas me shportën e re të përfituar nga zgjedhja u kalua në analizën e artikujve në nivel 5-shifror të detajimit. U zgjedh të paktën një produkt. Në rastet kur ky kriter nuk plotësohej u zgjedhën produkte nga produktet e mbetura; - Në fund u bë krahasimi i shportës së re me shportën e vjetër dhe u tregua kujdes që të përfshiheshin në listë artikuj nga shporta e vjetër megjithëse nuk plotësonin kriterin e 0.05 %, Gjithashtu u përjashtuan nga shporta disa artikuj që megjithëse plotësonin kriterin e 0.05 përqind, mbledhja e çmimeve ishte e pamundur. - Peshat e shpenzimeve për produktet e pa zgjedhura janë shpërndarë në mënyrë proporcionale në grupet respektive klasifikimit të shpenzimeve.

Llogaritja e Indeksit

Mbledhja e Çmimeve: Çmimet mblidhen vetëm në qytet, Zyrat rajonale të 11 qyteteve janë të përfshira në mbledhjen e çmimeve si Berat, Dibër Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër. Korçë, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Koha e mbledhjes së çmimeve është nga data 10-25 të çdo muaji. Në çdo qytet çmimet mblidhen në 6-8 ose 10 dyqane. Çdo muaj afërsisht mblidhen rreth 18,000 çmime individuale. Afërsisht janë rreth 500 dyqane ku mblidhen çmimet çdo muaj.

Llogaritja e peshave. Peshat janë përqindja e shpenzimeve të çdo produkti ndaj shpenzimeve gjithsej. Keto pesha janë: - Peshat e produkteve për çdo rajon; - Peshat gjeografike; - Peshat e produkteve në nivel vendi. Peshat e produkteve për çdo rajon janë përdorur për llogaritjen e indeksit në nivel rajonal. Peshat gjeografike dhe peshat e produkteve në nivel vendi janë përdorur për llogaritjen e indeksit në nivel vendi.

Llogaritja e Indeksit: IÇK llogaritet në nivel kombëtar dhe rajonal. Hapi i parë i llogaritjes së indeksit është llogaritja e çmimeve relative për çdo produkt për çdo rajon. Në mënyrë më të detajuar, çmimi relativ është llogaritur për çdo produkt dhe çdo prefekturë (**Imputimi i çmimeve:** Për produktet sezonale të cilat dalin dhe zhduken nga tregu gjatë një ose disa muajve në vit çmimet e tyre imputohen. Imputimi bëhet duke marrë për bazë ndryshimin mesatar relative të çmimeve të grupit ku artikulli bën pjesë. E njëjta metodologji përdoret për imputimin edhe të çmimeve të tjera që për një arsye apo tjetër mungojnë në treg).

Publikimi: Indeksi i Çmimeve të Konsumit publikohet në datë 6 të muajit pasardhës. Indeksi publikohet në: - **Buletinin mujor "Indeksi i Çmimeve të Konsumit** dhe "Konjuktura"; - Buletinin tremujor "Statistika"; - Vjetarin statistikor, etj.. Indeksi publikohet çdo muaj po me datë 6 në faqen e Web të INSTAT.

Perqindja e inflacionit

Kjo eshte nje mase (matje) e inflacionit . E tille eshte **rritja e indeksit te cmimeve** si ai i **cmimeve te konsumit** (ndryshimi ne nivelin e cmimeve) ne nje kohe te dhene, zakonisht nje vit. **Perqindja (raporti) e renies se fuqise blerese te parase eshte afersisht e njejte.** Perqindja e inflacionit perdoret per te llogaritur **perqindjen reale te interesave**, apo **rritjen reale te rrogave** (pagesave). Nje humbje ne fuqine blerese te parase pasqyrohet si rritje ne nivelin e pergjithshem te cmimeve (shpesh te matur nga indeksi i cmimeve te konsumit) .

Pra, c'eshte inflacioni?– Nje situatë ekonomike qe karakterizohet nga nje rritje ne cmime dhe rroga dhe nje renie ne fuqine blerese. Ai matet zakonisht me ndryshimet ne indeksin e cmimeve te konsumit (**Consumer Price Index -CPI**). Inflacioni e zvogelon fuqine blerese, dhe me shpesh ka nje perqindje te ulet ne kursim (nje pjese kryesore e rrogës harxhohet per konsum).

Inflacioni eshte nje dukuri monetare. Ai ndodh kur ka shume para ne qarkullim ne krahasim me prodhimin e mallrave dhe sherbimeve aktuale. Ne ShBA kete ben Rezerva Federale (Federal Reserve), ndersa ne Shqiperi Baka Qendrore me **politiken e saj monetare** per te kontrolluar inflacionin, megjithate **politika fiskale** mund te ndihmoje jo pak (p.sh., me politiken e te ardhurave). Duke rritur nivelin e cmimeve inflacioni i larte mund te shoqerohet me pasiguri, dekurajon kursimet dhe investimet, deri duke prekur tregtine e vendit me jashte, ne baze te raportit (normes apo perqindjes) te kembimit dhe balancimit te pagesave, apo rishperndarjes se te ardhurave (nga te kursyerit ne marrje huaje).

Inflacioni dhe deflacioni

■ Inflacioni

■ Tepricë paraje

■ Mbivlera e parasë e bën atë më pak të vlefshme

■ Kërkohet më shumë para për të blerë të njëjtat të mira materiale: mallra apo shërbime (**rritje çmimesh**)

- **Ndryshimi i sasisë së kreditimit në sistemin bankar ndryshon agregatin e parasë M.** Pra, rënia e kreditit rrit përqindjet (normat) e interesave

■ Deflacioni

● Mungesë paraje

● Nënvlësimi i saj e bën atë më të vlefshme

● Kërkohet më pak para për të blerë të njëjtat të mira (**rënie çmimesh**).

- **Rritja e kreditimit zvogëlon përqindjet (normat) e interesave.**

Vlera te konsiderueshme te inflacionit shpesh kushtezohen nga rritje te shpejta ekonomike, sidomos per vende kur kerkesat per mallra dhe sherbime jane me te larta se kapaciteti prodhues . **Lufta kunder inflacionit eshte detyre e bankes qendrore qe dhe kontrollon agregatin monetar duke ulur apo rritur interesat.** P.sh., BQE (ECB) po tenton ta mbaje inflacionin vjetor 2% per te ruajtur stabilitet cmimesh dhe rritje te qendrueshme.

Paraja

Inflacioni

çmimet

çmimet

çmimet

Mallrat dhe shërbimet

Deflacioni

çmimet

çmimet


çmimet

Paraja

“Cfarë është deflacioni? -
“një periudhë ekonomike e
karakterizuar nga një ulje e
përgjithshme dhe
persistente e cmimeve. Ajo
pasqyron një rritje me
kohën të fuqisë blerëse të
parasë”. (Le Monde 5
octobre 2010)


Inflacioni ne shkalle globale (1984- 2002)

Burimi: 'Rethinking Governance', boshti Y mat vleren logaritmike te inflacionit mesatar per çdo rajon sipas periudhave te dhena



NIC (Newly Industrializing Countries)

Perqindja e inflacionit (ICK) %



Lufta monetare

- Flitet sot për një luftë monetare, për një konflikt global mbi **normat e këmbimit**, për një seri zhvlerësimesh apo gare të lidhur me interesa krejt të veçanta. Bile, shtetet kryesore po përplasen midis tyre duke synuar ushtrimin e një praktike tepër të rrezikshme: **secili prej tyre përpiqet të dobesoje monedhën e vet (ta zbrese në një nivel sa më të ulët) për të favorizuar eksportet dhe për të shpëtuar punësimin.**
- Mendohej se gjëra të tilla ishin kapërcyer! Aq më tepër që vendet e tjera te ndodhura nën trysinë e viktimizimit mund të marrin **masa proteksioniste të pastra e të thjeshta**. Parë me këtë sy, sidomos historia e vitit 2010, po penalizon sidomos eksportuesit e zonës euro.
- Përplasja më e drejtpërdrejtë është ShBA-Kine, madje ShBA akuzon Kinën në mbajtjen e monedhës kineze yuan-it **në mënyrë artificiale një nivel tepër të zhvlerësuar në lidhje me dollarin**. Dhoma e përfaqësuesve e konsideron këtë epërsi të eksportimeve kineze si ekuivalente e një **“subvencioni të shpifur”**, prandaj ligjvënësit amerikanë kanë qene ne kerkim te masave të ashpra tregtare.
- **Banka Qendrore Amerikane (Rezerva Federale) është përgjigjur në të njëjtën mënyrë. Në mbështetje të aktivitetit ajo aplikoi një politikë monetare që konsiderohet si QE apo “quantitative easing”**

Quantitative Easing (QE)

- Në thelb, ky është një proces i rritjes së agregatit të parasë apo e rritjes tej mase të rezervave të sistemit bankar, kur normat e interesit janë reduktuar në zero dhe qeveria synon të ndalojë një situatë “plasje” (“crunch”) kreditimi. Pra, kjo politikë shfrytëzohet kur kanë dështuar metoda normale të kontrollit të agregatit të parasë, p.sh. ajo e normës së interesit. Një bankë qendrore e zbaton QE duke kredituar fillimisht llogarinë e vet me para të krijuara nga “*ex nihilo*”. Ajo blen kështu asete financiare, përfshirë bono thesari të qeverisë, borxhe të agjencive të ndryshme, siguracionet e kreditimit të shtëpive, bonot e korporatave nga banka të tjera apo institucione financiare. Kjo e mundëson bankën qendrore të rrisë tepricën e rezervës për të prodhuar para të re dhe në këtë mënyrë shpresohet të stimulohet ekonomia. Janë të mundshme të dy rreziqet: nga njëra anë, një proces i tillë mund të nxisë hiperinflacionin, ndërsa, nga ana tjetër, ka rrezik që banka të mbështetet tek cash-i shtesë për të rritur rezervën kapitale duke mos qenë mjaft efektive në trajtimin e portofolio-s së huadhënies. Kjo lloj “metodologjie” është shfrytëzuar nga Banka e Japonisë në fillim të viteve 2000-të dhe, praktikisht, e njëjta taktikë është shfrytëzuar dhe nga Rezerva Federale më 2008 në trajtimin e krizës së kreditit. Me këtë lloj “teknologjie” ajo po blen bono thesari, për të ushtruar presion ndaj rënies së dollarit, dhe po ashtu, duke bërë nga ana saj eksportimet amerikane me konkurrese. Nëse ky lloj veprimi nuk quhet një zhvlerësim kompetitiv, ai i ngjan tamam atij!

- Disa vëzhgues kanë arritur në përfundimin se kur norma e interesit zbritet në zero nga banka qendrore politika monetare e humbet aftësinë për të stimuluar më tej kërkesën agregate dhe vetë ekonominë. Për të tjerë, një përfundim i tillë edhe në planin konceptor duket i gabuar. Në fakt, në kushtet e një sistemi monetar fiat, një qeveri (në praktikë banka qendrore në bashkëpunim me agjenci të tjera) ka mundësinë për çdo rast të gjenerojë shpenzime të rritura dhe inflacion edhe kur norma e interesit për një kohë të shkurtër është zero. Në fakt, në rastin e sistemit fiat, bëhet fjalë për një para me kurs të detyrueshëm këmbimi. Ajo, si kartëmonedhë apo monedhë metalike, nuk është e konvertueshme në ar apo metal të çmuar. Pranohet si mjet këmbimi kur publiku ka besim në këtë formë paraje apo kur ajo bazohet në garanci shtetërore. Është para jo për vlerën që bart (është thjesht letër e shtypur) por për vlerën që një shtet vendos të përfaqësojë nëpërmjet saj (p.sh. 1000 lek).

Koment shtese (tetor 2010)

- Por, nuk është vetëm ShBA-ja e përfshirë në këtë “histori”. Japonia po shet po ashtu sasi yeni, për të mos lejuar një zhvlerësim të mëtejshëm të tij. Njëlloj dhe Zvicra apo disa vende të tjera që nuk dëshirojnë që monedhat e tyre të vlerësohen përkundrajt dollarit. **Siç duket një “viktimë” mbetet euro.** Me situatën ekonomike në Irlandë, në Greqi apo Spanjë, euro nuk duhet të sillet me kete lloj “krenarie”. Kështu, ajo brenda një muaji (muajit tetor 2010) u rrit gati 10% ndaj dollarit duke arritur në një kurs këmbimi 1 euro=1.4 dollarë. Aktualisht situata është me e mire!
- Kryeministri kinez Zhiabao, në vizitën e tij në Greqi, **propozoi blerjen e borxhit grek në shtrirje të gjatë kohe.** Pa e zgjatur, sipas tij, më mirë për të fituar e ruajtur euron sesa për të mbledhur dollarë që Rezerva Federale po përpiqet t’i zhvlerësojë. Pra, përkundrajt kësaj situate, nuk është e sigurt me iu kundërvënë “statutit” të dollarit (2010) apo për të lejuar uljen e mëtejshme të kursit të tij. **Pavarësisht nga kjo, ne vitin 2010, me të drejtë presidenti francez (Sarkozi) e konsideroi tepër të rrezikshme situatën monetare të kohës, çrregullsinë e theksuar të saj në nivel global.**

Roli i parlamentit mbi qeverisjen ekonomike (rasti shqiptar)

Mbi politiken fiskale:

Diskutimi me grupet e interesit

**Miratimi në komisionet
parlamentare**

Miratimi i paketës fiskale

Ligji i buxhetit

Kushtetuta: FINANCAT PUBLIKE

Neni 155:

Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Në këto raste ligjit nuk mund t'i jepet **fuqi prapavepruese**.

Neni 156:

Shteti mund të marrë e të garantojë hua dhe kredi financiare, kur autorizohet me ligj.

Neni 157:

- 1. Sistemi buxhetor përbëhet nga buxheti i shtetit dhe nga buxhetet vendore.**
- 2. Buxheti i shtetit krijohet nga të ardhurat e mbledhura prej taksave, tatimeve dhe detyrimeve të tjera financiare, si dhe nga të ardhura të tjera të ligjshme. Ai përfshin të gjitha shpenzimet e shtetit.**
- 3. Organet vendore caktojnë dhe mbledhin taksa dhe detyrime të tjera siç përcaktohet me ligj.**
- 4. Organet shtetërore dhe ato vendore janë të detyruara t'i bëjnë publike të ardhurat dhe shpenzimet.**

Neni 158:

1. Kryeministri, në emër të Këshillit të Ministrave, i paraqet Kuvendit projektligjin për buxhetin e shtetit gjatë sesionit të vjeshtës, i cili nuk mund të mbyllet pa e miratuar atë.
2. Në qoftë se projektligji nuk arrin të miratohet deri në fillim të vitit të ardhshëm financiar, Këshilli i Ministrave zbaton **çdo muaj një të dymbëdhjetën e buxhetit të vitit paraardhës, derisa të miratohet buxheti i ri.**
3. Kuvendi miraton buxhetin e ri brenda 3 muajve nga dita e mbarimit të vitit të kaluar financiar, përveçse në rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme
4. Këshilli i Ministrave është i detyruar t'i paraqesë **raport Kuvendit lidhur me zbatimin e buxhetit dhe me borxhin shtetëror për vitin e kaluar.**
5. Kuvendi vendos përfundimisht pasi dëgjon edhe raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 159:

Parimet dhe procedurat për hartimin e projektbuxhetit, si dhe për zbatimin e buxhetit **përcaktohen me ligj.**

Neni 160:

1. **Gjatë vitit financiar Kuvendi mund të bëjë ndryshime në buxhet.**
2. Ndryshimet në buxhet bëhen sipas procedurës së parashikuar për hartimin dhe miratimin e vetë buxhetit.
3. Shpenzimet e parashikuara me ligje të tjera nuk mund të ulen sa kohë që këto ligje janë në fuqi

Rritja e kufirit te deficitit

Rritja e kufirit te deficitit behet vetem me ligj te miratuar nga Kuvendi.

- Ne asnje rast Ministria e Financave nuk duhet te autorizojë shpenzime mbi kufirin e deficitit te miratuar me ligj. - Po ashtu, Banka e Qendrore nuk duhet te mbeshtese apo tolerojë financimin e rritjes se deficitit.


Kur qeveria rrit deficitin kjo do te thote se ajo pakeson mundesite per kredi per sektorin privat si dhe rrit koston e deficitit, duke rritur koston e parase ne ekonomi. Pra, i ben me te shtrenjta kredite per biznesin dhe konsumatoret. Po keshtu, kur Banka Qendrore lejon rritjen e financimit te deficitit, rritet oferta e parase ne qarkullim, cka ne kushte normale, rrit kerkesen totale ne ekonomi, gje qe mund te sjelle edhe rritje te inflacionit.

Pra, cenohet misioni themelor i Bankes Qendrore qe eshte ruajtja e stabilitetit te cmimeve.

“Borxhi total publik, përfshirë garancitë, nuk duhet ta tejkalojë limitin 60% të produktit të brendshëm bruto”. Ky ishte limiti që qeveria i kishte vënë vetes me ligj në qershor të vitit 2008. Dje, Ministria e Financave paraqiti në Kuvend shfuqizimin e këtij paragrafi të nenit 58 në ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. Pas miratimit të tij qeveria nuk ka më kufij për rritjen e borxhit. (Qeveria e ka shkelur këtë ligj që me paraqitjen e buxhetit, i cili duhet të shkonte në Kuvend në fillim të nëntorit. Por kjo ishte vetëm shkelje procedurale. Shkelja financiare po mbrohet me ndryshimin e dt. 22 nentor 2012). Në prezantimin e djeshëm të buxhetit, parashikohet që borxhi publik të shkojë në 62.6% e GDP-së. Shifra e re është e njëjtë me atë të vitit 2002, ku u arrit niveli maksimal dhe rekord i borxhit. Në total, në vitin 2013, borxhi do të arrijë në 8,959 miliardë USD.

Rritja e borxhit ne 2013.

Vitin tjetër borxhi 8,9 miliardë USD. Sa ndikon kjo në rritjen ekonomike kur vetëm për interesat, në 2013 ne do te paguajmë 500 milionë USD.



Autoriteti fiskal dhe auditimi publik

Autoriteti fiskal

Struktura qendrore

Efektiviteti në mbledhjen e të ardhurave (**Doganat dhe Tatimet**)

A vlen një autoritet **autonom apo i integruar** (në duar të qeverisë)?

Struktura të tjera qendrore që bashkëveprojnë në mbledhjen e të ardhurave

Struktura lokale

Bashkëveprimi me organizma ndërkombëtarë si BB-ja apo FMN-ja në dy nivelet

Auditimi publik

Kontrolli i lartë i Shtetit

Raportimi në Parlament

Komisionet e zakonshme


Komisionet hetimore

Disa evidenca

Ministritë vazhdojnë të bëjnë mbishpenzime

Draftimi apo rishikimi (miratimi kohë pas kohe

i buxheteve shtesë apo suplementare) **është shenjë dobësi por dhe mungesë kapacitetesh planizuese e menaxhuese!**



Kontrolli i Lartë i Shtetit

Mbulon kontrollin në të gjitha instiucionet e shtetit, ministritë, zyrat e ndryshme, autoritetet vendore, kontrollon financat, bën auditimin. **Nuk ka autoritet Prokurorie.**

Qeveria dhe shumica parlamentare nuk ja parapëlqejne raportimet!...

Sipas Kushtetutës së Shqipërisë:

Neni 162

Kontrolli i Lartë i Shtetit është **institucioni me i lartë i kontrollit ekonomik e financiar**. Ai u nenshtrohet vetem Kushtetutes dhe ligjeve. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidenti të Republikës. Ai qendron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Gjatë viteve 1997-2000 u hodhën hapa serioze në rrugën për forcimin dhe konsolidimin e KLSH-së. Bazat ligjore dhe institucionale bënë të mundur të përcaktohet qartë roli, autoriteti, objekti dhe marrëdhëniet e KLSH-së me Parlamentin, Qeverinë dhe Institucionet e tjera.

Neni 163

Kontrolli i Larte i Shtetit kontrollon:

- a) veprimtarine ekonomike te institucioneve shteterore e te personave te tjere juridike shteterore;
- b) perdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shteterore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor;
- c) veprimtarine ekonomike te personave juridike, ne te cilet shteti ka me shume se gjysmen e pjeseve ose te aksioneve, ose kur huat, kredite dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

Neni 164

- **Kontrolli i Larte i Shtetit i paraqet Kuvendit:**
 - a) raport per zbatimin e buxhetit te shtetit;
 - b) mendim per raportin e Keshillit te Ministrave per shpenzimet e vitit te kaluar financiar para se te miratohet nga Kuvendi;
 - c) informacion per rezultatet e kontrolleve sa here qe kerkohet nga Kuvendi.
- **Kontrolli i Larte i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor te veprimtarise se tij.**

Neni 165

- **Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit mund te ftohet te marre pjese dhe te flase ne mbledhjet e Keshillit te Ministrave, kur shqyrtohen ceshtje qe lidhen me funksionet e tij.**
- **Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit ka imunitetin e gjyqtarit te Gjykates se Larte.**

Ligji Organik i KLSH-se:

Ligji nr. 8270, datë 23.12.1997, së bashku me amendimet në Ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit".

Pavarësia e institucionit është e garantuar me pozicionin kushtetues dhe ligjin organik të KLSH, duke filluar nga pavarësia e Kryetarit, pavarësia financiare, imuniteti i Kryetarit, pavarësia organizative dhe funksionale. Kryetari zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës dhe qëndron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

KLSH ka për objektiv kontrollin e përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, miradministrimin financiar dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike e financiare. Gjithashtu, komunikimin dhe dhënien e informacionit autoriteteve publike dhe publikut në përgjithësi, nëpërmjet publikimit të raporteve të paanshme. KLSH ka për detyrë të kontrollojë :

Veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë ; Përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe vendor ; Veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve apo të aksioneve ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti ; Përdorimin e fondeve që iu janë dhënë nga buxheti i shtetit partive politike dhe shoqatave ; Mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të kontroll-revizionit të brendshëm shtetëror, përfshirë auditin e brendshëm ; Subjekte të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta.

KLSH e ushtron kontrollin e administrimit të pronës shtetërore dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, në subjektet e përcaktuara në ligjin organik. Kontrolli mbulon çështjet e rregullshmërisë, të administrimit financiar dhe vlerësues.

KLSH ka të drejtë të japë rekomandime lidhur me kontrollin e drejtimit dhe atë të kontroll-revizionit të brendshëm, dhe kërkon nga subjektet e kontrolluar dhe autoritetet e larta shtetërore marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e gjendjes në përputhje me këto rekomandime. Gjithashtu, KLSH ka të drejtë të bëjë propozime për përmirësimin e legjislacionit në fushat brenda detyrave të tij, madje kur gjatë kontrollit konstaton akte ligjore ose nënligjore në kundërshtim me ligjet bazë, mund të kërkojë ndryshimin ose shfuqizimin e tyre nga organet që i kanë nxjerrë ; ndërkohë që për shkeljet financiare me dëm ekonomik, **KLSH kërkon kompensimin e vlerave të humbura.** Për rastet kur shkeljet financiare me dëm ekonomik, **përbëjnë vepër penale, ndaj personave përgjegjës bëhet kallzim në organet e prokurorisë, duke i dërguar dhe materialet përkatëse.**

Lidhur me marrëdhëniet institucionale të KLSH, ato përcaktohen qartë në kushtetutë dhe ligjin organik.

Kryetari i KLSH ka detyrimin për paraqitjen çdo vit në Kuvend për:

- **Raportin për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit;**
- **Mendime për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar, para se të miratohet nga Kuvendi;**
- **Raportin për Veprimtarisë Vjetore të KLSH ;**

Autoriteti monetar

Elementë të politikës monetare:

- Krahas nxjerrjes e qarkullimit të monedhës,
- mbajtjes dhe administrimit të rezervave valutore
- Normat e interesit
- Yield-i i bonove të thesarit
- Treguesi i inflacionit.

Neni 161 i Kushtetutes:

1. Banka Qendrore e shtetit është **Banka e Shqipërisë**. Ajo ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të monedhës shqiptare, të zbatimit të pavarur të politikës monetare dhe **të mbajtjes e të administrimit të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë**.
2. Banka e Shqipërisë drejtohet nga një këshill, i cili kryesohet nga Guvernatori. Ai zgjidhet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje

Banka e Shqiperise

Ligj nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"

- **Ky është ligji kryesor për organizimin dhe funksionimin e Bankës së Shqipërisë si Banka Qendrore në Republikën e Shqipërisë.**
- Me këtë ligj sanksionohet **pavarësia e Bankës së Shqipërisë** dhe përcaktohen objektivat e Bankës së Shqipërisë dhe kompetencat e saj ligjore.
- Ligji përcakton se Banka e Shqipërisë është e pavarur nga çdo pushtet tjetër për realizimin e objektivit kryesor të veprimtarisë së saj, si dhe në ushtrimin e detyrave të ngarkuara. Banka e Shqipërisë sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, përgjigjet para Kuvendit të Shqipërisë dhe ka si **objektiv kryesor arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.**
- **Ligji përcakton statusin juridik të Bankës së Shqipërisë si person juridik publik**, përcakton drejtimet kryesore të veprimtarisë, funksionin dhe qëllimet e saj, dhe përcakton pozicionin e Bankës së Shqipërisë në nivelin e parë të sistemit bankar **duke i dhënë kompetencën e organit licencues dhe mbikëqyrës të të gjithë sistemit bankar në Shqipëri.** Në ligj parashikohen të drejtat dhe kompetencat e Bankës së Shqipërisë në kuadër të transparencës së aktivitetit të saj dhe të rritjes së shkallës së pavarësisë, si dhe parashikohen dispozita lidhur me mënyrën e organizimit dhe të administrimit të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë.

Ligj nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"

- **Ligji synon modernizimin e legjislacionit bankar në Shqipëri me qëllim harmonizimin e tij më të drejtën komunitare.** Ai merr në konsideratë detyrimet e Shqipërisë që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në fushën e shërbimeve financiare, në përgjithësi dhe atyre bankare, në veçanti, të cilat kanë të bëjnë me lirinë e themelimit ofrimit të shërbimeve bankare dhe financiare. **Ligji është harmonizuar edhe me direktivat kodifikuese të BE-se në fushën e të drejtës bankare,** si dhe me **Parimet Thelbësore të Bazelit,** duke vendosur kriteret dhe kushtet të qarta për licensimin e bankave dhe degëve të bankave të huaja. Ai është harmonizuar edhe me legjislacionin shqiptar në fuqi **i cili parashikon licensimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve financiare nga autoritete të tjera rregullatore,** siç është edhe **Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, apo Agjencia e Sigurimit të Depozitave.** Një nga risitë kryesore të ligjit është rregullimi i mbikëqyrjes së konsoliduar të grupeve bankare dhe financiare. Për shkak të rëndësisë së këtyre konglomeratëve financiarë, ligji, në rregullimin që parashikon, është mbështetur në praktikën më të mirë të vendeve fqinje dhe atë të BE-se
- **Për rritjen e transparencës së veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë,** ligji parashikon edhe procedurën të qarta të ankimit administrativ ndaj masave administrative që Banka e Shqipërisë merr kundrejt subjekteve që rregullohen nëpërmjet tij. Përcaktimi i këtyre procedurave ofron garanci për mosçenimin arbitrar të të drejtave të subjekteve që preken nga çdo akt administrativ i Bankës së Shqipërisë me karakter parandalues, mbikëqyrës ose ndëshkues, në përputhje me parimet mbi kontrollin e brendshëm dhe atë gjyqësor të akteve administrative të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe në Kodin e Procedurës Civile. (Ligji është shpallur me dekretin nr. 5178, **datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës**).

Banka e Shqipërisë është banka qendrore

- Banka e Shqipërisë u krijua gjatë procesit të tranzicionit me kalimin në sistemin bankar dynivelor dhe me krijimin e hapësirës së nevojshme ligjore për një bankë qendrore, e cila u zyrtarizua me miratimin e ligjit nr. 7559 "Për Bankën e Shqipërisë", (221 prill 1992) . Rishikimet e mëvonshme që iu bënë këtij ligji u hartuan sipas modeleve të vendeve perëndimore e rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë. **Statusi si banke qendrore sanksionohet me tej në nenin 161 të Kushtetutës dhe me ligjin nr. 8269, datë 27.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i cili përcakton objektivat, detyrat, marrëdhëniet me sistemin bankar dhe me shtetin, organizimin dhe drejtimin, pronësinë mbi kapitalin, pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e fitimit.** Banka e Shqipërisë është bankë me kapital tërësisht shtetëror dhe përgjigjet përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ajo mban, në përputhje me ligjin “ Për kontabilitetin” dhe standardet ndërkombëtare, llogari e regjistra, që në çdo kohë duhet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë gjendjen financiare të Bankës së Shqipërisë.
- Në cilësinë e **autoritetit monetar e mbikëqyrës** të vendit, Banka e Shqipërisë gëzon të gjitha funksionet e mirëfillta të një banke qendrore klasike: **Harton, miraton dhe zbaton politikën monetare të vendit, për realizimin e objektivave të së cilës ajo përdor instrumentet e duhura monetare; Ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të kartmonedhes dhe të monedhes kombëtare. Mban dhe administron rezervat valutore. Harton, miraton e zbaton regjimin e këmbimit valutor si dhe politikën e kursit të këmbimit. Licencon ose revokon licencën për ushtrimin e veprimtarisë bankare si dhe mbikëqyr aktivitetin bankar me qëllim sigurimin e stabilitetit të sistemit bankar. Shërben si bankier, këshilltar e agjent fiskal i RSH. Shërben si bankë e bankave të nivelit të dytë. Nxit funksionimin normal të sistemit të pagesave.**
- Banka e Shqipërisë drejtohet nga **Këshilli Mbikëqyrës**, i cili kryesohet nga Guvernatori. Brenda kompetencave të përcaktuara me ligj, ajo është e pavarur nga çdo pushtet tjetër për realizimin e objektivit kryesor të veprimtarisë së saj, si dhe në ushtrimin e detyrave të ngarkuara. Çdo subjekt është i detyruar të respektojë pavarësinë e Bankës së Shqipërisë, të mos kërkojë të influencojë te ndonjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për të cënuar detyrimet e tij ndaj Bankës së Shqipërisë, si dhe të mos ndërhyjë në veprimtaritë e Bankës së Shqipërisë.

Funksionet dhe detyrat te Keshillit Mbikeqyres

Në bazë të ligjit, Këshilli Mbikëqyrës ka kompetencat e mëposhtme:

Të miratojë politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar kufijtë e operacioneve të BSH në treg të hapur, përqindjen e interesave për depozitat në BSH dhe për skontimet dhe huatë ose kreditë e BSH, si dhe të rezervave dhe nivelit të rezervave të detyrueshme që bankat e nivelit të dytë duhet të mbajnë në BSH;

të vendosë mbi regjimin dhe politikën e këmbimeve valutore të Republikës së Shqipërisë, si dhe të miratojë procedurat që përdoren për përcaktimin e vlerës së lekut në raport me valutat e huaja;

të miratojë të gjitha vendimet, rregulloret dhe udhëzimet me zbatim të përgjithshëm, që nxirren nga BSH;

të miratojë të gjitha raportet dhe rekomandimet që BSH i paraqet Kuvendit ose Këshillit të Ministrave;

të përcaktojë vlerën nominale, prerjet dhe konfigurimin e kartëmonedhave dhe monedhave, si dhe kushtet e tërheqjes nga qarkullimi;

të miratojë kreditë ose huatë e BSH për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë;

të miratojë dhe revokojë dhënien e miratimeve paraprake dhe të licencave për ushtrimin e veprimtarisë bankare.

të miratojë skontimin e instrumenteve me maturitet mbi tre muaj nga data e blerjes nga BSH, në zbatim të nenit 32; me pëlqimin e të paktën tre të pestave të anëtarëve të pranishëm të miratojë çdo kredi, hua apo detyrim tjetër të kushtëzuar të BSH për një bankë në zbatim të nenit 16;

- të miratojë statutin dhe rregulloret e brendshme të BSH;
- të vendosë mbi politikat e administrimit në përgjithësi, si dhe të përcaktojë mënyrat ose procedurat e përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë operative të BSH;
- të përcaktojë strukturën organizative të BSH;
- të miratojë emërimet e drejtuesve të departamenteve në BSH, të përcaktojë në përgjithësi kushtet e marrëdhënieve të punësimit në BSH të agjentëve dhe korrespondentëve të BSH;
- të vendosë për hapjen dhe mbylljen e filialeve, degëve ose agjencive të Bankës së Shqipërisë;
- të vendosë mbi buxhetin e BSH;
- të propozojë rritje të kapitalit të BSH dhe të vendosë mbi fondin e veçantë rezervë të BSH, të vendosë mbi të ardhurat neto të BSH, si dhe mbi masën e të ardhurave neto që do të transferohet në rezervë;
- të miratojë raportet vjetore dhe raportet financiare të BSH;
- të përcaktojë letrat me vlerë të borxhit që do të trajtohen si instrumente të përshtatshme për investime nga BSH;
- të vendosë mbi politikat dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës 2012

- Z. Ardian Fullani, Kryetar
Zj. Elisabeta Gjoni, Zëvendëskryetare
Z. Petraq Milo, Anëtar
Z. Dhori Kule, Anëtar
Zj. Ela Golemi, Anëtare
Zj. Ermelinda Meksi, Anëtare
Z. Halit Xhafa, Anëtar
Z. Arjan Kadareja, Anëtar
Z. Adrian Civici, Anëtar

Permbledhje mbi Autoritetin Monetar

Banka e Shqipërisë është Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë e cila nxjerr vendime, rregullore, urdhra dhe udhëzime për zbatimin e dispozitave të ligjit "**Për Bankën e Shqipërisë**" dhe të ligjit "**Për bankat në Republikën e Shqipërisë**".

Aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë dhe që zbatohen nga disa subjekte, publikohen në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë nxjerr akte normative dhe jonormative për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit bankar bazuar në ligj dhe për zbatimin e tij.

Aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë me zbatim të përgjithshëm, miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, si organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i politikave, i administrimit dhe i operacioneve të Bankës së Shqipërisë.

Këshilli Mbikëqyrës i merr vendimet e tij bazuar në objektivat dhe detyrat e Bankës së Shqipërisë, dhe brenda kompetencave të përcaktuara në ligj.

Këshilli Mbikëqyrës miraton të gjitha aktet në zbatim të ligjit dhe të statutit të Bankës së Shqipërisë, për çdo rast që konsiderohet e nevojshme apo e përshtatshme për të administruar veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë.

Bursa e Tiranës

- Bursa e Tiranës është i vetmi treg i organizuar i titujve (letrave me vlerë) në Shqipëri. Themeluar në vitin 2002 në formën e shoqërisë aksionare, Bursa e Tiranës funksionon në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9879 dt.21.02.2008 “Për titujt”.
- Objekti i veprimtarisë së Bursës së Tiranës sh.a është krijimi i një tregu kapitalesh apo titujsh duke krijuar një sistem tregtimi me anë të të cilit “ofertat për shitje, blerje apo këmbim të titujve kryhen apo pranohen rregullisht; oferta apo kërkesat kryhen rregullisht kur janë oferta apo kërkesa të paracaktuara apo janë te pritshme, që rezultojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në bërjen apo pranimin e ofertave për shitje, blerje, apo këmbim të titujve ose; jepet informacion rregullisht lidhur me çmimet dhe shpërblimet që persona apo grupe të veçanta propozojnë apo presin të shesin, të blejnë apo të këmbejnë tituj”

Bursa e Tiranës është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare “për të ushtruar veprimtarinë si treg i letrave me vlerë të borxhit të Qeverisë, të borxhit të shoqërive dhe të aksioneve në Shqipëri” me Nr. Licensë 78/1, datë 13.07.2007, për një periudhë pa afat.

- Nuk ka arritur te behet realisht burse!
- (Para disa vjetesh, ne perpjekje te afrimit te kompanive private drejt listimit ne Bursen e Tiranës, drejtuesit e ketij institucioni kane zhvilluar nje dje takim me kompanite me te medha te biznesit. Presidenti i Dhomes se Tregtise Bregasi: “Tek bursa, ne nuk shohim realisht dhe praktikisht nje nevoje”. Tregu i kapitaleve prej dy vjetesh inaktiv)

Historiku

- **Bursa e Tiranës** është e para bursë e krijuar në Shqipëri. Bursa e Tiranës u krijua fillimisht si **departament i Bankës së Shqipërisë**, me qëllimin për ta shkëputur atë pas një periudhe tranzitore disavjeçare.
- Ajo u organizua si treg i drejtuar nga porosia, dhe aktiviteti i saj bazë konsistoi në **tregtimin sekondar të bonove të thesarit dhe të 5 obligacioneve qeveritare**. Sesionet e tregtimit u zhvilluan fillimisht dy herë në javë, por pas tetorit 1997, sesionet filluan të kryheshin çdo ditë pune dhe si instrumente tregtimi u pranuan bonot e thesarit 3 dhe 6 mujore. Ajo vuri në funksionim dhe tregun primar të bonove të thesarit deri në 1 gusht 1998. Pas kësaj date e në vijim, ankandet kryhen pranë Departamentit të Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë.

Bursa e Tiranës u shkëput përfundimisht nga Banka e Shqipërisë në 1 korrik 2002, për të vijuar me organizimin dhe funksionimin e saj si shoqëri aksionare. Bursa e Tiranës mori licensën përfundimtare si treg titujsh në 1 korrik 2003, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Kjo licensë u rinovua përsëri në vitin 2005 për një afat 2-vjeçar. Në vitin 2007, Bursa e Tiranës u licensua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për një afat të pacaktuar.

Disa institucione te tjera

Sidomos

- **Problemi i konfliktit te interesave** dhe
Inspektoriati i Larte i Kontrollit te Deklarimit te Pasurive
- **Autoriteti i konkurrences**
- **Enti i energjise.**
- **Bursa e Tiranes (!), etj.**

Avokati i Popullit

Gjykata e Larte

Gjykata Kushtetuese

Prokurori i Pergjithshem

Zyra e Administrimit te Buxhetit

Gjyqësor.

Avokati i Prokurimeve (Avokati i Shtetit)

Kontrolli i Larte i Shtetit

Komisioni i Sherbimit Civil

Inspektoriati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive

Autoriteti i Konkurrences

Komisioni i Letrave me Vlere

Entit Rregullator i Telekomunikacionit

Enti Rregullator i Energjise

Enti Rregullator i Ujit

Instituti i Statistikave

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Këshilli Kombëtar i Radios e

Televizionit

KQZ-ja, etj.

V.2. Qeverisja e mirë apo e keqe ekonomike.

Menaxhimi dhe karakteristika baze.

(Zbatimi i ligjit dhe të luftuarit e korrupsionit janë qendrore për rritjen dhe zhvillimin social-ekonomik)

Institutet publike drejtojnë çeshtje publike, menaxhojnë **burimet publike** dhe garantojnë **realizimin e të drejtave të njeriut**. Pikerisht, qeverisja e mire nenkupton atë lloj qeverisje praktikisht të lire nga abuzimi dhe korrupsioni, në respekt të ligjit e procedurave ligjore, të garantimit të lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

Në lidhje me “qeverisjen ekonomike” vlen të konsiderohen:

Zbatimi i ligjit

Barra apo pesha rregullatore

Efektiviteti i qeverisjes

Reagimi dhe përgjegjësia

Stabiliteti politik dhe shmangie e dhunës

Dhe mbi të gjitha:

Kontrolli i korrupsionit

Edhe njehere: Çfare eshte qeverisja ne pergjithesi?

- Ka vite qe termi **qeverisje** e ka rritur frekuencen e perdorimit te tij kur behet fjale per strukturat dhe proceset e perfshirjes se aktoreve te ndryshem qe indikojne apo marrin vendime **mbi ceshtje te rendesise publike**.
- Ne thelb, qeverisja misheron menyren e bashkeveprimit midis njerezve dhe te krijimit te politikave dhe rregullave (ligjeve), qe e drejtojne sjelljen e tyre.

Qeverisja nuk eshte nje sinonim i **termit qeveri**, pavaresisht shfrytezimit te ketij termi “pa kujdes” sepse qeverisja eshte me shume se nje mori zyrtarësh apo trupash te vecante, apo njerezish qe punojne si nje staf qeveritar.

Qeverisja eshte bashkeveprimi midis institucioneve ne perputhje me ligjet e rregullat e miratuara, midis proceseve dhe traditave qe percaktojne menyren sesi ushtrohet pushteti apo fuqia, sesi vendimet e marra kushtezohen me interesat publike dhe po ato private, si qytetaret apo te interesuarit e tjere thone fjalen e tyre.

-2-

- **Ne thelb, qeverisja lidhet me fuqine, me lidhjet apo marrëdhëniet e ndryshme, përgjegjësitë përkatëse: kush e ka ndikimin, cili vendos dhe sa e si vendim-marrësit janë të përgjegjshëm për këtë.**
- **Qeverisja realizohet sapo njërezit organizojnë vetveten- duke zhvilluar në mënyrë formale apo informale rregulla dhe marrëdhënie me njëri-tjetrin në ndjekjen apo realizimin e objektivave dhe qëllimeve të tyre.**
- **Tipet e aktoreve në “lojen e qeverisjes” mund të jenë të shumta dhe të ndryshme, përfshirë agjencitë qeveritare dhe ministritë, autoritetet e zgjedhura lokale apo tradicionale, komunitetet lokale, OJQ-te, biznesi, nga ndermarrjet e thjeshta tek korporatat, strukturat ndërkombëtare, sindikatat, organizatat profesionale, organizimet fetare, edukative apo kulturore, autoritetet ushtarake, zyrtarët politikë apo të partive, etj.**

Instrumenta qeverises

Instrumenta te tille jane ata qe krijojne dhe ruajne kushte nxitese e mbeshtetese per administrime ne fusha te ndryshme.

Ketu futen, p.sh.:

- **Baza ligjore (ligjet);**
- **Politikat dhe elemente e principe te ushtrimit te tyre (si p.sh., roli rregullues e ndertues, gatishmeria e pergjigja, pergjegjeshmeria);**
- **Rregullat (p.sh., koha e shfrytezimit te burimeve ne dispozicion, teknologjia e perdorur dhe niveli i saj, etj.), investimet financiare (ne programe, infrastrukture, etj) ;**
- **Shperndarja e informacionit ne rruge te ndryshme;**
- **Krijim kushtesh per t'u takuar, diskutuar dhe negociuar mbi ceshtje specifike (forume, panele, platforma, etj.);**
- **Krijimi i mundesive materiale dhe administrative;**
- **Programe kerkimi dhe trajnimi;**
- **Forma te ndryshme incentivash dhe dizincentivash, nga detyrimet dhe taksat deri ne njohjen e meritave sociale, ngritjen e nivelit social etj.**

Fuqite (pushtetet) qeverisese

Vetekuptohet se personat pergjegjes per qeverisjen duhet te gezojne apo te mbajne disa pushtete me ane te cilave arrijne te perdorin instrumentat qeverises.


Mund te rradhiten keto fuqi celes:

- **Pushteti apo fuqia rregullatore dhe ajo e planizimit** .
- **Fuqia e shpenzimeve** (e lidhur me menaxhimin e burimeve, infrastrukturen, sigurine publike, zbatimin e ligjit, ruajtjen e mjedisit dhe te shendetit, etj.)
- **Fuqia e gjenerimit te te ardhurave** (si detyrime, taksa, aktivitete sherbimi etj.).
- **Fuqia e futjes ne fuqi** (qe lidhet me ndarjen apo delegimin e aspekteve apo kombinimin e 3 fuqive te para. Kjo perfshin dhe autoritetin e sanksioneve, arranxhimet e kesaj ndarje fuqie, mandatet dhe rregullat operacionale, etj.).
- **Fuqia e marrjes dhe perdorimit te informacionit** (qe lidhet me komunikimin formal apo informal te informacionit ndaj politikave te planifikimit, kerkimit, procesit te vendim-marrjes, monitorimit dhe vleresimit te rezultateve, etj.) Kjo perfshin dhe autoritetin per te zgjedhur formen dhe mjetet me ane te cilave furnizohet nje informacion i tille.
- **Fuqia e zbatimit dhe detyrimit** (qe permban kapacitetin e detyrimit te vendimeve, te ligjeve dhe rregullave me ane te menyrave te ndryshme, perfshire dhe konsensusin social dhe legjitimitetin, mbeshtetjen legale, presionin politik, bile dhe forcen policore e ushtarake).

Sfida ne qeverisje dhe fuqite rregullatore

- Rregullimi mund te marre ngarkese politike**, prandaj shihet shpesh si “nje e keqe e domosdoshme”. Me te lidhen kritika te llojeve te ndryshme:
 - **Teprimi ne sistemin rregullator (ne rregulla dhe procedura)**;
 - Rregullimet, rregullat dhe procedurat jane teper komplekse dhe jo fleksibel;
 - **Rregullimet jane te kaluara ne kohe**, ato nuk reflektojne realitetet e reja te aktivitetit rregullator apo te zhvillimit te teknologjive te reja;
 - **Rregullimet jane te tilla qe shfaqin nje ngarkese te padrejte** (jo te ndershme) ne garen konkrete, perfshire dhe kompetivitetin ne treg;
 - **Rregullimet nuk respektojne te drejtat e pakicave**, interesat dhe nevojat e tyre lokale;
 - Agjensite rregullatore **kontrollohen nga vete ata qe supozohen se duhet t'i nenshtrohen rregullimit** .
- Agjensite rregullatore synojne te shmangin apo te parashikojne rreziqet e mundshme ne rrafshin publik, social, mjedisor, etj.** Normalisht, rezultatet konkrete te menaxhimit efektiv te riskut nuk mund te demonstrohen aq lehte, madje meqe aksidentet nuk mungojne, te gjitha keto agjensi rregullatore jane krejtesisht vunerabel ndaj kritikave publike apo penalizimit institucional (rasti i fundit shpreh aksionin legal ndaj “neglizhences rregullatore”).
- Rregullimi efektiv ka te beje dhe me zgjedhjen.** Ne mungese te burimeve te pamjaftueshme duhet te rregullohet shtrirja dhe cilesia e aktivitetit duke e inspektuar dhe realizuar monitorimin e saj. Pra, rregullimi efektiv eshte i lidhur keshtu me ushtrimin e diskrecionit ne zgjedhjen e zgjidhjeve, te sanksionit konkret ne vargun e sanksioneve duke u nisur nga masa paralajmeruese (e dokumentuar), nga pezullimi apo largimi nga detyra, pezullimi i licenses, etj., deri tek procedimi civil apo kriminal. **Nese diskrecione te tilla nuk trajtohen me kujdes e drejtesi**, ato mund te provokojne abuzime jodemokratike te fuqise, perfshire dhe shfaqje te drejtperdrejta te korrupsionit politik dhe administrativ.

Karakteristika te qeverisjes se mire.



Per nje qeverisje te mire apo te keqe

Qeverisje e keqe

Ineficiencia

Korrupsion/Manipulim

Harxhim pa nikoqirllak

Furnizimi i nje sherbimi te dobet

Mungese pergjegjshmerie

Koordinimi i dobet

Qeverisje e mire

Pjesemarrja/Ndertimi i konsensusit

Transparenca

Equity (barazia, drejtesia, paanesia)

dhe Perfshirja

Efektiviteti/Eficiencia/Pergjigjshmeria

Pergjegjshmeria

Marrja e informacionit

Zbatimi i ligjit

Permiresim qeverisjeje

Minimizohet korrupsioni

Burimet publike menaxhohet ne menyre eficiente

Merren parasysh mendimet e pakices

Degjohen ne vendim-marrje zerat e grupeve me vulnerabel ne shoqeri

Fuqizohet ndertimi i konsensusit

Minimizohet abuzimi prej autoritetit

Pjesemarrja

- Pjesemarrja, duke respektuar **barazine gjinore**, eshte nje gure prove i nje qeverisje te mire. Pjesemarrja eshte **ose e drejtperdrejte ose nepermjet institucioneve legjitime ndermjetese e perfaqesuesve te tyre**. Eshte e rendesishme te nenvizohet se demokracia perfaqesuese nuk nenkupton patjeter qe shqetesimet e pjeses vunerabel ne shoqeri do te merren domosdo ne shqyrtim e konsiderate ne vendimmarrje.
- Vete **pjesemarrja lidhet ngushte me informimin dhe organizimin**. Kjo nenkupton lirine e asocimit (bashkimit) dhe te shprehjes nga njera ane dhe te nje shoqeri civile te organizuar nga ana tjeter.

Zbatimi i ligjit

- Qeverisja e mire kerkon nje sistem legal dhe demokratik qe zbatohet **ne menyre neutrale**. Ajo kerkon po ashtu mbrojtjen e plote te drejtave te njeriut, vecanerisht atyre te **grupeve pakice, minoriteteve**. Ky zbatimi i tille i paanshem i ligjit kerkon **nje gjyqesor te pavarur** dhe nje **force policore jopartizane, neutrale** dhe **te pakorruptuar**.

Transparenca, Efektiviteti dhe eficienca.

- **Transparenca.** Transparenca nenkupton qe vendimet e marra, ushtrimi dhe zbatimimi i tyre jane te tilla qe te respektojne ligjet dhe rregullat. Po ashtu, ajo nenkupton se informacioni mund te merret lirisht, madje ai arrihet ne menyre te drejtperdrejte nga ata qe preken nga vendime te tilla dhe zbatimet e tyre. Ne kete kuptim nje informacion i mjaftueshem, per me teper dhe ne trajte te kuptueshme, duhet te vihet ne duar te medias.
- **Efektiviteti dhe eficienca.** Qeverisja e mire nenkupton qe proceset dhe institucionet te arrijne te prodhojne rezultate qe u pergjigjen nevojave te shoqerise, duke shfrytezuar sa me mire dhe drejte **burimet ne dispozicion te tyre**. Koncepti i **eficiences (rendimentit)** ne kontekstin e qeverisjes se mire mbulon po ashtu shfrytezimin e qendrueshem te burimeve natyrore, perfshire dhe **mbrojtjen e mjedisit**.

Qeverisja e orientuar nga konsensusi. Paanesia (drejtesia) dhe perfshirja.

- **Konsensusi.** Ka disa aktore te ndryshem dhe mjaft pikepamje brenda nje shoqerie. Qeverisja e mire kerkon **mediatim**, nje **ndermjetesim** te interesave te ndryshme ne shoqeri per te arritur nje **konsensus** sa me te gjere brenda saj, sidomos mbi ato ceshtje qe jane dhe interesi me i mire i te gjithe komunitetit, por dhe si mund te arrihen te zgjidhen apo realizohen ato. Ajo kerkon po ashtu dhe nje perspektive sa te qarte, po aq te gjere dhe nje shtrirje kohe mbi gjithcka qe nevojitet per nje zhvillim njerezor te qendrueshem, menyren e arritjes se qellimeve te duhura ne kete zhvillim. **Kjo mund te arrihet, mbi te gjitha, duke kuptuar mire kontekstet historike, kulturore dhe sociale te nje shoqerie apo komuniteti.**
- **Paanesia, drejtesia dhe perfshirja.** Nje shoqeri e drejte eshte ajo qe garanton te gjithe anetaret e saj qe ta ndjejne veten pjese te kesaj shoqerie dhe mbi te gjitha mos e ndjejne veten te perjashtuar nga rrjedhjet kryesore shoqerore. Kjo kerkon qe te gjithe grupet, vecanerisht ata me vunerabel te kene shanset e tyre per te permiresuar apo ruajtur mireqenien e tyre.

Responsabiliteti. Pergjegjshmeria dhe dhenia ne kohe e pergjigjes

- **Responsabiliteti.** Qeverisja e mire kerkon qe institutet dhe proceset t'u sherbejne apo t'u pergjigjen me korrektesi te gjithe aktoreve brenda nje kohe te arsyeshme.
- **Dhenia ne kohe e pergjigjes.** Edhe dhenia e pergjigjes eshte nje kerkese celes e nje qeverisje te mire. Jo vetem institucionet qeveritare por po ashtu dhe sektori privat apo organizatat e shoqerise civile duhet te jene **sa te pergjegjshme po aq te afta per pergjigje** ndaj publikut (per t'iu pergjigjur publikut) dhe partnereve perkates institucionale.
- Cili eshte pergjegjes ndaj nje tjetri varet nga llojet e vendimeve apo te aksioneve te ndermarra, qe mund te rezultojne te brendshme apo te jashtme ne lidhje me nje organizate apo institucion. Ne pergjithesi, per nje qeverisje te mire, nje organizate apo nje institucion duhet te jene te pergjegjshem ndaj atyre qe afektohen (preken) nga veprimet apo aksionet e saj.
- **Pergjegjshmeria nuk mund te arrihet apo detyrohet pa transparence dhe zbatim ligji.** Ajo mund te jete sociale po ashtu financiare.

Permiresim i qeverisjes

- **Kur minimizohet korrupsioni:**
- • **Burimet publike menaxhohen ne menyre eficiente**
- • **Merren ne shqyrtim pikepamjet e pakices. • Degjohet zeri i grupeve vunerabel ne shoqeri ne procesin e vendim-marrjes**
- • **Fuqizohet ndertimi i konsensusit**
- • **Minimizohet abuzimi i autoritetit**

Perfundime

- Eshte e qarte se nje qeverisje e mire eshte **ideale**, prandaj dhe eshte e veshtire te arrihet ne ndertimin apo plotesine e saj, por vecse mund te realizohen **pamje te vecanta te saj**. Shume pak vende dhe shoqeri mund t'i afrohen realizimit ne teori dhe praktike te **qeverisjes se mire ne teresine e saj**. Sidoqofte, per te garantuar nje zhvillim njerezor te qendrueshem nevojiten **aksione konkrete ne funksion te ketij ideali**, duke progresuar ne menyre te panderprere, ne cdo moment kohor dhe pozicionim hapesinor, drejt arritjes se ketij realiteti.
- Dhe, mbi te gjitha, duke arritur nje permiresim te vazhdueshem te qeverisjes si ne **perspektiven e procesit** (pergjigjes, drejtesise e barazise, por dhe koston) ashtu dhe ne **perspektives se rezultatit** (efektivitetit, arritjes se synimeve te deshiruara)

Strategji për qeverinë e mirë dhe antikorrupsionin

Kontroll e balancim:

Gjyqësor i pavarur dhe efektiv
Decentralizim me përgjegjësi

Përgjegjësia e lidershipit politik

Votimi parlamentar
Transparencë në financimin e partive
Deklarimi i të ardhurave
Konflikti i interesave

Shoqëria Civile:

Liria e informacionit
Dëgjimi publik i draft-ligjeve
Monitorim nga media/OJQ-të

Qeverisje
e mirë
dhe
e pastër

Kompetiviteti:

Konkurrenca
Ristrukturimi i monopoleve
Thjeshtime rregullatore

Administrata publike dhe financat publike

- Shërbimi civil meritokratik
- Remunerim (*Remuneration*) transparent dhe adekuat
- Përgjegjësi në shpenzime (thesari, auditimi dhe prokurimi)

Dy strategji operacionale emergjente

Shqipëria


- Reformë në drejtësi
- Tatimet dhe doganat
- Standarde për kujdesin shëndetësor
- Hyrja dhe studimet universitare (+)
- Monitorimi nga OJQ-të

Gjeorgjia

- Reformë rregullatore
- Tatimet dhe doganat
- Prokurimi publik
- Menazhimi fiskal
- Zëvendësimi i gjykatësve
- Monitorimi nga OJQ-të

Korrupsioni në vite

(Disa vende të zgjedhura, në shkallëzimin 0-10)



Qeverisja kombetare: sfida ne perfshirjen e anti-korrupsionit ne nje strategji ndryshimesh institucionale

Nje formule qe pasqyron nje sinteze-**qeverisje/antikorrupsion:**

$$\text{IG dhe AC} = \text{KI} + \text{LE} + \text{CA}$$

Permiresimi i qeverisjes (**Improving Governance: IG**) dhe antikoorrupsioni (**Anti-Corruption: AC**) =

= Njohje/ Te dhena (**Knowledge/**

Info.Data: KI) + ...

...+ Udheheqje (**Leadership (incl. Political): LE**) + ...

... + Veprim kolektiv apo ndryshim

(**Collective Action (change): CA**).

V.3. Qeverisja ekonomike dhe rritja e qendrueshme.

- **Standardi i jetesës** varet shumë nga rritja ekonomike.
- **Vendet e pasura** janë të pasura sepse ata **kanë pësuar një rritje të shpejtë në periudha relativisht të gjata.**
- **Vendet e varfra** janë të tilla sepse ato **nuk kanë patur një rritje relativisht shpejt nga ana ekonomike.**
- **Por pse ndodh kjo? Pse, p.sh., Tajlanda e la shumë prapa Zambia-n në një gjeneratë?** Tailanda dhe Zambia kane patur nje nisje te njejte dhe kane vazhduar rritjen e tyre te vecante. Tailanda ndoqi nje rruge “politikash miqesore”, duke e nxjerr ne pah tregun e lire, stabilitetin, siper marrjen private dhe edukimin.
- **Argjentina dhe Suedia kane ecur paralelisht ne periudhen 1900-1930, pastaj u zhvilluan ndryshe.** Suedia ndoqi rrugen e tregtise se lire, demokracine liberale, me prirje sociale per te ardhura te barabarta, dhe duke shmangur inflacionin e larte. Argjentina deri me grusht shteti!

Çfare e ben nje vend qe te rritet me shpejt dhe me mire?

- **Eficienta ekonomike**

Politikat ekonomike dhe institucionet perkatese

Edukimi dhe perkujdesi shendetesor

Qeverisja e biznesit (p.sh., tek ne Dhoma e Tregtise dhe Industrise. Konfindustria, etj...)

Politikat monetare dhe financiare (fiskale) dhe institucionet perkatese

Qeverisja e jashtme apo “**qeverisja globale**” (FMN, BB, OBT; etj.). Bashkeveprimi me te.

Eficiencia dhe rritja

- Ne pergjithesi, output-i per fryme varet nga sasia dhe cilesia e input-eve.
- Sasia e input-eve mund te rritet me ane te akumulimit, sidomos **akumulimit te kapitalit**.
- Cilesia e input-eve, produktiviteti i tyre, mund te rritet me ane te eficiences apo rendimentit ne pergjithesi. Ketu perfshihen:
 - Edukimi dhe shendeti
 - Liberalizimi
 - Stabilizimi
 - Privatizimi
 - Aspekte institucionale

Politikat konkrete

Perse?

- Output-i prodhohet **nga puna, kapitali** dhe inpute te tjera.
- Output-i per fryme (per capita) mund te rritet nepermjet akumulimit te kapitalit me ane te kursimeve dhe investimeve.
- Output-i per fryme, jo patjeter mund te rritet me **rritjen e popullsise**, perkundrazi.
- Output-i per fryme mund te rritet me ane te permiresimeve ne pune, si te investimeve fizike (**hardware**) ashtu dhe atyre ne kapitalin njerezor (**software**); ketu futen: **edukimi, por dhe kujdesi shendetesor**
 - Investimi fizik dhe edukimi jane çesesa te rritjes. Por, krahas edukimit dhe kujdesi shendetesor ka vleren e tij ne rritjen e produktivitetit te punes. (Rasti i Kines!)
- Edhe **progresi teknologjik** eshte i domosdoshem per rritjen
 - Progresi teknologjik** ua mundeson kompanive rritjen e output-eve per inpute te dhena. Por kjo rrit **eficiencen apo rendimentin!**
 - **Feed-back** (ushqimi i kundert): Rritja e eficiences rrit kerkesen per progres teknologjik, gje qe ndihmon me tej rritjen ekonomike.

Institucionet dhe “gjeografia”

– Krahas nderlidhjes midis iniciativave private (investimeve, fertilitetit) dhe politikave publike (edukimit, kujdesit shendetsor, liberalizimit, stabilizimit, privatizimit), nje vlere te rendesishme kane dhe:

• Institucionet e gjeografia

– Institucionet (perfshire dhe aspekte te kapitalit social)

- Korrupsioni
- Pabarazia
- Demokracia liberale

– “Gjeografia”

- Lendet e para, prodhimi primar (bujqesia, mineralet, etj.)
- Burimet natyrore

• Institucionet apo “gjeografite”?

– Kontrasti fallco

– **Ka hapesire per te dyja...**

**“Rritja ekonomike eshte e vlefshme per te gjithë ata
qe perpiqen per ta arritur ate” (Lewis).**

Nje rritje e cilesise se larte kerkon **akumulimin e kapitalit,
po ashtu dhe **eficiencen ekonomike** nepermjet qeverisjes se
mire:**

**- Politikes se ndershme ligjore dhe institucioneve te
shendetshme.**

– Edukimit, planifikimit familjar, kujdesit shendetsor

**– Tregtise e lire, çmimeve te qendrueshme, zhvillimit te
shendetshem te siper marrjes private.**

– Ndershmerise, barazise, lirise, demokracise.

Jo varesi e tepruar nga bujqesia dhe burimet natyrore!

**Nje vlere konkrete ka dhe menaxhimi! Pra, ja vlejne disa
komente per vleren dhe rolin e menaxhimit ne qeverisje**

Probleme menaxhimi

Menaxhimi i sistemeve apo proceseve qe krijojne te mira materiale, qe prodhojne mallra dhe/ose furnizojne sherbime




Prodhimi i mallrave dhe furnizimit i sherbimeve

1. Prodhimi i mallrave- rezultat material,
2. Furnizimi (realizimi) i sherbimeve- veprim

Kategori sherbimesh:

- Qeveritar (ne kuader te qeverisjes)
- Tregtar
- Financiar, bankar
- Kujdesi shendetesor e ushqimor
- Sherbim personi
- Sherbim biznesi
- Edukimi
- Kontrolli mjedisor

Manufakturim apo sherbim



Pergjegjesite operationale

Planizimi:

Kapaciteti, Lokalizimi, Prodhime&Sherbime, prodhon (shet) apo blene, shtrirja, projektimi, afatet.

Kontrolli/Permiresimi:

Inventarizimi

Cilesia

Kostoja

Produktiviteti

Organizimi:

Shkalla e centralizimit

Perzgjedhjet e proceseve

Stafi:

Seanca degjimore, konkursi
rekrutim ne prove, etj.

Drejtimi:

Percaktimi i detyrave dhe pergjegjesive per cdo vend pune

Incentimi

Garancia (siguria ne pune)

Zbatimi i urdherit, disiplina

Faktore celes te jashtem

Kushtet ekonomike

Kushtet politike

Mjedisi legal

Teknologjia

Konkurenca apo kompetiviteti

Tregjet

Faktore celes te brendshem

Burimet njerezore

**Lehtesite (facilitetet) dhe pajisjet
(makinerite)**

Burimet financiare

Klientet

Prodhimet dhe sherbimet

Teknologjia

Furnizuesit

Fokusimi mbi cilesite apo kohezgjatjen

-Fokusimi ne ruajtjen apo permiresimin e cilesise se prodhimit apo te sherbimit

Cilesia ne burim!

-Fokusimi ne reduktimin e kohes se nevojshme per kryerjen e detyres

Produktiviteti

Produktiviteti:

-Nje mase apo **matje e perdorimit efektiv** te burimeve, zakonisht te shprehur si **raport i outputit mbi inputin**, i daljes (rezultatit) mbi hyrjen (dhenien)-

$$\text{Produktiviteti} = \text{Outpute/Inpute}$$

Ky raport shfrytezohet per

- Per te planizuar kerkesat per fuqine punetore
- Per afatet dhe kerkesat e pajisjeve (makinerive)
- Per analizen financiare

Masa (matja) totale e produktivitetit

Matje (mase) pjesore

- output / input i vetem

Matje (mase) shume-faktoriale

-output / inpute te shumefishta

Matje (mase) e plote

- output / inpute te plota

Masa
parciale

Output/puna Output/makineria Output/kapitali Output/energjia



Masa
shumefaktoriale

$\text{Output}/:(\text{puna}+\text{makineria})$ $\text{Output}/:(\text{puna}+\text{kapitali})$

Masa totale

$(\text{Mallra dhe sherbime te prodhuara}) /$
 $/(Te gjitha inputet e shfrytezuara)$

Faktoret që afektojnë produktivitetin



V. 4. Korrupsioni

- **BB-ja e përcakton korrupsionin si keqpërdorim të pushtetit publik për qëllime private.**
- **Po ashtu mund të veçohen: **Korrupsioni pasiv dhe Korrupsioni aktiv****
- **Është vështirë të matet ai në mënyrë të drejtpërdrejtë, në sajë dhe të natyrës së fshehtë dhe të pandershme.**
- **Shfrytëzohen tregues të ndryshëm midis tyre:**
Indeksi i perceptimit të korrupsionit CPI (Corruption Perceptions Index nga Transparency International); Raporti i konkurrencës globale GCR (Global Competitiveness Report), ICGR-ja (International Country Risk Guide); BI (Business International Index), BEEPS (Business Environment and Enterprise Performance Survey) etj.

Disa pyetje

- **Cili korrupcion?**

Kompanitë, korporatat shumëkombëshe, krimi i organizuar, zyrtarë dhe lidhjet e tyre, miqtë apo familjarët

- **Cili korruptohet?**

Shtetarë të pandershëm, zyrtarë të paguar keq, të pavlerësuar, të pamotivuar politikisht, apo të mbeshtetur politikisht etj.

- **Si?**

Duke marrë një vendim politik në favor, duke mos hapur garën apo konkursin, etj.

- **Cilat kushte favorizojnë korrupsionin?**

Korrupsioni si praktikë biznesi. Rushfeti gjoja si shenjë respekti, etj.

- Korrupsioni dhe praktikat e biznesit
- Diferencat kulturore

Nje problem “informacioni”!

-Korrupsioni ne pjesen me te madhe te tij zhvillohet ne “erresire”!...

Ai pothuajse gjithmone shfaqet dhe si nje problem “**informacioni**”, prandaj duhet siguruar dhe informimi sa me i shpejt, me adekuat, sa me i duhur ne luften kunder tij.

Dy tipe të përgjithshme të korrupsionit sipas BB-së

Kapja e shtetit:
Veprimi i individëve, grupeve apo kompanive ndikon fuqishëm në hartimin e ligjeve, akteve ligjore dhe ndërligjore, dekreteve apo politikave të tjera qeveritare në avantazhin e tyre , duke shfrytëzuar mjete financiare ndaj zyrtarëve publikë.

Korrupsioni administrativ:
Distorcion i ligjeve ekzistuese, rregullave dhe rregullimeve në përfitim të agentëve të shtetit apo jashtë tij, nëpërmjet lubrifikimit të zyrtarëve publikë. P.sh., evazioni fiskal, mitmarrja në shërbime të ndryshme.

- **Kapja e shtetit:**
 - Veprimi i individëve, grupeve apo kompanive ndikon fuqishëm në hartimin e ligjeve, akteve ligjore dhe ndërligjore, dekreteve apo politikave të tjera qeveritare në avantazhin e tyre , duke shfrytëzuar mjete financiare ndaj zyrtarëve publikë.

- **Korrupsioni administrativ:**
 - Distorcion i ligjeve ekzistuese, rregullave dhe rregullimeve në përfitim të agentëve të shtetit apo jashtë tij, nëpërmjet lubrifikimit të zyrtarëve publikë. P.sh., evazioni fiskal, mitmarrja në shërbime të ndryshme.

Korrupsioni politik

- Që në kohën e Aristotelit, grekët e lashtë e kuptonin korrupsionin si shmangie nga skema e shëndetshme e qeverisjes. Po kështu, **tirania shihej si një monarki e korrumpuar**, ku monarki nuk shqetësohej më për mirëqenien e qytetarëve të tij, por për favoret e qejfet e veta. **Në këtë kuptim korrupsioni konsiderohej dhe si problem i rënies apo degradimit moral.**
- Për të kuptuar thelbin e korrupsionit duhen konsideruar dhe dy aspekte bazë: **motivet dhe pasojat**. Motivi i korrupsionit politik është **pasuria, statusi apo pushteti**, bile në mënyrë më specifike vet-pasurimi, indulgjencia ndaj vetes apo **ruajtja me çdo mjet (përfshirë atë material) e pushtetit**. Bile, për këto arsye, shqetësimi për grekerit e vjetër ka qenë fokusimi tek **vlerësimi i përfitimit kolektiv, përkundër atij privat**. Pasoja të korrupsionit politik janë degradimi institucional, pushteti arbitrar, tendencat autoritare dhe reduktimi i lirive.
- **Korrupsioni politik kap nivelin e lartë të sistemit politik** (politikanët e lartë, ministrat dhe drejtuesit e shërbimeve publike kryesore, të zgjedhurit politikë apo të strukturave të tjera). Ai ndeshet si në **aspektin ligjor** (legjislativ), ashtu dhe në atë të **zbatimit** (ekzekutiv). Si proces, korrupsioni politik favorizon elitat e veta ekzekutive-legjislative në mënyrë individuale e kolektive.

Pra, korrupsioni politik qe arrin deri ne **kapje te shtetit** kap nivelet e larta të politikës, të sistemit politik. Ai dallohet nga korrupsioni administrativ apo burokratik (Ky i fundit ndeshet në pjesen fundore, ne skajet e implementimit të politikës, p.sh., në shërbime të tilla si edukimi e shëndeti). **Pra, korrupsioni politik bën formulimin e politikës, ku merren vendimet e shpërndarjes së pasurisë kombëtare dhe të rregullave të kërkuara.**

Tipologji të rrezikshme të korrupsionit

- **Korrupsioni tradicional qeveritar.**
- **Korrupsioni kriminal.**
- **Korrupsioni qeveritar- sipërmarrës.**

Pamje konkrete të korrupsionit në Shqipëri.

Korrupsioni politik - Korrupsioni zgjedhor

Korrupsioni administrativ (evazioni fiskal, rushfeti apo mitmarrja, abuzimi në tenderim apo prokurim, etj.)

Korrupsioni kapilar

Dy mekanizma të luftës kundër korrupsionit politik-burokratik:

Konflikti i interesave

Deklarimi i pasurisë

Efekte negative të korrupsionit

- **Vonesa** në prodhimin ekonomik dhe rritjen ekonomike
- Zvogëlohen **FDI** (Foreign Direct Investment)
- Bie indeksi **HDI** (Human Development Index)
- Dëmton sipërmarrësit dhe **bizneset e vogla**
- Prek cilësinë e **informacionit të tregut**
- Favorizon **një pabarazi** ekstreme sociale
- Trondit thellë **besimin** publik ndaj qeverisë dhe gjykatave.

Godet sipërmarrësit, bizneset e vogla dhe inovimin


- Firmat e reja nuk i kanë ende lidhjet politike dhe ekonomike të firmave të mëdha.
- Të dhënat e shumicës së ekonomive në tranzicion dëshmojnë se **ndërmarrjet e vogla paguajnë në mesatare dy herë më shumë se të ardhurat e tyre vjetore në trajtë rushfeti, bile shumë më shumë përkundrejt kompanive të mëdha.**

Një kërcënim në vete është korrupsioni në tenderat publikë.

- Bizneset e vogla janë thelbësore në ndërtimin e infrastrukturës së tregut në ekonomitë e tranzicionit.
- Duke dekurajuar sipërmarrjen dhe reduktuar fuqinë legale të patentave, **korruptsioni godet dhe shpirtin e inovacionit, të ndryshimit.**
- Favorizon **përqendrimin** e pasurisë vetëm në duar të disa pronarëve shumë më të pasur.


Distorcione të sinjaleve të tregut

Figure 14. Transition Economies: Genuine Saving and Corruption



- Korrelacion negativ midis kursimeve shtëpijake dhe korrupsionit.
- Të dhënat ekonomike janë të pakoordinuara në sajë të evazionit fiskal, prokurimeve qeveritare, subvencioneve qeveritare të korruptuara apo keq-reportimit të qëllimshëm.

Mban apo ruan pabarazinë



Grafik i BB-së që ilustron korrelacionin midis niveleve të larta të korrupsionit dhe pabarazisë së shprehur me anë të koeficientit Xhini (Gini): 0 është barazia perfekte në të ardhura dhe 1 pabarazia e absolute

Efekte psikologjike

- Përveç efekteve të dëmshme të korrupsionit në planin ekonomik, me efekt negativ është dhe **ai i humbjes së besimit** të popullit ndaj qeverisë dhe zbatimit të ligjit.
- Publiku e percepton korrupsionin të ushqyer apo të zhvilluar brenda sistemit bazë institucional.
- Ky korrupsion minon **integritetin e qeverisjes**, të shërbimeve juridike, policisë, atyre mjekësore dhe edukative, etj.

Hartimi dhe zbatimi i kodit etik dhe krijimi i agjensive anti-korrupsion
Nje sistem “check-balance” ne kontrollin e menaxhimit, monitorim brenda sektorit (publik apo privat), monitorim nga media, etj.

Rrjedhoja dhe kosto te korrupsionit: Te ardhura te uleta, investime te dobta, varferi dhe pabarazi. **Por jo qe duke permiresuar qeverisjen mund te arrihet gjithcka “brenda nje nate”!.**

Percaktues te korrupsionit:

- **Kapja dhe perfshirja e interesave personale apo kolektive (politike, financiare , etj.**
- **Mungesa e zerit, dhe liria e vaget e shtypit, devolucioni dhe transpareenca**
- **Duhet te gjendet ekuilibri sa me i drejte midis derregullimit dhe rregullimit (rreziku i mbirregullimit ne luften kunder korrupsionit). E kunderta incentivat dhe transpareenca.**
- **Porfesionalizem i ulet i sherbimit publik apo mangesi apo mungesa ne drejtim (leadership)**

Paradoks apo fshehje: Pretendimi apo Perdorimi i “ilaceve magjike”!?

Sinteze: Nje reforme me 7 pika

1. **Reduktime te domosdoshme** ne rregulla (ne sistemin rregullator apo reduktimin e pengesave ndaj biznesit)
2. Reforma madhore ne lidhje me transparencen: ne planin politik, financiar, fiskal, ekonomik, transparence nepermjet internetit, monitorimit te dhenave, aktivizimit te medias.
3. **“Zeri qytetar”**: pjesemarrja poshte siper, vezhgimi nga qytetaret, OJQ-te, sondazhet, etj.
4. Depolitizimi dhe reforma e Sherbimit Civil
5. Reforma ne drejtesi
6. Pergjegjesia dhe kontrolli i llogarive ne kompanite e medha.
7. Roli i vendeve te pasura dhe i Institucioneve Financiare Nderkombetare: **Pergjegjesia kolektive.**

Lufta kundër korrupsionit

- Shumë organizata ndërkombëtare janë angazhuar në luftën kundër korrupsionit. Midis tyre janë p.sh. :
- Inisiativa Etike Globale (Ethical Globalization Initiative),
- Kontrata globale e OKB-së (UN-Global Contract),
- Organizata Botërore e Tregtisë - OBT (World Trade Organization-WTO),
- Banka Botërore BB (World Bank, WB)
- Inisiativa e stabilitetit në BE (EU - Stability Initiative),
- US (MilleniumCA),
- Fondi Monetar Ndërkombëtar - FMN (International Monetary Fund-IMF).
- **Ka përfitime ekstensive kur njerëzit e besojnë integritetin e qeverisjes, sidomos në ekonomi.**

Konventa OECD per luften kunder mitmarrjes e zyrtareve te huaj ne Transaksionet e Biznesit Nderkombtar, adoptuar me 1997, hyre ne fuqi 1999

- **Qellimi i Konventes:** Per te niveluar dhe balancuar fushen e lojes ne bashkeveprimin nderkombetar.
- **Perafrimi baze:** Adoptimi per vendet anetare i FCPA (FOREIGN CORRUPT PRACTICES ACT, ANTIBRIBERY PROVISIONS, Foreign Corrupt Practices Act of 1977 ("FCPA"), 15 U.S.C. §§ 78dd-1, *et seq.*,)
- **Probleme te pikenisjes:** (i) prioriteti i ulet,; (ii) mungesa e informacionit; (iii) pasojat ne te ardhmen.
- **Pasoja praktike:** (i) shtetet jo anetare te OECD-se (ii) organizatat nuk jane aktore unitare, (iii) mungesa e kultures kooperative te pajtimit dhe zgjidhjeve reciproke.
- **Mitmarrja eshte vetem nje pjese e vogel e problemit te korrupsionit.** ("Master of the Universe" Phenomenon).

Konventa civile mbi korrupsionin (Keshilli i Evropes 1999)

- **Artikulli 2 – Korrupsioni (eshte perkufizuar ne menyre te gjere).**
- **Artikulli 3 – Kompensimi per demet.**
- **Artikulli 4 – Detyrimi.**

Konventa e OKB-se kunder korrupsionit (perfunduar me 2003, hyre ne fuqi ne dhjetor 2005)

- **Artikulli 1 – Perkufizime (nuk perkufizohet korrupsioni).**
- **Artikulli 34 – Shtetet duhet te anulojne apo rishqyrtojne kontratat e fituara si rezultat i korrupsionit, si rrjedhoje e Akteve te Koorupsionit.**
- **Artikulli 35 i ketij instrumenti u kerkon paleve te adoptojne masa konkrete per te kompensuar viktimat e korrupsionit.**

Rekomandime të TI-së në luftën kundër korrupsionit

- ***Përgjegjshmëria Politike***- Financim transparent i partive politike, konflikti i interesave, deklarimi i pasurisë (aseteve).
- ***Spektori kompetitiv privat*** – Liberalizim, reforma të politikës ekonomike, thjeshtëzim rregullash, sidomos për firmat e reja, transparencë në qeverisjen e korporatave.
- ***Pjesëmarrje e shoqërisë civile***- Liri e informacionit, media neutrale, reagimi sindikalist dhe pjesëmarrje demokratike
- ***Kufizimet institucionale*** – Gjyqësor efektiv dhe i pavarur, rishikimi legjislativ, penalizimi i pavarur.
- ***Menazhimi i sektorit publik***- Shërbim civil meritokratik, pagesë e drejtë, decentralizim autoriteti
- **Menazhimi i buxhetit (parashikimi dhe kontrolli i realizimit, prokurimi, auditimi, reforma e taksave)**

Një mision global

- **BB-ja, sic u theksua me pare, e identifikon korrupsionin si “pengesën më të madhe në lidhje me zhvillimin ekonomik dhe social”**
- **Mision global për çrrënjosjen e korrupsionit është thelbësor për të ardhmen e botës.**
- **Megjithëse një shoqëri e çliruar nga korrupsioni mund të konsiderohet si një ideal utopik, ekonomitë e ndërtuara dhe të zhvilluara në mënyrë demokratike përfitojnë fuqishëm nga çvlerësimi maksimal i aktiviteteve korruptive.**

Mitmarrja dhe korrupsioni.

***-Pengesë serioze ndaj
standardeve demokratike,
zhvillimit në përgjithësi dhe
rritjes ekonomike!***


Disa rezultate të një ankete

Nje “survey” i nje permase te gjere (I realizuar mbi 100 vende World Economic Forum)

- 1. Shtrirja e mites apo e ryshfetit nga kompanite private mbi sektorin publik, si dhe korrupsioni brenda sektorit publik jane te dyja te larta ne mesatare, edhe pse te ndryshme midis vendeve.**
 - 2. Tendencat e 3 viteve te fundit nuk jane permiresuar me tej.**
 - Sidoqofte po skenohet nje sensibilizim politik e institucional, publik e mediatik shume me i larte.**
 - Ne mjedisin e biznesit parashikimet jane me te mira.**
 - Per qytetaret ryfsheti dhe ne pergjithesi korrupsioni eshte nje nga pengesat madhore ndaj zhvillimit dhe rritjes.**
 - Permasat publike dhe private te korrupsionit- sfida teper te rendesishme te dites.**
- Ne vendet e zhvilluara: Fokusi mbi sektorin privat**
- Ne vendet ne zhvillim: Mitmarrja ne sektorin publik dhe ajo: *sektor privat-sektor publik* jane sfida kryesore.**
- Per qeverine : Me teper zbatim dhe forcim ligji & edukim**
- Per qeverine dhe firmat : blokim, zbulim e penalitet**
- Per kompanite: Auditi i brendshem (ne shume raste i pamjaftueshem)**
- Per donatoret dhe BB-ne: Perzgjedhje e rrepte ne fonde kur mungon angazhimi i lidershipit vendor, por te rritet angazhimi ne bashkepunimin e ngushte me vendet donatore ne A/C (ne luften kunder korrupsionit)**

Sondazh me internet – mbi rolin e rendesishem te donatoreve ne luften kunder korrupsionit

(Burimi: BB mbi sondazhin per miniqeverisjen http://www.wbigf.org/hague/hague_survey.php3. 2,839 te anketuar).



Perqindja e te anketuarve qe e konsiderojne rolin e donatoreve si teper te rendesishem

“Mithe” ende per t’u sfiduar

1. **KONSENUSI** mbi qeverisjen e mire per zhvillimin dhe rritjen, konceptuar me thelle qe ne fillimet e viteve 1990-te – *‘Washington Consensus’*
2. **Stabilizim makro dhe rritje e qendrueshme+ reforma te tjera politike ekonomike**
3. **Koorupsion i ulet&Qeverisje e mire: rezultat i zhvillimit dhe rritjes**
4. **Qeverisja eshte permiresuar ne te gjitha hallkat e saja ne shkalle boterore.**
5. **Por qeverisja eshte e “pamatshme”- megjithate eshte e ndjeshme! *Perceptimi edhe pse deri diku mjaft subjektiv i sherben qeverisjes dhe permiresimit te saj. P.sh. CPI.***
6. **Reformim dhe praktika te qeverisjes me te mire. Kode, ligje, rregullime, agjenci te reja, etj.**

Permasa te qeverisjes

Qeverisja si nje bashkesi traditash dhe institucionesh me ane te cilave ushtrohet autoriteti ne nje vend

- **Procesi** me ane te cilit zgjidhen dhe zevendesohen ata qe e ushtrojne kete autoritet
 - Zeri dhe pergjegjesia
 - Stabiliteti politik & mungesa e dhunes/terrorizmi
- **Kapaciteti** i qeverisjes per te formuluar dhe implementuar politikat
 - Efektiviteti i qeverisjes
 - Cilesia rregullatore
- **Respekti** i qytetareve dhe pozicionimi per institucionet qe qeverisin nderveprimet midis tyre
 - Zbatimi i ligjit
 - Kontrolli i korrupsionit

P.sh.:

Besimi ndaj policise → Zbatimi i ligjit

Liria e shtypit → Zeri & Pergjegjesia

Konsistenca politike → Efektiviteti qeveritar

Shtoice: Liria ekonomike

Nder çështje çelës që lidhen me lirinë ekonomike është, se pari, **politika e tregut**, që, ndaj lëvizjes së lirë të mallrave, për asnjë arsye, nuk duhet të jetë një politikë frenuese, me bariera të larta për tarifatat apo kuotat e import-eksportit. Po kështu i rëndësishëm është dhe **problemi i detyrimeve fiskale**, sepse sa më të larta të lejohen kërkesat për detyrime të tilla mbi ekonominë, të cilat maten nga **niveli i taksave dhe i shpenzimeve qeveritare**, aq më e vogël bëhet **liria ekonomike në vend**. Të njëjtin efekt negativ ka dhe shkalla e lartë aktuale e **ndërhyrjes së qeverisë në ekonomi**, veçanërisht përsa i përket përqindjes së lartë të borxhit të brendshëm e konsumit në përqindje të GDP-së, zotërimit shtetëror akoma të përfillshëm mbi **prodhimin, biznesin dhe pronat**. Kjo gjë imponon dhe përshtetimin e **procesit të privatizimit**, e veçanërisht atij strategjik. Jo pa vlerë është dhe **politika monetare**, e cila aktualisht tek ne, në pjesën dërmuese të rasteve, favorizon çmimet e tregut, duke ju dhënë mundësi kështu individëve të gëzojnë liri më të madhe ekonomike. Por dhe për këtë çështje mund të bëhen sugjerime dhe të kërkohen ndryshime ligjore e strukturore përkatëse, shoqëruar këto jo vetëm me **liberalizimin e çmimeve, por dhe të vetë pagave**. Natyrisht një çështje tepër e rëndësishme është dhe **qarkullimi i kapitalit dhe politikat lehtësuese**, antiburokratike e antikorruptive, për investimet e huaja. Kufizimet e qeverisë apo kufizimet ndaj qeverisë, të imponuara pa një diskutim të hapur nga organizma ndërkombëtare, për investimet e huaja, veçanërisht barrierat, “për të qënë brënda”, për kreditë, zvogëlojnë sasinë hyrëse të kapitalit dhe për rrjedhojë dëmtojnë lirinë ekonomike. Përkundrazi, do të ishte llogjike dhe nxitëse lehtësimi i kufizimeve apo heqja e studiuar të tyre për ato investime të huaja, që do të rrisnin drejtpërsëdrejti lirinë ekonomike, pra dhe depërtimin e kapitalit të huaj, veçanërisht për sektorin e prodhimit e atij të turizmit. E njëjta frymë vlen dhe për shërbimet bankare.

Një nga problemet me shqetësuese për realitetin shqiptar dhe lirinë ekonomike është **çështja e pronës**, apo në trajtë të përgjithësuar **e drejta mbi pronën**, si një e drejtë e plotë kushtetuese. Në të vërtetë, për këtë problem nuk mund të justifikohen më vonesat, por kërkohet një rregullim i ri ligjor, në përputhje me Kushtetutën, në respektim të pronës private, përfshirë këtu edhe **pronën intelektuale**, themele këto të domosdoshme për një zhvillim të lirë ekonomik. Nga ana tjetër, dhe **sistemi rregullator qeveritar**, veçanërisht për biznesin, që përmban detyrime të tepruara, nëpërmjet kërkesash mjaft të rrepta apo të përsëritura çdo vit, siç janë p.sh. ato për liçensim, një mori rregullash pune dhe rregullash të tjera të pajustificuara kufizuese, madje me natyrë thjesht burokratike, godasin thelbin e lirisë ekonomike, pra pengojnë drejtëpërsëdrejti apo tërthorazi vetë biznesin, d.m.th. dhe **punësimin** e zhvillimin ekonomik. Të njëjtin efekt negativ ka dhe **tregu i zi**, që cënon jo vetëm lirinë e tregut dhe vetë konkurrencën e lirë, apo thelbin e lirisë ekonomike, por për më tepër dhe funksionimin e **skemave** të sigurimeve e pensionimit.

Kater kategorite dhe “rubikat” baze

- Sipas indeksit ndërkombëtar **katër** kategoritë e mëdha të lirisë ekonomike janë: kategoria e vëndeve ekonomisht **të lira** (me një indeks mesatar të përgjithshëm 1.95 ose më pak); **kryesisht të lira** (me një indeks mesatar të përgjithshëm 2.00 deri 2.95); **akoma jo të lira** (me një indeks mesatar të përgjithshëm 3.00 deri 3.95); **ekonomikisht të ndrydhura** (me një indeks mesatar të përgjithshëm 4.00 ose më shumë).
- **Politikat e tregut, Sistemi bankar e financiar, Pesha fiskale Pagat dhe cmimet, Ndërhyrja e shtetit, Të drejtat mbi pronën, Politikat monetare, Sistemi rregullator, Investimet e huaja, Tregu i zi.**

Per lirine ekonomike dhe ekonomine informale shihni, p.sh., per me hollesisht: R. Meidani, **Politika, Morali dhe Shteti, Toena, 203 , f.119 -137, 192-199.**

Klasifikimi ne 100 pike (dhe rikonsiderim rubrikash)

- Kur treguesi mesatar ndodhet ne intervalin 100-80 vendi perkates konsiderohet **i lire (free)**. Per vlera ne intervalin 79.9-70 eshte **me te shumten i lire (mostly free)**, ne intervalin 69.9-60 **moderisht i lire (moderately free)**, vendi ne intervalin e treguesit mesatar 59.9-50 **me te shumten jo i lire (mostly not free)** dhe vendet me tregues midis 49.9-0 percaktohen si **te shtypur (repressed)**.
- Sipas “Index of Economic Freedom-2009” Shqiperia, Bullgaria, Greqia, Maqedonia, Rumania dhe Sllovenia, jane moderisht te lire (moderately free), kurse vendet e tjera me te shumten jo te lire (mostly not free).

Për një konceptim shumë më ndryshe të “lirisë ekonomike”.

- Liria ekonomike, në një konceptim të thjeshtë, është e drejta bazë e çdo qenie njerëzore për të administruar e kontrolluar punën dhe pronën e vet. Pra, në një shoqëri ekonomikisht të lirë individët janë të lirë të punojnë e prodhojnë, të konsumojnë dhe investojnë në mënyrën sesi u pëlqen atyre, me një nivel lirie sa të mbrojtur nga shteti po aq dhe të pa shtrënguar prej tij. Madje, në shoqëri të tilla puna, kapitali dhe mallrat lëvizin lirshëm, brenda kufizimeve të lirisë, që e mbrojnë atë. 10 faktorët kryesorë të kësaj lirie në nivel kombëtar (sipas *Heritage Foundation/Wall Street Journal*) janë: **liria e biznesit, liria tregtare dhe ajo monetare, përmasa qeveritare, liria fiskale, të drejtat e pronës, liria e investimit e ajo financiare, liria për t’iu kundërvënë korrupsionit dhe liria e punës**. Pikërisht, IEF-ja apo *indeksi mesatar i lirisë ekonomike (Index of Economic Freedom)* është një seri matjesh të tilla ekonomike, që përcaktojnë nivelin e lirisë ekonomike në vendin përkatës. Bile, ky indeks, i perceptuar që më 1995, në thelbin e tij nënkupton: “*formën më të lartë të lirisë ekonomike që përfshin një të drejtë të plotë për pronën private, lirinë maksimale mbi lëvizshmërinë e punës, kapitalit e mallrave, një mungesë maksimale koerciteti e kufizueshmërie të lirive ekonomike, me përjashtim të kushtëzimeve të domosdoshme në mbrojtje të qytetarëve dhe të vetë lirive të tyre*” ... Krahas IEF-së, është formuluar dhe një tregues tjetër i ngjashëm, i quajtur EFW-ja apo *liria ekonomike e botës (Economic Freedom of the World)*.

-2-

- Për llogaritjen e IEF-së, secili nga 10 faktorët e përmendur më sipër matet në një shkallë qindëshe, ku vlera 100 jep lirinë përkatëse maksimale dhe shuma e tyre (e pjesëtuar me 10) jep vlerën mesatare të IEF-së. Sipas kësaj vlere mesatare për çdo vend bëhet dhe kategorizimi mesatar: *i lirë, pothuajse i lirë, me liri të moderuar, pothuajse jo i lirë, jo i lirë dhe i “jo shkallëzuar”*. Sidoqoftë, pavarësisht nga treguesi konkret (IEF apo EFW), liria ekonomike është një kusht i nevojshëm në zhvillimin demokratik. Ajo shpreh çlirimin e njerëzve nga varësia prej qeverisë siç ndodh në rastin e një ekonomie të planifikuar, duke u mundësuar individëve që të realizojnë vendimet e tyre të pavarura apo zgjedhjet e veta ekonomike e politike...

- Sipas Freedom House “**ekziston një korrelim statistikisht i lartë midis nivelit të lirisë politike të matur nga Freedom House dhe të lirisë ekonomike të përcaktuar sipas vrojtimeve të realizuara nga Wall Street Journal/Heritage Foundation**”. Sidoqoftë, të dy treguesit për lirinë ekonomike: IEF-ja dhe EFW-ja janë dy indekse që synojnë të matin shkallën e lirisë ekonomike në nivel kombëtar, njëri në një shkallë qindëshe dhe tjetri në shkallë dhjetëshe. Sa për ilustrim, më poshtë, jepen disa të dhëna të tyre të viteve të fundit.
- Në vitin 2008 (për 157 vende), sipas IEF-së, vendi që vazhdon të rezultojë me liri ekonomike maksimale është Hong Kongu me tregues 90.3 (në totalin e 100 pikëve). Kurse Shqipëria ndeshet në pozicionin e 56-të me tregues 63.3, ndërkohë që për vendet fqinje kemi, përkatësisht, sipas radhitjes: Bullgaria (59) me 62.9 pikë; Italia (64) me 62.5; Rumania (68) me 61.5; Maqedonia (71) me 61.1; Turqia (74) me 60.8; Sllovenia (75) me 60.6; Greqia (80) me 60.1; Moldavia (89) me 58.4; Kroacia (113) me 54.6; Bosnja (121) me 53.7.
- Pak më ndryshe jepen këto të dhëna të IEF-së në “siglën” e vitit 2009 (për 183 vende). Edhe aty në vend të parë është Hong Kong me tregues 90.0 +(0.3); ndërsa për Shqipërinë dhe vendet fqinje kemi: Bullgaria (56) me 64.6 pikë; Shqipëria (kalon nga pozicioni 56 në 62) me 63.7 pikë; Rumania (65) me 63.2; Sllovenia (68) me 62.9; Turqia (75) me 61.6; Italia (76) me 61.4; Maqedonia (78) me 61.2; Greqi (81) me 60.8; Mal i Zi (94) me 58.2; Serbia (109) me 56.6; Kroacia (116) me 55.1; Moldavia (120) me 54.9; Bosnja (134) me tregues 53.1.

-4-

- Për EFW-në (viti 2007 e 2008), si gjithmonë në pozicion të parë është Hong Kongu me tregues të lirisë ekonomike (në shkallë dhjetëshe) të barabartë me 8.9. Disa të dhëna në këtë rast (si radhitje grup-vendi dhe vlerë të këtij treguesi) për Shqipërinë dhe vendet fqinje, janë: 52 Itali 7.0; 56-57 Bullgaria 6.9; 56-57 Greqia 6.9; 60-67 Mal i Zi me 6.8, 76-78 Moldavia 6.5; 82-85 Kroacia e Rumania me 6.4; 86-90 Maqedonia me 6.3; 91-96 Sllovenia dhe Turqia me 6.2; 97-100 Shqipëria e Bosnja me 6.1; 123-126 Serbia me 5.4.

-5-

- Parë në tërësi, treguesi i lirisë ekonomike të botës (EFW-ja) është rritur në mënyrë të konsiderueshme në rrjedhje të viteve, duke lëvizur nga vlera afro 5.2 (në vitin 1980) tek vlera gati 6.6 në periudhën e tashme. Kurse, duke shfrytëzuar indeksin e lirisë ekonomike (IEF-në) na rezulton se liria ekonomike në botë ka pasur një rritje me 2.6 pikë që nga viti 1995. Sidoqoftë, treguesi i dytë (IEF-ja), sipas aspekteve që mbulon, del më i përdorshëm (p.sh., për BB-në) si tregues i klimës së investimeve. Po ashtu, EFW-ja është shfrytëzuar më shpesh në kërkimin akademik. Ajo, në orientimin e vet, është më afër përcaktimit të lirisë brenda modelit “**laisser-faire**” të kapitalizmit. Ky tregues flet edhe për shkallën, në të cilën politikat konkrete dhe institucionet e një vendi janë mbështetëse të lirisë ekonomike. Akoma, më i shfrytëzueshëm del ky tregues kur bëhet fjalë për pronën, madje ai nënkupton, për më tepër, se prona e fituar në mënyrë ligjore, pa manipulime e vjedhje, pa shfrytëzim forcë duhet të mbrohet me domosdo nga të pushtuarit e saj prej një personi apo strukture tjetër; se i zoti i saj mund ta shfrytëzojë atë në mënyrë të lirë, ta shkëmbejë atë apo ta japë me qira tek persona të tjerë për aq kohë sa këto veprime nuk dhunojnë të drejta identike të tjerëve...

- **Si kolona të lirisë ekonomike janë, në radhë të parë, zgjedhja personale në krahasim me atë kolektive, shkëmbimi vullnetar i koordinuar nga tregu e jo nga marifetet politike, liria për t' u përfshirë në treg dhe për të garuar aty; mbrojtja e individit dhe e pronës së tij nga agresioni i të tjerëve. Në praktikë, vetë indeksi përmban: përmasën qeveritare (shpenzimet, taksat e ndërmarrjet e saj), strukturën legale, sigurinë apo garantimin e të drejtave të pronës, një përdorim të parasë së shëndetshme, liri pjesëmarrjeje në tregtinë e brendshme dhe të jashtme, rregullime të kreditit, punës dhe biznesit, etj. Disa nga parametrat e matura janë p.sh., dhe ato që lidhen me taksat, shkallën e pavarësisë juridike, normat e inflacionit, kostot e importit, rregullimet e çmimeve, etj...**

- **Shumë kohë më parë, ekonomistë të shquar këmbëngulnin se liria e shkëmbimit dhe koordinimi i tregjeve përbënin “karburantin” e progresit ekonomik. Bile, as mund të përfytyrohej pa këtë shkëmbim dhe aktivitetin ndërmarrës (të koordinuar nëpërmjet tregjeve), që të arriheshin standardet e arritura të jetesës. Por, shumë gjëra janë tronditur jo pak këtë vitin e fundit. Për arsye të krizës financiare shfaqen kudo ndërhyrjet e fuqishme qeveritare, deri të afërta me “teknologjitë” socialiste. Në kushte të tilla, një problem i ri shtrohet edhe për konceptimin e lirisë ekonomike apo i treguesit të saj mesatar. Të paktën, duke pasur parasysh ndërhyrjet e sotme në ekonomi dhe kontrollet përkatëse qeveritare në institucionet bankare e financiare, pra një “metodologji” krejt tjetër nga ajo e “*laisser-faire*”. Dhe, po ashtu, duke ridimensionuar parametrat ekonomikë në korrelacion të ngushtë me të drejtat politike e liritë civile...**

Per Shqiperine treguesi mesatar per vitin 2009 rezulton 63.7, duke e rradhitur ekonomine e saj ne vendin e 62-te ne bote apo te 27-te midis 43 vendeve ne Evropa



Per Shqiperine treguesi mesatar per vitin 2009 rezulton 63.7, duke e rradhitur ekonomine e saj ne vendin e 62-te ne bote (midis 183 vendeve) apo te 27-te midis 43 vendeve ne Evrope. Po aty per Maqedonine rezultojne: vendi i 78-te (ne bote) dhe ai i 33-te ne Evrope, ndersa per Serbine 109-te dhe 37-te.



Liria Ekonomike: Shqiperia 2012


Sipas indeksit te vitit 2012 te Lirise Ekonomike, Shqiperia eshte ne vendin e 57-te me tregues 65.1, me nje rritje te tij prej 1.1 pike nga viti i kaluar. Ne Europe ajo eshte ne pozicionin e 26-te midis 43 vendeve, kurse treguesi i saj eshte mbi mesataren boterore.

Tregues problematik ka ate te drejtes se prones dhe korrupsionin.

Taksa personale dhe ajo e korporatave jane 10% (taksa e sheshte). Taksa te tjera jane: TVSH, taksa e prones dhe ajo e trashegimise, me nje total 25.7% te te ardhurave totale te vendit. Shpenzimet qeveritare perbejne 31.9 % te PBB-se, kurse deficitin buxhetor eshte mbi 4% te PBB-se.

Procedurat e nisjes se biznesit jane thjeshtuar, po ashtu dhe kapitali per hapjen e tij, apo ato te mbylljes se tij. . Ne tregun e punes ka probleme informaliteti.

Tarifa e ponderuar tregtare eshte 5.1 %. Kerkesat per licensim jane minimale. Nuk ka taksa eksporti, por kapaciteti i dobet tregtar dhe burokracia administrative krijon vonesa tregtare dhe rrit koston. Kompanite e vendit dhe ato te huaja trajtohen ne menyre te njejte nga ana ligjore, por burokracia e paafte i dekurajon investimet. Shumica e bankave jane te huaja dhe brenda sistemit bankar ka nje kompetivitet ne zhvillim te mire.



Zbatimi i ligjit:

E drejta e pronës 35.0

Liria nga korrupsioni 33.0

Qeverisja e kufizuar

Shpenzimet qeveritare 69.5

Liria Fiskale 91.4

Eficienca rregullatore

Liria e biznesit 78.2

Liria e punës 51.0

Liria monetare 78.6

Hapja e tregjeve:

Liria tregtare 79.8


Liria e investimit 65.0

Liria financiare 70.0

CPI per Shqiperine (2008)

- **CPI-ja (Corruption Perceptions Index) shpreh nivelin e perceptuar te korrupsionit ne sektorin publik mdis 180 vendeve. Shqiperia arrin ne nivelin 3.4 (ku niveli 10 perfqeson ate me te pastrin dhe 0 me te korruptuarin) Pavaresisht qe ende kemi probleme serioze, treguesi i vitit 2008 eshte shume me i permiresuar sesa ai I vitit 2007 me tregues mesatar 2.9.**

Treguesit e Perceptimit të Korrupsionit dhe të Lirisë Ekonomike




1-Sllovenia
2-Greçia
3-Bulgaria
4-Turqia
5-Kroacia
6-Rumania

■ CPI
■ L.Ekon.

7-Bosnja
8-Moldavia
9-SMZ
10-Maqedonia
11-Shqiperia

CPI: Ndryshimi ne vite

Rendi		2011	2010	2009	2008	2007	2006	2005	2004	2003	2002
95	Shqiperia 	3.1	3.3	3.2	3.4	2.9	2.6	2.4	2.5	2.5	2.5

**Nje qeverisje per nje
klime pozitive biznesi**

Per nje klime pozitive per biznesin

Zhvillimi i qëndrueshëm është i pamundur pa një klimë të fuqishme biznesi dhe investimesh. Duhet të ketë një kuadër të përshtatshëm për rregullimin dhe qeverisjen në mënyrë që firmat të mbijetojnë dhe të veprojnë me përgjegjshmëri. Rregullimi mjedisor është një fushë ku qeveria duhet të sigurojë rregullim të balancuar që të mbrojë interesat kombëtare si edhe qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve. Me vendosjen e një kuadri të përshtatshëm, qeveritë mund të nxisin qëndrueshmërinë afatgjatë të klimës së biznesit duke inkurajuar – dhe jo me detyrim apo presion – ndërmarrjet që të veprojnë me përgjegjshmëri. Përgjegjësia sociale e komunitetit është vendim që i takon ndërmarrjes. Praktikrat më të mira në këtë fushë përfshijnë edhe miratimin e kodeve të sjelljes në industri si dhe inkurajimin e punonjësve që të marrin pjesë në punë vullnetare.

Shumë punime mbi zhvillimin ekonomik e trajtojnë në mënyrë të veçantë nxitjen e IHD-ve nga ai i NVM-ve. Sidoqoftë, IHD-të dhe zhvillimi i NVM-ve janë dy nga katalizatorët më të rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe hapjen e vendeve të punës dhe prirjen të jenë mbështetëse të njëra-tjetrës. Nga ana tjetër, përmirësimi i klimave të biznesit dhe investimeve gjeneron IHD-të dhe zhvillim të NVM-ve. IHD ka potencialin për të gjeneruar punësim, rritje të prodhueshmërisë, aftësi transferuese dhe teknologji të re, rritjen e eksporteve, si dhe kontribuon në zhvillim afatgjatë ekonomik të vendeve të zhvillim. A janë IHD-te që gjenerojne rritje ekonomike, apo është rritja ekonomike që gjenerojne IHD-te? Ne shume drejtime mund te pohohet se **rritja e IHD-së dhe rritja ekonomike prirjen të shoqërojnë njëra-tjetrën.**

Udhëzuesi i Praktikave më të Mira për një Klimë Pozitive për Biznesin dhe Investimet. OSBE (OSCE). © 2006 Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE); ISBN-10: 3-9502218-0-8, ISBN-13: 978-3-9502218-0-0

- Klima e favorshme e biznesit është thelbësore për tërheqjen e **investimeve të huaja të drejtpërdrejta** (IHD) dhe për zhvillimin e **ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme** (NVM). Një mjedis i dobët biznesi, domethënë i karakterizuar nga faktorë që imponojnë kosto të larta, vonesa dhe risk të lartë, pengojnë zhvillimin ekonomik dhe mund të frikësojnë dhe largojnë IHD-në. IHD është burimi më i madh i financave të jashtme në ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion. Vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore dhe të Azisë Qendrore janë në pozita të mira për të konkurruar për IHD, nëse miratojnë politika pro-zhvillim dhe ligje e praktika që mbështesin investimet dhe zhvillimin e biznesit. Siç është ilustruar edhe nga transformimi ekonomik i Irlandes, edhe ato vende me nivele të ulëta IHD-je mund të rrisin konsiderueshëm IHD-në me përpjekje të përqendruara për përmirësimin e klimës së biznesit.

Disa shkurtime:

BERZH Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

IHD Investime të Huaja të Drejtpërdrejta

FIAS Shërbimi Këshillues për Investimet e Huaja

IFC Korporata Financiare Ndërkombëtare

MIGA Agjencia për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe

OECD Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

PFI Kuadri i politikave të OECD për investimet

PPP partneritet publik-privat

NVM Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

TMC Korporata Ndërnacionale

UNCTAD Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin

UNIDO Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial

USAID Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

OBT Organizata Botërore e Tregtisë

Çfarë është “klima e biznesit dhe investimeve”?

- Nuk ka një përkufizim preciz për “klimën e biznesit dhe të investimeve”. Banka Botërore në klimën e biznesit dhe të investimeve përfshin mundësinë dhe incentivat për firmat që të investojnë në mënyrë produktive, të hapin vende pune dhe të zgjerohen. Në vija të ngjashme, klima e biznesit dhe e investimeve shërben si kuadër që u mundëson kompanive të huaja dhe vendëse, që të kryejnë biznes dhe të kërkojnë fitime në një vend të caktuar. Klima e investimeve mund të përkufizohet nga tre variabla komplekse: **-1. Politikat makroekonomike si ato fiskale, monetare dhe politikat tregtare, -2. Qeverisja dhe institucionet dhe – 3. Infrastruktura**
- Klima e biznesit dhe e investimeve përbëhet jo vetëm nga niveli i taksave dhe incentivave fiskale të disponueshme për bizneset. Komponentë të tjerë vendimtare janë edhe stabiliteti politik, shteti i së drejtës, kushtet makroekonomike, perceptimet e qeverisë dhe mjedisi rregullator.
- Gjendja e klimës së biznesit dhe investimeve të një shteti është një faktor kyç i aftësisë së këtij shteti për të thithur investime të huaja dhe për të zhvilluar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Ndërmarrjet ndërnacionale parapëlqejnë të investojnë në vende me klimë të shëndetshme biznesi ku kostot, vonesat dhe risku janë të minimizuar. Përveç kësaj, NVM-të janë më të prirura të lulëzojnë në një klimë ku nuk rëndohen së tepërmi me taksat dhe rregullime. Në mbarë globin vendet e pasura priren të kenë klimë më të favorshme për biznesin dhe investimet. Ka një lidhje të pandashme ndërmjet rritjes ekonomike dhe lulëzimit, investimeve dhe klimës së biznesit. Shumë nga vendet e Evropës Lindore pa rezerva të mëdha energjie apo lëndë të parë, i kanë kthyer ekonomitë e tyre në destinacione globale për tërheqjen e IHD-së nëpërmjet reformimit të klimës së tyre të biznesit dhe investimeve. Qeveritë shpesh e shpërfillin rëndësinë e klimës së biznesit kur ftojnë investimet e huaja të drejtpërdrejta. Ato priren të përqëndrohen në përmasat e tregut, niveli i burimeve natyrore dhe kostot. Edhe pse këta faktorë janë të rëndësishëm, klima e investimeve është një faktor vendimtar dhe nuk duhet nënvlerësuar.
- Investuesit kërkojnë kthim (fitim) të parashikueshëm dhe të pranueshëm për investimin e bërë: “Paraja është frikacake” është një shprehje e njohur. Në mënyrë që të arrijë në fitime konkurruese, një investues përpiqet të shmangë tri pengesa kryesore: kostot, vonesat dhe riskun. Në rast të një klime të dobët investimesh, për shkak të taksave, tarifave, gjobave, korrupsionit dhe nevojës për shërbime shtesë (avokatë, financiarë, konsulentë, etj.) rriten kostot e transaksionit investues dhe investuesi mund të hedhë sytë diku tjetër, pavarësisht se kostot e krahut të punës, transportit dhe energjisë në atë vend janë konkurruese. Në të njëjtën logjikë, nëse pengesat që paraqet sistemi vonojnë thithjen e fitimeve të ndjeshme, investuesi mund të vendosë të investojë gjetkë, paçka se kostot janë konkurruese. Në fund, edhe kur kostot fillestare dhe vonesat nuk janë faktorë, por investuesi shqetësohet për trazirat politike, ngrirjen e aseteve apo ndryshimet ligjore që mund t’ia pakësojnë fitimet e parashikuara, investuesi mund të preferojë një vend tjetër me fitime më të ulëta në mënyrë që të minimizoië riskun.

Mrekullia e ekonomisë irlandeze

- **Irlanda është një nga shembujt më domethënës të një vendi, ku IHD është promovuar nga klima e fuqishme e biznesit dhe investimeve dhe ku ka pasur ndikim të madh. Në vitet 1970 dhe '80 pati migrim masiv të punëtorëve irlandezë drejt Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të tjera, për shkak të papunësisë së lartë dhe rritjes së dobët ekonomike. Në mesin e viteve 1980, Irlanda vuante nga një shkallë papunësie rreth 20% dhe nga niveli më i lartë i borxhit për frymë në botë. PBB për frymë ishte vetëm 63% e fqinjit të saj, Britanisë së Madhe. Në vitet 1990, Irlanda pësoi një transformim rrënjësor ekonomik dhe u bë një nga vendet më të pasura evropiane për frymë, duke u renditur e treta pas Norvegjisë dhe Zvicrës. Afërsia gjeografike e Irlandës me Shtetet e Bashkuara, popullsinë anglishtfolëse si dhe anëtarësimi në Bashkimit Evropian kanë kontribuar në rritjen ekonomike gjatë 15 viteve të fundit. Por ajo që e bën të veçantë rastin e Irlandës është se pa një bazë industriale apo burime të konsiderueshme natyrore, Irlanda vendosi të shfrytëzojë epërsitë e brendshme duke zhvilluar një klimë të shkëlqyer biznesi dhe nëpërmjet hartimit të politikave inteligjente. Irlanda vazhdimisht renditet mes vendeve të para në botë për sa i përket indeksit ndërkombëtar për “hapjen ndaj investimeve të huaja”, “globalizimit”, dhe “lehtësisë për të bërë biznes”.**

Çfarë hapash bëri Irlanda?

- Irlanda transformoi klimën e biznesit dhe u ofroi bizneseve:
 - Taksat për korporatat me të ulëta në Evropë: 12.5%;
 - Kosto konkurruese falë krahut të ri dhe të kualifikuar të punës (i gatshëm të punojë për rroga të moderuara);
 - Një mjedis i lirë nga nderhyrjet e qeverisë dhe i karakterizuar nga konkurrenca;
 - Një infrastrukturë dhe një nivel i lartë kulturor-shkencor, pra dhe një bazë e mirë universitetesh e institutesh të teknologjisë (përfshirë dhe zhvillimin e aftësive kompiuterike);
 - Partneritet midis qeverisë, industrisë dhe fuqisë punonjëse;
 - Vullnet politik e kometar për të tërhequr kompanitë më të mira, që të vendosen në Irlandë.
- Shumë cilësojnë taksat e ulëta si shkakun e rritjes së IHD-së në Irlandë. Por taksat e ulëta ishin vetëm një element në një program shumë më të madh për tërheqjen e biznesit. Kështu, p.sh., i tillë ishte vendimi për të ulur nivelin e taksave në një **taksë të sheshtë prej 10%**. Por, përveç nivelit të ulët të taksave, faktorë të tjerë të rëndësishëm luajtën rol në mrekullinë e Irlandës janë:
 - - *Zhvillimi i kapitalit njerëzor.*
 - - *Politikë e fuqishme për investime kombëtare në infrastrukturë.* (Aderimi në BE, përveç aksesit në tregje dhe fonde, i siguroi dhe disiplinë planifikimi, ndryshe nga ajo që ndodhte më parë).
 - - *Bashkëpunim ndërmjet krahut të punës dhe industrisë – një “partneritet social”,* për të cilin rane dakord dhe sindikatat për rroga të drejta dhe të moderuara.
 - - *Nxitja e përcaktuar e investimeve në sektore si industria IT (teknologjitë e informimit dhe komunikimit), industria farmaceutike dhe e kujdesit shëndetësor, industria e shërbimeve financiare ndërkombëtare, ku rritjen më të lartë pati dhe industria e shërbimeve ndërkombëtare software.*
 - *Për ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion që nuk kanë luksin e burimeve natyrore si nafta apo gaz, përmirësimi i klimës së biznesit bëhet një element i dorës së parë.* Madje, rasti i Irlandës apo dhe ai në Shtetet Balltike demonstrojnë që ekonomitë nxjerrëse nuk janë të vetmet mekanizma për zhvillim ekonomik.

Vendet baltike: Estonia, Letonia dhe Lituania

- Disa specifika te tyre.
- Këto shtete kishin sisteme ekonomike me planifikim të centralizuar, nuk kanë kufij të afërt me Evropën Perëndimore, nuk disponojnë burime të bollshme natyrore dhe kanë popullsi të vogla, e megjithatë arritën të transformohen dhe të renditen ndër ekonomitë me rritjen më të shpejtë. Ndërkohë që ekzistojnë disa epërsi falë afërsisë me vendet nordike dhe Rusinë, duhet thënë që vendet nordike edhe pse me ekonomi të avancuar, nuk janë ekonomi të mëdha dhe Rusia është akoma një shtet me të ardhura të mesme.
- Cilat janë sekretet e zhvillimit në Balltik?
- - *Përdorimi inteligjent i zonave të lira*. (P.sh., Lituania dallohet për suksesin në zonat e saj të lira dhe ofrimin e shërbimeve one-stop-shop dhe e incentivave tatimore).
- - *Taksat e ulëta*. (Të tre shtetet kanë tatime të ulëta për të ardhurat dhe taksë të sheshtë).
- - *Shtrirja e madhe e teknologjisë dhe e sektorit IT*. (Të tre këto shtete kanë futje të lartë të kompjuterëve dhe internetit dhe kanë arritur të thithin IT nga Evropa Veriore dhe SHBA. Estonia, në veçanti, shpesh quhet “Finlanda Jugore” për shkak të projekteve IT, sepse ato janë me kosto konkurruese).
- - *Përqëndrim në konkurrueshmëri*. (Jane hequr tashme shumica e subvencioneve për industri të ndryshme).
- - *Politika të kujdesshme fiskale dhe monetare*. (Shtetet Baltike kanë relativisht defiçit të ulët të llogarive rrjedhëse, lejojnë fluksin e lirë të kapitalit, dhe kanë valuta të këmbyeshme).

Disa rekomandime

- Qeveritë zakonisht i kanë mjetet për t'ua bërë më të lehtë biznesin njerëzve. Rritja e nivelit teknologjik dhe nxitja e rritjes ekonomike janë çështje komplekse dhe të vështira, por ndryshimi i legjislacionit për punësimin, thjeshtimi i procedurave të dhënies së lejeve dhe licencave, përpilimi i regjistrimit kombëtar të tokës, apo mbështetja e zhvillimit të infrastrukturës, të gjitha këto janë çështje që u takojnë qeverive për t'ua bërë. Nëse qeveritë dëshirojnë të tërheqin IHD, duhet të përkushtohen në bërjen e një politike të kujdesshme. Regjimet e dobëta rregullatore dhe/ose kapacitetet e dobëta institucionale që çojnë në sjellje jokonkurruese të tregut apo në mosmbledhjen e taksave, priren të kenë ndikim negativ në IHD.
- Qeverisja e mirë, transparencja, stabiliteti dhe parashikueshmëria, janë baza thelbësore për zhvillimin ekonomik. Nëse këto tipare bazë politike dhe ligjore kanë mangësi, atëherë stimulantët për rritjen ekonomike si për shembull: burimet e bollshme natyrore, taksat e ulëta apo krahu i lirë i punës, nuk rezultojnë efikase sa duhet. Meqë mungesa e stabilitetit politik dhe sigurisë cenon shumë bizneseve të ligjshme, u takon qeverive që mbrojtjen e të drejtave dhe lirive civile, politike dhe ekonomike të tyre, ta bëjnë prioritet kryesor. Përveç garantimit të të drejtave të njeriut dhe parandalimit të krimit, qeveritë duhet të mbrojnë si investimet e huaja, ashtu edhe ato vendëse kundër arbitraritetit apo bllokimeve të pakompensuara, sanksioneve diskriminuese dhe nga ndërhyrjet qeveritare me shtysë nga ngjarjet politike. Qeveritë mund të përmirësojnë transparencën dhe stabilitetin legjislativ duke e afruar legjislacionin tregtar me standardet rajonale dhe globale; duke botuar ligje, rregullore dhe vendime të qeverisë; dhe duke lejuar një periudhë njoftimi dhe komentesh përpara miratimit përfundimtar të ligjeve dhe rregulloreve. Nëpërmjet qeverisë elektronike, Interneti siguron mundësi me kosto të ulët për të hedhur dritë se si funksionojnë qeveritë, si bashkëveprojnë me biznesin dhe si e rregullojnë atë. Shtetet mund ta zbusin korrupsionin – një nga forcat më shkatërruese që kërcënon zhvillimin ekonomik dhe shoqërinë e shëndetshme – duke miratuar ligje të përshtatshme dhe duke ngritur institucione të pavarura jo vetëm për hetimin dhe ndjekjen ligjore të korrupsionit, por që të veprojnë si kontrollorë të ushtrimit të paligjshëm të pushtetit qeveritar. Këto dhe të tjera praktika të mira qeverisjeje, u japin një sinjal të qartë bizneseve vendëse dhe të huaja se vendi në fjalë e çmon kontributin e tyre për të mirën e shoqërisë dhe se do të punojë me ta për arritjen e përfitimeve të ndërsjella.

Rëndësia e mjedisit politik dhe kushteve kryesore

- Qeveritë shpesh mendojnë se kushtet ekonomike dhe fiskale janë faktorët vendimtare për tërheqjen e investimeve të huaja. Edhe pse kushtet ekonomike dhe fiskale janë të rëndësishme, faktori kryesor për vendosjen e një klime të favorshme biznesi dhe investimesh **është mjedisi politik dhe ligjor**. Shtetet mund të ofrojnë taksa të ulëta dhe tokë falas, por nëse investuesit i druhen shpronësimit të aseteve, revokimit të incentivave, revoltimit të krahut të punës, trazirave civile, apo paaftësisë për të përballur fatkeqësitë natyrore, atëherë ata dekurajohen dhe nuk investojnë. Investuesit duan të binden që vendi në fjalë është i vendosur që të thithë investime të huaja dhe që këto investime janë të sigurta. Mjediset e paqëndrueshme politike rrisin riskun, të cilin investuesit prirën ta shmangin. Përveç kësaj, faktorët politikë si korrupsioni, burokracia dhe mungesa e shtetit të së drejtës, janë jo vetëm risqe, por ngarkojnë investimet me kosto shtesë të drejtpërdrejta. Përgjithësisht, atje ku IHD-te janë te ulëta, investuesit e huaj ankohen për një nivel të papranueshëm të burokracisë, paqartësive dhe amendimit e shpeshtë të ligjeve dhe që po aq shpesh bien në kundërshtim mes tyre, si dhe për korrupsionin. Faktorët kryesorë politik që mbështetin klimën e fuqishme të biznesit dhe investimeve, janë:

- - Siguria
- - Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të investuesit të huaj
- - Stabiliteti legjislativ
- - Transparenca
- - Reduktimi apo eliminimi i korrupsionit
- - Qeverisja e mire.

P.sh., pa mbrojtjen e investuesve, tregjet e kapialeve nuk arrijnë të zhvillohen dhe bankat bëhen i vetmi burim financimi. Megjithatë, sistemet e dobëta regjistruese të kolateraleve dhe pronave bllokojnë shumë biznese në vendet e varfra që të marrin hua bankare. Rezultati: bizneset nuk arrijnë përmasa efiçente ngaqë u mungon financimi dhe rritja ekonomike frenohet.

-2-

- Investuesit e huaj pretendojnë atë që quhet “trajtim kombëtar”: me fjalë të tjera, të trajtohen njësoj si ndërmarrjet vendëse. Nënsektorët ekonomik specifik që lidhen me sigurinë kombëtare mund të kërkojnë trajtim të veçantë ndërmjet ndërmarrjeve të huaja dhe vendëse, megjithatë, “proteksionizmi” nuk shihet me sy të mirë nga investuesit.
- Në përgjithësi, vendet me klimë të fuqishme biznesi dhe investimesh, i trajtojnë njësoj ndërmarrjet vendëse dhe të huaja, dhe sigurojnë mjedisin më konkurrues të mundshëm. Një shtet me incentiva të ndërlikuara fiskale për investuesit e huaj në disa industri dhe që nuk lejon investimet e huaja në sektorë të tjerë, krijon një ekonomi më pak konkurruese me një fushë loje të pabarabartë që është e kushtueshme për t’u drejtuar si nga qeveria ashtu edhe nga vete kompanitë.
- Prandaj duhet te kihet parasysh:
 - Trajtim i barabarte dhe jodiskriminues,
 - Investim ne cdo drejtim e strukture biznest (i drejtperdrejte, portofol, etj.)
 - Garantim ne procesin e privatizimit, shpronësimeve apo masave të tjera me efekt të ngjashëm, dhe kompensim të drejtë në rast se këto rrethana ndodhin për shkak të sigurisë kombëtare;
 - Transferim te fitimeve jashte shtetit ne valute huaj pas pagimit të taksave dhe tarifave të vendosura me ligj;
 - Pronesi mbi token;
 - Mbrojtje te pronësise intelektuale dhe industriale;
 - Zgjidhje te mosmarreveshjeve ne gjykata vendore, që janë të drejta dhe të pavarura, ose të kërkojnë arbitrazh vendas ose ndërkombëtar.

Stabiliteti legjislativ

- “S’ka rëndësi nëse taksa mbi fitimin është 17% apo 21%. Natyrisht, 17% është më mirë. E rëndësishme është që Kodi Tatimor (apo Fiskal) të qëndrojë i pandryshuar për pesë vitet e ardhshme që ta di se çfarë taksash kam për të paguar”.
- Stabiliteti legjislativ është një nga elementët kyç për një mjedis politik që mbështet klimën e fuqishme të biznesit dhe investimeve. Ligjet, që ndryshohen vazhdimisht, ndikojnë negativisht në aftësinë e investuesve për të parashikuar fitimet. Për më tepër, kosto të biznesit si financa dhe auditimi, outputet mjedisorë dhe administrimii i krahut të punës. Gjithashtu, edhe kur kushtet janë të favorshme në një moment të caktuar, një mjedis i paqëndrueshëm legjislativ mund t’u japë investuesve përshtypjen se është i lartë rreziku i thellimit të kushteve të pafavorshme, që mund t’i bindin ata, që të heqin dorë nga investimi.
- Miratimi i legjislacionit tregtar të krahasueshëm ose të ngjashëm me **acquis communautaire** të Bashkimit Evropian. Ky rekomandim nënvizon nevojën për ligje tregtare që janë të njohura për investuesit dhe në linjë me standardet ndërkombëtare. Në Bashkimin Evropian, **acquis communautaire** siguron një kornizë të njohur ligjesh të cilat investuesit i njohin dhe i kuptojnë mirë.

Dy rekomandime:

- *Vendosja e një periudhe për njoftim dhe komente për projektligjet për tregtinë*
- *Vendosja e një kalendarit ngjarjesh periodike legjislative.* (Idea është që ndryshimet legjislative të jenë të parashikueshme. Për shembull, rishikimi i nivelit të taksave mund të bëhet një apo dy herë në vit).

Transparenca

Hapja dhe llogaridhënia para publikut janë elementë kyçë të transparencës. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (UNDP) e përkufizon transparencën edhe **si shkëmbim informacioni dhe veprim në mënyrë të hapur**. Transparenca u mundëson aktorëve të mbledhin informacion që mund të rezultojë vendimtar për zbulimin e abuzimeve dhe mbrojtjen e interesave të tyre. Sistemet transparente kanë procedura të qarta për vendimmarrjen publike dhe kanale të hapura komunikimi, si dhe garantojnë akses të gjerë për një gamë të madhe informacioni.

- *Për investuesit vendës dhe të huaj, informacioni transparent për mënyrën si zbatohen rregullat dhe aktet për investimet dhe se si ato mund të ndryshohen, është një faktor vendimtar në vendimet për investimet. Transparenca dhe parashikueshmëria janë veçanërisht të rëndësishme për investuesit e huaj që u duhet të funksionojnë me sisteme rregullatore, kultura dhe kuadre administrative shumë ndryshe nga ato që janë mësuar. Një kuadër rregullator investimesh që është transparent dhe i parashikueshëm, ndihmon bizneset të vlerësojnë mundësitë potenciale për investime në një mënyrë më të informuar dhe më të shpejtë në kohë, duke e shkurtuar kohën që i duhet investimit për t'u bërë produktiv.*
- Ekziston një prag transparence nën të cilin kushtet e biznesit bëhen kaq të paqarta, saqë thuhet asnjë investues nuk është i gatshëm të hyjë, pavarësisht shkallës së tundimit. Indeksi i Paqartësisë/Opacitetit është një instrument për llogaritjen e transparencës. Krijuesit e Indeksit të Opacitetit besojnë se “risqet e përditshme, me shkallë të ulët”, të shoqëruar me mungesën e transparencës, përbëjnë barrierat për investimet dhe tregtinë globale. Indeksi bazohet në një metodologji të quajtur “CLEAR”, ku secila gërmë përfaqëson në anglisht një koncept: C për Korrupsion, L për Sistem Ligjor, E për Politika Ekonomike, A për Praktikën e Llogarisë dhe Financave, dhe R për Mjedisin Rregullator. Por ky indeks nuk ka gjetur një zhvillim aq depertues. (Shihni: R.Meidani, **Kontrate me vetvete, Toena 2004, f.288-290, Panorama, 23 prill 2004,**)
- Më poshtë, renditet disa nga praktikën më të mira për rritjen e transparencës në qeverisje:
 - - *Përdorimi i gjerë i qeverisë elektronike.*
 - - *Publikimi dhe rishikimi i vendimeve administrative, përfshi tenderët publikë.*
 - - *Përkrahja e medias së pavarur dhe shtypit.* (Transparenca rritet kur ka një shtyp të pavarur në gjendje të hetojë dhe të diskutojë politikën dhe aksionet e qeverisë pa pasur frikë nga hakmarrja. Qeveritë nuk duhet të përpiqen që të shtrëngojnë mediat të shprehin pikëpamje të caktuara duke përdorur instrumente imponuese ekonomike, apo duke kërcënuar me censurim të informacionit)
 - - *Miratimi i standardeve ndërkombëtare për llogaritë.* (Përdorimi i standardeve ndërkombëtare për llogaritë lehtëson vlerësimin financiar të ndërmarrjeve dhe projekteve investuese. Kompanitë e huaja janë më në qiendie që të vlerësojnë deklaratat financiare të ndërmarrjeve).

Korrupsioni

- **Korrupsion do të thotë të kërkosh, të ofrosh, të japësh apo të pranosh, drejtpërdrejt ose jo , ryshfet ose çfarëdo epërsie apo premise favorizuese që shtrembëron ecurinë drejtë të një detyre apo sjelljeje që kërkohet nga marrësi i ryshfetit. Kultura të ndryshme mund të kenë perceptime të ndryshme për korrupsionin, por një fakt është i qartë: korrupsioni është pengesë si për investimet e huaja të drejtpërdrejta, ashtu edhe për zhvillimin e NVM-ve. Edhe pse investuesit mësojnë “t’ia gjejnë anën” korrupsionit nëpërmjet lobimit, ndërtimit të marrëdhënieve, përdorimit të medias dhe taktikave të tjera, fakti i thjeshtë është se korrupsioni u kushton investuesve para dhe kohë.**
- Praktikave e ndjekura nga një numër shtetesh që kanë shënuar progres kundër korrupsionit janë si më poshtë:
 - **Ngritja e nje agjencie ose departamenti te pavarur antikorrupsion;**
 - **Lehtesirat administrative** (Burokracia është një terren pjellor për korrupsionin. Sa herë ka një refuzim potencial ose ngadalësim të një projekti investimi, ka një tundim korrupsioni për burokratin dhe investuesin).
 - **Funksionimi i nje gjyqesori te pavarur**
 - **Rritja e pages dhe nxitja e profesionalizmit tek nenpunesit civile**
 - **Ligj per denoncimin e korrupsionit;**
- **Zbatimi i ligjeve qe jane ne vetvete barriera kunder korrupsionin** (Para pak kohësh, disa vende të Evropës Perëndimore lejonin kompanitë që të trajtonin ryshfetet e paguara për të bërë biznes jashtë shtetit si taksa të zbritshme. Korrupsioni publik në ekonomitë në zhvillim dhe tranzicion cilësohej si një fakt i jetës, dhe pak ekzistonte shqetësimi nga qeveritë në vendet e zhvilluara që të bënin diçka për këtë situatë. Sot, me miratimin e traktateve ndërkombëtare si Konventa AntiRyshfet e OECD-së dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit⁷, shumë kombe po përpiqen të korrigjojnë këto praktika si brenda ashtu edhe jashtë shtetit.

Qeverisja e mirë

- “Qeverisja e mirë tashmë njihet si një parakusht vendimtar për mirëfunksionimin e tregjeve dhe rrjedhimisht për kushtet tërheqëse investuese dhe akordimin e qëndrueshëm të kapitalit investues”.
- Një nga gjërat më të thjeshta që shtetet mund të bëjnë për përmirësimin e klimës së biznesit është thjesht të qeverisin mirë. Regjimet që shikohen si të korruptuara, të paqëndrueshme ose të paaftha, i dekurajojnë investuesit. Një qeverisje quhet e mirë kur ka katër cilësi kryesore: **parashikueshmërinë, transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen.**
- Nëse qeveritë duan që qeverisja e mirë të bjerë në sy të investuesve, ato duhet të reklamojnë disa praktika të mira si:
 - - *Privatizime dhe tendera transparentë dhe konkurrues.*
 - - *Pagim i shpejtë dhe i plotë i borxheve të shtetit.* (Nëse qeveria nuk paguan për shërbimet, konsulentat, apo produktet, ulet tërheqja e investimeve në infrastrukturë apo kontratat Bashkiake).
 - - *Krijimi i një procesi sistematik konsultimi me sektorin privat.* (Dialogu i rregullt konstruktiv me sektorin privat mund të sjellë më tepër sesa shkëmbim informacioni. Shpesh, konsultimi i drafteve të legjislacionit, mbajtja e takimeve të hapura me publikun dhe organizimi i forumeve, si dhe krijimi i këshillave në partneritet me sektorin privat, u sjell qeverive përfitime si konsulencë falas, legjislacion më të mirë tregtar dhe mbështetje më të gjerë për programet qeveritare).
 - - *Ngritja e një avokatit të popullit për investimet.* (Investuesit, veçanërisht ata të huaj, shpesh hasin në vështirësi kur punojnë në kultura dhe kuadro rregullatore të panjohura për ta. Këto vështirësi thellohen kur përballen me burokraci apo negociata me entet shtetërore. Ngritja e zyrës së avokatit të investimeve mund të sjellë ndihmë shumë të vyer).
 - - *Përgatitja e një raporti vjetor për gjendjen e klimës së investimeve.* (Raporti vjetor për gjendjen e klimës së investimeve i jep mundësinë qeverisë që të shohë hapur progresin e bërë në përmirësimin e klimës së investimeve si dhe në evidentimin e fushave që kanë ende nevojë për përmirësime. Për më tepër, qeveria mund të gjenerojë edhe më tepër transparencë dhe parashikueshmëri, nëse shpall publikisht planet e saj për klimën e biznesit dhe investimeve për vitin pasardhës).

Stabiliteti

- **Stabiliteti makroekonomik dhe rritja ekonomike janë thelbësore për nxitjen e zhvillimit ekonomik. Për investuesit e kompanive, treguesit më të rëndësishëm të stabilitetit makroekonomik janë ata që ndikojnë drejtpërdrejt në bilancet e tyre si për shembull rritja e PBB-së dhe e PBB-së për frymë, inflacioni, rritja e popullsisë dhe shkalla e arsimimit universitar. Gjithashtu, kursi i interesave është shumë i rëndësishëm për NVM-të dhe disa investues të huaj. Hapja e një shteti ndaj tregtisë me jashtë, investuesit të huaj dhe punëtorëve të huaj, ndikon në suksesin e tij në nxitjen e zhvillimit ekonomik. Nëse shtetet me burime të bollshme natyrore duan të zgjerojnë rrezën e pasurisë dhe të zbutin tronditjen nga ndryshimet brenda një industrie, ata duhet të diversifikojnë ekonominë e tyre. Vendet duhet të miratojnë strategji ekonomike afatmesme, politika fiskale të disiplinuar dhe një qasje të hapur ndaj tregtisë me jashtë dhe flukseve të kapitalit nga tregjet ndërkombëtare.**

Rëndësia e një mjedisi makroekonomik të fortë dhe të qëndrueshëm

“Politikat e qëndrueshme makroekonomike janë një pjesë vendimtare e kuadrit të politikave nxitëse, duke ulur rrezikun e të bërit biznes duke garantuar një klimë përgjithësisht të parashikueshme për biznesin si dhe në vendimmarrjen për investimet”.

- **Stabiliteti makroekonomik** konsiderohet si parakusht për rritjen ekonomike. FMN e përkufizon stabilitetin ekonomik si llogari rrjedhëse dhe bilanc fiskal konsistent me nivel të ulët dhe në rënie të borxhit, inflacion të ulët me një shifër dhe rritje të PBB-së për frymë. Ky është një prej shumë përkufizimeve. Disa ekonomistë besojnë se inflacioni i ulët me një shifër të vetme është kërkesë shumë e rreptë. Kurba konsistente në ngritje është çelësi i stabilitetit makroekonomik. Mungesa e stabilitetit ekonomik që rezulton në periudha hiperinflacioni apo trauma të tregut financiar, frenon investuesit e huaj. Rënia e PBB-së sinjalizon për një treg në amulli. Kur kostot janë shumë të larta, bizneset nuk mund të funksionojnë dhe të prodhojnë fitime. Ndryshimet e çmimeve shkatërrojnë NVM-të. Rritja prej 20% e kostos së lëndës së parë redukton biznesin e vogël. Mjedis i fuqishëm dhe i qëndrueshëm makroekonomik është i domosdoshëm për të mbështetur rritjen afatgjatë ekonomike.

Treguesit makroekonomikë të përdorur nga komuniteti i investuesve

- **Ndërkohë që forumet ekonomike, institucionet donatore, bankat e zhvillimit, bankat e investimeve, ekonomistët dhe akademikët studiojnë me kujdes statistikën që lidhen me ofertën monetare, apo deficitin e llogarive rrjedhëse, shumica e komunitetit të investuesve përqëndrohen te treguesit që ndikojnë drejtpërdrejt te bilanci i biznesit të tyre. Investuesit e huaj e shohin rritjen ekonomike, dhe veçanërisht nivelin e rritjes së PBB-së dhe PBB-së për frymë, si tregues të destinacioneve me potencial investues. Shtetet me PBB në rritje, jo vetëm që shërbejnë si tregje potenciale, por, gjithashtu, ekonomitë e tyre janë në gjendje të mbështetnin investimet me kapital njerëzor, furnitorë dhe shërbime që i duhen investuesit për të zgjeruar dhe modernizuar biznesin me kalimin e kohës. Një shtet me kosto të ulët, por me ekonomi të amullt, nga njëra anë siguron një hyrje konkurruese në treg, por nga ana tjetër mund të mos rezultojë një model i qëndrueshëm biznesi. Inflacioni është po aq i rëndësishëm. Investuesit shpesh tremben nga rritja e shpejtë e kostove të inputit. Edhe më keq ndodh kur inflacioni i lartë apo hiperinflacioni është një shenjë e qartë që stabiliteti makroekonomik nuk është arritur. Nivelet e larta të inflacionit zakonisht kanë ndikim mjaft negativ te IHD, çka sugjeron që stabiliteti makroekonomik është një faktor i rëndësishëm ndaj kurbës së IHD-së... Keto të fundit lidhen ngushtë dhe me kapitalin njerëzor, shkallen e kualifikimit dhe edukimit profesional të popullsisë.**
- **Papunësia e një vendi është si thikë me dy presa. Disa kompani me karakter të thellë prodhues kërkojnë të vendosen në zona me papunësi të lartë në mënyrë që të thithin krah të lirë pune dhe lëshime nga qeveritë, ndërkohë që kompani të tjera mallrash konsumi, shërbimesh dhe të tjera, e shohin papunësinë e lartë në ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion si një tregues se vendi nuk e ka arritur stabilitetin makroekonomik dhe se tregu i brendshëm nuk është i qëndrueshëm. Po ashtu, për investuesit vendës dhe disa investues të huaj, kursi i interesave është një ndryshore kyçe makroekonomike. Ky ishte dhe gabimi në vende të tilla si Tajlanda, Malejzia, etj., vëmendja u përqëndrua tek dinamizmi ekonomik, hapja e tregjeve dhe konkurrueshmëria dhe jo çështjes së ngushtë të balancimit të nivelit të kursit të këmbimit. Kur kostoja e një kapitali është tepër e lartë, zhvillimi i NVM-ve mund të ndrydhet dhe investimet e huaja të pakësohen. Një nga problemet tradicionale të NVM-ve, është aksesimi në financa. Nëse i vetmi financim i mundshëm është rreth 40 apo 50 përqind me kërkesa kolaterale të lartë, atëherë praktikisht mungojnë financimet për NVM-të.**

- **Paranteze (Footnote):**
- **Kjo do të thotë që i kushtuan më tepër vëmendje mjedisit institucional, sistemit bankar, marrëdhënieve të menaxhimit të krahut të punës, klimës dhe kulturës së biznesit, shtetit të së drejtës dhe kodeve tregtare, si komponentë të konkurrueshmërisë bashkë me politikat e shëndosha makroekonomike. Pikëpamja e Azisë Lindore për rritjen dinamike ekonomike ishte e bashkërenduar dhe e integruar dhe jo e ngushtë dhe teknike. Politikat e tyre ekonomike u mishëruan në një kuadër të gjerë strategjik që ishte gjithëpërfshirës. Këndvështrimi i tyre për konkurrueshmërinë shkonte përtej dëshirës për të arritur te çmimi i kërkuar, pra shtrihej në një plan shumë më të gjerë institucional dhe normash rregullatore dhe të sjelljes. Perspektivat dhe zgjedhjet strategjike që bënë ishin vendimtare për suksesin e tyre. Pikëpamja e bashkërendimit me një kuadër strategjik mund të jetë çelësi i suksesit. Për të çuar më tej rritjen ekonomike, një kuadër strategjik, që vë theksin te ekonomia e hapur me politika makroekonomike të orientuara drejt konkurrueshmërisë kombëtare, siguron një mjedis makroekonomik më të fuqishëm. Kontrollimi apo shtrëngimi fort i ekonomive në emër të stabilitetit social apo financiar mund të frenojë konsiderueshëm rritjen ekonomike dhe zhvillimin e ndërmarrjeve**

Ekonomitë e mbyllura kundrejt atyre të hapura

- ***“Hapja e ekonomive, bashkë me përmirësimin e kapitalit njerëzor, është motori kryesor i rritjes. Vendet që ia dalin me sukses që të shkëmbejnë mallra dhe të tërheqin investime të huaja të drejtpërdrejta dhe krah pune, rriten më shpejt sesa vendet që nuk arrijnë të integrohen në ekonominë globale”.***
- Një ekonomi e hapur tërheq teknologji dhe shkëmbimin e ideve, si dhe promovon konkurrueshmëri. Hapja ndaj tregtisë dhe investimeve të huaja prodhon incentiva për ekonomitë që të përmirësojnë mjedisin e brendshëm të biznesit dhe infrastrukturën, në mënyrë të tillë që të shfrytëzojnë mundësitë.

Rëndësia e diversifikimit të ekonomive të ndërtuara mbi industrinë nxjerrëse

- Disa vende kanë luksin e burimeve të pasura natyrore, marrim naftën si shembullin më tipik, po përfitojnë nivele të larta IHD dhe rritje ekonomike falë rritjes së fundmi të çmimit të naftës. Sidoqoftë, u duhet të vendosin politika bazë të fuqishme.
- *Investimet e huaja të drejtpërdrejta (IHD) dihet që luajnë një rol vendimtar në zhvillimin e ekonomive në zhvillim, përfshi këtu edhe ekonomitë në tranzicion. Për pasojë, IHD po kërkohet me ngulm nga qeveritë e këtyre vendeve që për t'u zhvilluar, kanë nevojë për kapital të jashtëm. Disa nga ekonomitë në tranzicion të Azisë Qendrore dhe të Kaukazit kanë sasi të konsiderueshme nafte, gazi dhe mineralesh, që janë tërheqjet kryesore për investuesit e huaj, por disa ekonomi të tjera kanë më pak rezerva të tilla dhe hasin më tepër vështirë në thithjen e IHD-së në sektorët e brishtë të industrisë dhe shërbimeve. Megjithatë, edhe për këto vende që janë të bekuara me rezerva të mëdha natyrore, lind nevoja që të diversifikojnë ekonomitë e tyre që të mos varen së tepërmi nga këto burime, por të zhvillojnë industri përpunuese dhe shërbime. IHD mund të luajë rolin e një katalizatori të madh në këtë proces.*
- Ndërkohë që fondet nga nafta, gazi dhe burime të tjera sigurojnë fonde shtesë për qeverinë, krijimi i vendeve të reja të punës dhe rritja e fuqisë blerëse mund të qëndrojnë e kufizuar. Veç kësaj, këto ekonomi të varura së tepërmi nga nafta dhe burime të tjera, janë shumë të ndjeshme ndaj luhatjeve të çmimeve të tregut. Rezervat e Rusisë në naftë dhe gaz kanë sjellë pasuri të konsiderueshme kombëtare dhe potencë ndërkombëtare ekonomike, por Rusia vazhdon të qëndrojë mbrapa shumë vendeve të Evropës Lindore për sa i përket PBB-së për frymë dhe gjithashtu, tërheq pak IHD përveç atyre që lidhen me industrinë që bazohen në këto burime.
- Përshkrimi tradicional i ekonomistëve për zhvillimin e IHD-së është se, ekonomitë fillimisht janë ofruese të burimeve natyrore dhe pastaj kur vendosen lidhjet me investuesit e huaj dhe ndërtohet infrastruktura, bëhen destinacione për fuqinë punëtore më intensive si dhe për industrinë përpunuese. Kur vendet blejnë teknologji dhe pagat rriten, gradualisht zhvendosen drejt objektivave për shërbime dhe kapitale intensive më vonë. Shtetet që janë të pasura me rezerva natyrore duhet të zhvillojnë një kuadër politikash që u lejon të ecin përgjatë këtij cikli evoluimi.

Krijimi i një mjedisi të fuqishëm makroekonomik

- Është e vështirë të jepet një recetë politikash për krijimin e një mjedisi të fuqishëm makroekonomik dhe stimulimin e rritjes ekonomike, e cila të jetë e suksesshme në cdo ekonomi. Por padyshim kërkoet një klimë të favorshme biznesi dhe investimesh, sugjerohen politikat makroekonomike që karakterizojnë ekonomitë e hapura dhe të diversifikuara. Përgatitja e një strategjie afatmesme ekonomike është vendimtare. Një dokument strategjie rrit perceptimin e stabilitetit të investuesit dhe tregjet financiare. Një strategji e hartuar mirë dhe e bazuar në shqyrtim të kujdesshëm të çështjeve të ndryshme ekonomike dhe finale, çon në politika që lindin dhe zbatohen jo në përgjigje të rrethanave imediate politike, por në përgjigje të objektivave kombëtare.
- - ***Politikë e disiplinuar fiskale***. Ndryshimet në politikat fiskale që sjell mes të tjerash ulatje të nivelit të taksave, shqetësojnë si investuesit e huaj, edhe ata vendës. Premisat e borxheve të mëdha shqetësojnë edhe institucionet financiare ndërkombëtare. Shpenzimet e kontrolluara qeveritare të shoqëruara me nivel konkurrues taksash dhe një sistem tatimor të thjeshtë dhe të qëndrueshëm, promovojnë IHD-në dhe zhvillimin e NVM-ve.
- ***Mbështetje me politika të fuqishme për tregtine ndërkombëtare***. Politikat liberale tregtare janë të rëndësishme sepse u sigurojnë NVM-ve akses më të madh dhe tërheqin investues të huaj që kërkojnë të eksportojnë në tregje të tjera rajonale. Gjithashtu, politikat proteksioniste dekurajojnë investuesit. Politikat e fuqishme në mbështetje të tregtisë nënkuptojnë lidhjen e marrëveshjeve rajonale dhe dypalëshe të tregtisë së lirë, me vendin me tarifatat më të ulëta në përpunime me normat ndërkombëtare, aderimin në OBT, përdorim i pakufizuar i valutës së huaj në tregti dhe sistem doganor funksional dhe jo i korruptuar.
- ***Lehtësimi i vërshimit të fluksit të kapitalit ndërkombëtar***. Mund të ketë një tendencë për “të administruar” ekonominë makro nëpërmjet politikave monetare. Një Bankë Qendrore edhe pse ka disa “leva manovrash” në dispozicion, nuk mund të krijojë e vetme, të drejtojë apo administrojë një mjedis të favorshëm makroekonomik. Janë qeveritë ato që ndihmojnë në krijimin e mjedisit të favorshëm, kur lehtësojnë vërshimin e tregjeve me kapital ndërkombëtar nëpërmjet politikave që mbështesin këmbimin e monedhave, stabilizimin e kursit të këmbimit dhe interesat e ulëta.

Pra, qeveritë mund të krijojnë mundësi reale nëpërmjet:

- - ***Orientimit të politikave makroekonomike drejt rritjes ekonomike***. Rritja e PBB-së është tregues vendimtar për komunitetin e investuesve dhe rrit potencialet për investime.
- - ***Hapjes së ekonomisë***. Ekonomitë e hapura kanë shanset më të mëdha për sukses. Politikat që përqafojnë liberalizimin e tregtisë, vërshimin e lirë të kapitalit dhe lëvizjen e lirë të punëtorëve, stimulojnë aktivitetin ekonomik.
- - ***Diversifikimit të ekonomisë***. Varësia e plotë të industrisë nxjerrëse e lë ekonominë të brishtë ndaj ulatjeve të çmimit të mallrave dhe e pengon hapjen e vendeve të punës.
- - ***Krijimit të një strategjie***. Hartimi i një strategjie afatmesme bën që bizneset ta kenë më të lehtë planifikimin. Gjithashtu, niveli më i lartë i transparencës dërgon sinjale pozitive të investuesit

Veprimet dhe politikat e Qeverisë që përmirësojnë klimën e Biznesit

- **Një politikë e përgjithshme që më tepër nxit konkurrencën mes aktorëve privatë sesa vë qeverinë në rolin e timonierit imponues të ekonomisë, është një hap thelbësor në drejtimin e duhur. Politikat tatimore që janë transparente, të thjeshta dhe jodiskriminuese, janë tërheqëse për investuesit, sepse u mundësojnë sipërmarrësve të llogarisin kostot dhe fitimet e mundshme më kollaj sesa në një terren me tatime të ulëta, por të ndërlikuara. Incentivat e veçanta tatimore për investuesit e huaj rrezikojnë të shtrembërojnë konkurrencën dhe minojnë shëndetin e kompanive vendëse. Efikasiteti në rimbursimin e vlerës së shtuar për importet ndihmon bizneset të shmangin problemet me fluksin e cash-it. Politikat e punësimit mund të stimulojnë fleksibilitetin e tregut të punës dhe mbështetin zhvillimin e biznesit duke iu dhënë pronarëve kompetencën që lehtësisht të punësojnë apo të largojnë punëtorët. Investimet në infrastrukturë – rrugë, rrjete transporti, rrjetet e shpërndarjes së shërbimeve, ujësjellës, rrjete telekomunikacioni, vepra dhe shërbime publike dhe sistemet doganore – u lejojnë kompanive të huaja dhe vendëse që të përfitojnë plotësisht nga tregjet rajonale dhe globale. Në të njëjtën logjikë, investimet në capital njerëzor – përmirësimi i arsimimit, formimit profesional dhe trajnimet, e bëjnë një shtet më konkurrues në arenën ndërkombëtare. Mësimet e integritit ekonomik rajonal, zonave të tregtisë së lirë dhe kompaktit të investimeve, vërtetojnë që bashkëpunimi midis partnerëve tregtarë ka më shumë gjasa sesa izolimi apo proteksionizmi që të prodhojë përfitime ekonomike për të gjitha palët. Në fund, privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe trajtimi i barabartë i kompanive të sapoprivatizuara, tregojnë për një përkushtim të vendosur të shtetit për të lejuar konkurrencën që të vendosë vetë për suksesin apo dështimin e këtyre kompanive dhe për të garantuar një fushë loje të njëjtë për të gjithë nga e cila të përfitojnë konsumatorët.**

Politika e taksave

- **Taksat janë të domosdoshme për rritjen e të ardhurave publike të cilat pastaj janë të nevojshme për qeveritë që të financojnë operacionet e tyre dhe t'u garantojnë shtetasve sigurinë dhe shërbimet e tjera bazë. Megjithatë, praktikat dhe politikat tatimore joefikase, diskriminuese dhe tepër rënduese, mund të dekurajojnë pagimin me vullnet të lirë të taksave nga ana e tatimpaguesve. Kjo gjë ul nivelin e të ardhurave tatimore, rrit tundimin për korrupsion publik dhe i josh disa kompani që të përshtaten me praktikat jotransparente dhe joefikase për fshehjen e transaksioneve “jashtë regjistrave”. Në shumë ekonomi në tranzicion, procedurat për mbledhjen e taksave janë akoma të dobëta dhe evazioni tatimor është i përhapur. Te tilla janë dhe nderveprimet midis organeve tatimore- organeve doganore. Edhe mangësitë në sistemet gjyqësore shpesh e bëjnë të vështirë mbledhjen e taksave. Këto probleme i ngarkojnë një barrë të pabarabartë kompanive private që duan të respektojnë ligjin. Gjithashtu privojnë shtetin nga të ardhura aq shumë të nevojshme. Rritja e rrezikut dhe koston potenciale të evazionit tatimor dhe nxitja e kulturës së qeverisjes së përbashkët, mund të bindë firmat që të mos ndërmarrin praktika të paligjshme. Megjithatë, ashtu si politikat dhe praktikat e këqija tatimore frenojnë investimet e huaja dhe zhvillimin e NVM-ve - për shkak se rritin koston e tyre, injektojnë rrezik dhe pasiguri, dhe pakësojnë konkurrueshmërinë e tyre – politikat tatimore pro-zhvillim duhet të kenë si kryefjalë jo vetëm rritjen në maksimum të mbledhjes së taksave, por edhe mbajtjen e një mjedisi të biznesit që nxit zhvillimin ekonomik**

Ndikimi i mjedisit të biznesit të firmat (BB)

- Mundësitë dhe incentivat për firmat që të investojnë, të hapin vende pune dhe të rriten, varen nga fitimet e pritshme. Fitimet ndikohen nga kostot, risqet dhe barrierat ndaj konkurrencës. Qeveritë mund të kenë një ndikim të madh në secilin prej tre faktorëve të mëposhtëm.
- - **Mbi kostot:** nepermjet barrieres rregullatore dhe procedurale, taksave, nivelit të korrupsionit, shërbimeve të infrastrukturës, rregullimeve të tregut të punës, dhe financave;
- - **Mbi riskun:** nepermejt politikave të parashikueshme, të drejtave të pronësisë dhe ekzekutimit të kontratave;
- - **Mbi barrierat ndaj konkurrencës:** nepermjet rregullimeve që kontrollojnë bizneset e reja dhe falimentimin, ligjit për konkurrencën, dhe hyrjen në tregjet e financave dhe infrastrukturës.

- Nivelet e taksave mund të ndikojnë në vendimin e investuesve se ku të investojnë brenda një rajoni specifik. Sidoqoftë, regjimet tatimore progresive shpesh gjenerojnë kuadro rregullash të ndërlikuara që ua bëjnë të vështirë kompanive të parashikojnë detyrimet tatimore. Si rezultat, bizneset e sofistikuara tërhiqen më pak nga taksat nominale të ulëta sesa nga barra tatimore përgjithësisht e ulët.
- Faktet gjithashtu konfirmojnë se investuesit konsiderojnë infrastrukturën bazë, stabilitetin politik dhe kostot e punës më të rëndësishme sesa nivelin e taksave për vendimet e tyre për investime. Gjithashtu, incentivat tatimore që janë bujare me tepri duke u dhënë privilegje të veçanta investuesve të huaj, mund të dëmtojnë NVM-të dhe konkurrencën vendëse, rritin kostot e administrimit, shkaktojnë shtrembërime të tregut dhe çojnë në rritje të korrupsionit. Kjo do të thotë që, regjimet tatimore për firmat duhet të bazohen në politika të balancuara që projektohen në planin afatgjatë³.
- **Thjeshtim i taksës mbi të ardhurat**- ndihmon në sheshimin e fushës së lojës midis kompanive, inkurajon pagimin e vullnetshëm të taksave, ndihmon kompanitë të parashikojnë kostot më mirë dhe të bëjnë projeksione më të sakta financiare, si dhe nga ana tjetër e bën më të lehtë mbledhjen e taksave. Në përgjithësi, një sistem më i drejtë dhe më i thjeshtë me nivele të ulëta tatimore që nuk diskriminon kompanitë, është baza më e mirë për tërheqjen e IHD-së dhe zhvillimin e sipërmarrjeve.
- **Taksat e sheshta**. Një mënyrë e thjeshtimit të tatimit është eliminimi i tatimit progresiv dhe adoptimi i një “takse të sheshtë”, domethënë një nivel të vetëm për taksat mbi fitimin dhe të ardhurat⁴. Kjo masë mund të aplikohet në rrethana të caktuara dhe për një periudhë kohe, si një prelud ndaj një kthimi të mundshëm të tatimit progresiv. Estonia ishte ndër të parat vende në Evropën Lindore që aplikoi lëvizjen e Taksës së Sheshtë, në 1994. Taksa e sheshtë është në thelb një taksë e vetme e përbashkët për të ardhurat e kompanive dhe personale, me idenë që thjeshtësia e sistemit ia bën qeverisë më të lehtë që të mbyllë shtigjet dhe të ndjekë penalisht shmangësit, duke rritur motivimin e tyre që të prodhojnë ose të fitojnë më tepër, sepse tatimi marxhinal mbi ta mbetet konstant. Ulja e nivelit të tatimit e bën evazionin më pak tundues. Taksa e sheshtë ka rezultuar e suksesshme edhe në shtetet e mëdha si Rusia ku qeveria uli tatimin mbi të ardhurat nga 35 në 24 përqind. Rusia e aplikoi taksën e sheshtë në 2001-shin dhe pati një rritje prej 26% të të ardhurave që në vitin e parë, veçanërisht falë pagimit të detyrimeve të prapambetura. Shumica e vendeve e kanë taksën e sheshtë në nivelet 25% e megjithatë kanë arritur të tërheqin të ardhura dhe IHD shtesë, duke demonstruar që për firmat është më tërheqës një sistem tatimorë që u lejon të parashikojnë me saktësi detyrimet tatimore, në krahasim me një sistem kompleks me vlerë të ulët nominale të taksave por me rezultate të paparashikueshme.
- **Zbritja e ri-investimeve**. Suksesi i qeverisë estoneze në tërheqjen e IHD-së ishte kryesisht falë një politike novatore sipas të cilës fitimet që ri-investohen në kompani, nuk janë objekt tatimi. Përveç se ul barrën e përgjithshme tatimore, kjo politikë është një inkurajim pozitiv për kompanitë që të zgjerojnë bizneset e tyre dhe rrjedhimisht të shtohen vendet e punës.

- ***Rimbursimi i taksës mbi vlerën e shtuar.*** Në shumë sisteme tatimore për shitjet, inputet tatohen fillimisht dhe pastaj outputi përfundimtar tatóhet sërish pasi inputet janë përdorur për të prodhuar një produkt. Kjo rezulton në tatim të shumëfishtë me efekt frenues. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) synon të shmangë problemin e tatimit të shumëfishtë. TVSH aplikohet për konsumin përfundimtar të mallrave apo shërbimeve nga konsumatori i fundit. Mblidhet në çdo fazë të blerjes dhe shitjes, por garantoheh zbritje për taksat e paguara nga blerjet e mëparshme.
- Kompanitë e regjistruara në zyrat tatimore vendore për TVSH lejohen të pretendojnë rikthimin e një shume për TVSH-në që u kanë paguar furnitorëve. Ajo që kompanitë duhet t'u paguajnë autoriteteve tatimore rregullisht është teprica midis shumës së çmimeve që u vënë klientëve (taksa për outputin) dhe shumës së TVSH-së që u kanë paguar furnitorëve (taksa e inputit). Kompanitë e huaja zakonisht mund të marrin rimbursime për TVSH-në e paguar për blerjet për të cilat bizneset e regjistruara për TVSH mund të pretendojnë zbritjen e taksës së inputit nga rimbursimi vendor i TVSH-së. Po të mos kishte masa të tilla lehtësuese për bizneset e huaja, sistemi i TVSH-së do të konsiderohej diskriminues dhe shkelje e marrëveshjeve ndërkombëtare tregtare. Gjithashtu, TVSH normalisht rimbursohet sipas produkteve të eksportuara nga shteti tates. Investues dhe eksportues të huaj në mjaft vende ndeshin vështirësi të konsiderueshme në marrjen e rimbursimit të TVSH-së. Ndonjëherë rimbursimi i papaguar i TVSH-së kompensohej me taksat e tjera. Në disa raste, pengesa kryesore për rimbursimin e TVSH-së duket se është mungesa e vullnetit të autoriteteve që të kthejnë "të ardhurat" që në fakt nuk u takon t'i mbajnë⁷. Vendet që dëshirojnë të tërheqin dhe mbajnë investime të huaja dhe të promovojnë bizneset vendëse eksportuese, duhet të marrin hapa që të garantojnë rimbursimin e TVSH-së saktë dhe shpejt.
- ***Dosjet elektronike.*** Shumë nga vonesat dhe mangësitë e lidhura me kthimin e tatimeve mund të zvogëlohen nëpërmjet skedimit elektronik me bazë Internetin.

Roli i doganave

- *Shtetet që nuk arrijnë të mbajnë ritmin e standardeve botërore për administratën doganore, do ta kuptojnë që investuesit nuk mund t'i përballojnë kostot e larta logjistike që u imponohen nga paaftësia e doganave. Ministrat e Financave të këtyre vendeve do ta shohin që investimet e huaja të drejtpërdrejta do të shtegtojnë drejt shteteve me administrata doganore më të sofistikuar.*
- **Niveli i lartë i tarifave për mallrat dhe shërbimet rrit kostot e prodhimit. Kompanive që kërkojnë një vend me kosto të ulëta nga ku të eksportojnë, mund t'u dekurajohen objektivat nga këto tarifa. Paaftësitë e administratës që shkaktojnë vonesa në çdoganim, ndërpresin ciklet prodhuese dhe aftësinë për të dërguar mallrat në treg. Administrata doganore është një nga segmentet më shpesh të korrupsuara dhe agjencitë e korrupsuara doganore janë kundrapedalet më të dukshëm për tregtinë dhe investimet. Korrupsioni në autoritetet doganore është më problematiku, në mos problemi më i madh i administratës.**

Politikat e punësimit dhe fleksibiliteti i tregut të punës

- **Fleksibiliteti i tregut të punës është jetik për garantimin e përdorimit maksimal të kapitalit njerëzor. Një studim së fundmi i kryer për Bankën Botërore doli në përfundimin se, “sa më fleksibël të jetë tregu i punës në ekonominë vendëse në krahasim relativ me vendin e origjinës së investuesit, aq më të shumta janë gjasat për investime në këtë vend” (10 Mariana Spartareanu dhe Beata Smarzynska, A shqetësohen investuesit nga rregullimet e tregut të punës?, Banka Botërore, Karta e Politikave Kërkimore 3275 (prill 2004)).** **Fleksibiliteti i tregut të punës është veçanërisht i rëndësishëm për vendet që ndjekin një politikë privatizimi. Kompanitë që blejnë ndërmarrje shtetërore shpesh e pakësojnë numrin e punëtorëve për ta bërë ndërmarrjen më efikase dhe fitimprurës. Një treg pune fleksibël duhet të përthithë punëtorë të rinj. Kompanitë duhet të jenë në gjendje të punësojnë punëtorë me orar të shkurtuar, punëtorë sezonale, punëtorë me më shumë se një punë dhe punëtorë me kontratë. Kur kjo është e pamundur, rezultati mund të jetë rritja e papunësisë dhe zhvendosja e punëtorëve drejt ekonomisë informale.**

Cilët janë elementët kryesorë të një tregu pune fleksibël?

- ***(1) Më tepër liri për të vendosur për fuqinë punëtorë*** në përputhje me nevojat e biznesit që është një pjesë e rëndësishme e përmirësimit të klimës së biznesit në vend. Kostot e punës mund të arrijnë në një pikë në raport me të ardhurat saqë kompania falimenton nëse nuk ul këto kosto. Perkundrazi, shteti duhet të mbrojë punëtorët kundër çdo lloj forme shfrytëzimi të padrejtë apo diskriminimi, dhe duhet të vendosin masa mbrojtëse për uljen e mundësive për dëmtime dhe vdekje në punë. Madje, deri vendosje sanksione kunder pushimit, kufizime për kontratat e punës dhe njoftim paraprak për nderprerje marredheniesh, kompensime për shkurtim vende pune, etj.
- ***(2) Mundësi për punëtorët që të punojnë orë shtesë.*** Shumë qeveri vendosin një kufi të rreptë për numrin e orëve që një punëtor mund të punojë gjatë javës. Ky kufizim shpesh nuk është i njëjtë për të gjitha industritë dhe mund të kufizojë prodhueshmërinë e një kompanie. Për më tepër, shumë punëtorë e dëshirojnë mundësinë për t'u paguar për orë shtesë. Si rrugë e mesme midis punëtorëve dhe punëdhënësve, legjislacioni mund të ndalojë punëdhënësit që të detyrojnë punëtorët të punojnë orë shtesë, por u lejon punëtorëve të bëjnë një gjë të tillë me dëshirë, në shkëmbim të një kompensimi me te larte.
- ***(3) Sigurime shoqërore të arsyeshme/tatime punësimi.*** Barra tatimore mbi punëtorët në shumë ekonomi në tranzicion mund të jetë e lartë, deri në 50% të rrogës së punëtorët ose më shumë. Bile, taksat e larta për kontributet shoqërore shkaktojnë uljen e rrogave dhe nxitin kompanitë që të mos respektojnë plotësisht legjislacionin për punën dhe tatimet.
- ***(4) Liria për të punësuar punëtorë me kontratë, të përkohshëm apo me orar të shkurtuar.*** Bizneset shpesh kanë nevojë për punëtorë sezonale ose në varësi të projekteve. Ato duhet të jenë në gjendje të punësojnë punëtorë për të përmbushur nevojat specifike. Po t'i kërkojnë firmave që të punësojnë punëtorë me orar të plotë, kjo rezulton ose në punësime më të pakta në numër, ose në kompani më pak fitimprurëse që, ose do të paguajnë më pak taksa, ose do ta kenë të pamundur mbijetesën.
- ***5) Detyrime të arsyeshme në lidhje me formimin profesional.*** Punëdhënësve mund t'u kërkohej që të sigurojnë një shkallë të arsyeshme trajnimit për punëtorët që ta kryejnë punën mirë dhe të rritin kualifikimin personal në fuqinë punëtore kombëtare. Kërkesa të tilla nuk duhet të jenë imponuese aq sa të dëmtojnë panoramën e përgjithshme të prodhueshmërisë dhe fitimprurjes së kompanisë.
- ***Nje shembull pozitiv:*** Pas ristrukturimit të ekonomisë, Sllovakia kishte papunësi të lartë, një nga më të lartat në Evropë. Megjithatë, me tërheqjen së fundmi të IHD-së dhe futjes së kodit të ri të punës, papunësia ra ndjeshëm. Në vitet 2001 dhe 2003, Sllovakia i bëri ndryshime të mëdha kodit të punës dhe rrjedhimisht krijoi një nga tregjet e punës më fleksibël në botë. Në studimin e 2004-s të Bankës Botërore, "Të Bësh Biznes", Sllovakia citohej si reformuesja më e madhe. Disa nga reformat e Sllovakisë kane qene:
 - - Kalimi nga kontrata pune me orar te plote ne kontrata me orar të shkurtuar për femrat, studentët dhe pensionistët;
 - - Lejimi i ripërteritjes se kohezgjatjes se kontrates;
 - - Rritja e limitit maksimal te oreve shtese ne vit nga 150 në 400 ore, me pëlqimin e punëtorit;
 - - Heqja e kriterit per miratimin e sindikates per pushimin e nje punetori nga puna; etj.

Investimet në infrastrukturë

- Cilësia e infrastrukturës së një vendi – rrugët, rrjetet e transportit, rrjetet e shpërndarjes së shërbimeve, ujësjellësit, rrjetet e telekomunikacioneve, punët dhe shërbimet publike, sistemit doganor dhe sistemi arsimor – është vendimtare për tërheqjen e investimeve të huaja dhe NVM-të e sapoformuara.
- Ne cdo rast investimet në infrastrukturë – sidomos duke përfshirë parqet shkencore dhe industriale – shfaqen si motorë të zhvillimit ekonomik në fusha të caktuara. Po ashtu, krahas rrjetit të transportit, një ndikim të lartë ka furnizimi me energji elektrike. Madje, rrjeti energjetik duhet të jetë i qëndrueshëm: Një ndërprerje e vetme dhe e paplanifikuar në aktivitet për disa prodhues që përdorin makineri me kalibrim të lartë, mund të jetë tepër e kushtueshme. Infrastruktura e cilësisë së lartë ul kostot e hyrjes në treg për investuesit dhe sipërmarrësit, lehtëson zhvillimin e eksportit dhe siguron një avantazh konkurrues kundrejt destinacioneve të tjera që ofrojnë imput kostosh të ngjashme si puna dhe trualli, por që kanë infrastrukturë më pak të zhvilluar. Partneritetet publik-privat (PPP) janë një instrument i mirë për të mundësuar qeveritë që të financojnë projektet investuese në infrastrukturë
- **Transporti është parakusht bazë për zhvillim kombëtar ekonomik dhe social.** Investimi në infrastrukturën e transportit përcakton një përqindje të madhe të aktivitetit ekonomik të një vendi. Transporti është një shtysë e padiskutueshme për zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare. Transporti ndërkombëtar është, gjithashtu, vendimtar për integrimin ndërkombëtar dhe për reduktimin e pabarazive sociale dhe ekonomike përmes kufijve. Lehtësimi dhe zhvillimi i rrjeteve ndërkombëtare të sigurt të transportit është me rëndësi strategjike për të gjitha vendet. Pra, ne pergjithesi, transporti është jetik për funksionimin e mirë të aktiviteteve ekonomike, për prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave dhe për tregtinë. Aftësia e një sipërmarrësi, NVM-je, kompanie apo një vendi për të konkurruar suksesshëm, të zhvillojë më tepër aktivitetit dhe të integrohet në ekonominë kombëtare apo globale, varet jo vetëm nga kapacitetet prodhuese, por edhe nga aftësia për të sjellë në treg mallra me çmimin më të ulët të mundshëm dhe nën kushte të arashikueshme. NVM-të përfitojnë nga kostot më të ulëta në dërgimin e mallrave të tyre në tregje. Koha më e shkurtër për të shkuar në treg sjell jo vetëm ulje të shpenzimeve operative, por edhe mundësinë për të lëvizur më shumë mallra në më pak kohë, gjë që ka efekt pozitiv në qarkullimin e parasë. Infrastruktura e shkëlqyer e transportit është e nevojshme sidomos për vendet pa dalje në det. Mungesa e aksesit në det është shtytja e shkëlqyer për ndërtimin e një rrjeti rrugësh, hekurudhash dhe transporti lumor jetik për aksesin në tregje dhe integrimin rajonal.
- *Ndërmarrjet shumëkombëshe janë veçanërisht të ndjeshme ndaj infrastrukturës kur vendosin se ku të ngrenë investimet e ideuara për të ushqyer tregjet globale, rajonale apo vendëse, pasi këto investime nga natyra kërkojnë efikasitet.*

Investimet në kapital njerëzor

- ***Arsimi i përgjithshëm dhe trajnimi për aftësi pune.*** Kapitali njerëzor është një nga avantazhet konkurruese që një ekonomi në zhvillim mund të ofrojë përmes kostos së ulët, njohjes së disa gjuhëve, arsimimit solid, veçanërisht arsimimi teknik dhe formimi profesional¹⁵. Vendet pa burime të mëdha natyrore mund t'u ofrojnë investuesve kapitalin njerëzor. Qoftë me shërbime ose prodhime me punë intensive, vendet që ofrojnë fuqi punëtore të kualifikuar me çmim të përballueshëm, gjithmonë do të tërheqin investime. Një komponent themelor i zhvillimit të kapitalit njerëzor, është arsimi bazë. Themelet e forta krijohen nga sistemi shkollor kombëtar që siguron trajnim të fuqishëm në konceptet e biznesit dhe në disiplinat matematikore dhe teknike, si edhe në gjuhë të huaja. Është e domosdoshme që qeveritë të inkurajojnë pjesëmarrjen e plotë në arsim. Njohuritë e fuqishme të gjuhëve të huaja mundësojnë rritjen e punësimit të banorëve vendës në investimet e huaja, pasi ata kanë përqindje njohurish më të lartë.
- ***Arsimi për biznesin.*** Vendet me ekonomi në tranzicion mund të nxitin zhvillimin ekonomik duke promovuar sistematikisht respektimin e ndërmarrjes dhe sipërmarrësit midis nëpunësve civile dhe publikut të gjerë. Në shumicën e vendeve në tranzicion dhe në disa vende në zhvillim, mendësia e epokës së ekonomisë së centralizuar vazhdon të ekzistojë dhe perceptimet për sipërmarrësit kanë ngjyrimet negative. Ndryshimi i qëndrimit popullor ndaj sipërmarrësve është një proces afatgjatë dhe mënyra më e mirë për të pasur sukses është integrimi i trajnimit ose mësimave për biznesin përgjatë gjithë sistemeve të arsimit dhe formimit profesional, përfshirë dhe organizimin e fushatave të veçanta për nxitjen e biznesit.

Integrimi ndërkombëtar dhe rajonal

- Një nga hapat konkrete që mund të marrin qeveritë për përmirësimin e klimës së biznesit dhe investimeve, është bërja e përpjekjeve për integrim ndërkombëtar dhe rajonal. Përveç vendosjes së politikave ekonomike që e “hapin ekonominë”, qeveritë duhet të marrin pjesë në organizata shumëpalëshe, kompakte, dhe marrëveshje për tregtinë dhe investimet, të cilat vendosin lidhje biznesi dhe ekonomike. Aderimi në Organizatën Botërore e Tregtisë (OBT). Përfitimi më i rëndësishëm ndoshta nga aderimi në OBT është përmirësimi i mjedisit të biznesit që stimulon investimet e huaja të drejtpërdrejta. Qeverisja më e mirë, standardet e sigurisë, mbrojtja e pronësisë intelektuale dhe kushte të tjera që kërkohen nga investuesit, janë vetë kritere për anëtarësim në OBT.
- ***Vendosja e marrëdhënieve me Bashkimin Evropian.*** Një nga shkaqet e suksesit ekonomik të arritur në Evropën Qendrore dhe Lindore në vitet e fundit, është procesi i anëtarësimit në BE. Procesi i anëtarësimit ka rritur investimet dhe interesimin për vendet kandidatë nga ana e shteteve anëtare të BE-së. Falë zhvillimit të shpejtë ekonomik të nxitur nga procesi i anëtarësimit, disa vende që aderuan së fundmi në BE – përfshi Republikën Çeke, Hungarinë dhe Poloninë – po cilësohen tashmë si ekonomi “të zhvilluara”. Vende të tjera si Bullgaria, Kroacia dhe Rumania, po manifestojnë rritje të shpejtë të IHD-së dhe rrogave. Harmonizimi i praktikave dhe politikave vendëse me ato të BE-së e rrit besimin te investuesit. Madje, miratimi i ligjeve, akteve dhe politikave të krahasueshme me Acquis Communautaire ndikon fuqishëm në këto rritje.
- ***Marrëveshje rajonale të tregtisë së lirë.*** Shumë nga vendet në Evropën Juglindore dhe Azinë Qendrore kanë një larmi marrëveshjes dypalëshe dhe shumëpalëshe të tregtisë së lirë, por nuk kanë ndonjë marrëveshje gjithëpërfshirëse rajonale të tregtisë së lirë. Pakti i Stabilitetit ka qenë aktiv duke u munduar të unifikojë mjaft marrëveshjet dypalëshe tregtare në një marrëveshje të vetme të tregtisë së lirë për Evropën Juglindore. Nisma të ngjashme mund të ndërmerren edhe nga vendet e tjera. Keshtu, p.sh., e tillë është **Marreveshja e Tregtisë së Lire e Amerikës së Veriut** (*North American Free Trade Agreement - NAFTA*). Qëllimi i përpjekjeve të tilla është që tregu të jetë sa më tërheqës për investuesit duke ua lehtësuar atyre mundësitë për të bërë biznes nëpër rajon, dhe duke siguruar tregje eksporti të reja për NVM-të.

Privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore

- Një përqindje e konsiderueshme e PBB-së në shumë ekonomi në zhvillim dhe në tranzicion e kanë origjinën nga ndërmarrjet shtetërore. Ndërkohë që vendet përpiqen të përmirësojnë klimën e biznesit dhe të konkurrojnë në ekonominë globale, qeveritë duhet të kalojnë nga roli i aktorit ekonomik në rregullator i pavarur. Detyra e qeverisë është të sigurojë kuadrin për firmat që të kenë sukses dhe të zgjidhin mosmarrëveshjet mes firmave, më tepër sesa të veprojnë në vend të firmave. Privatizimi është njëra metodë për të asistuar qeveritë që të lëvizin në këtë drejtim ndryshe nga pronësia shtetërore e mjeteve të prodhimit që ka qene parimi kryesor i ideologjisë socialiste. Nën ndikimin e ekonomistë kejnesianiste, edhe qeveritë perëndimore si ajo e Britanisë së pasluftës zotëronin dhe operonin me ndërmarrje të mëdha industriale. Por në vitet 1980, mangësitë dhe shtrembërimet e konkurrencës për shkak të zotërimit të ndërmarrjeve nga shteti ishin të dukshme për vendet me ekonomi tregu. Qeveritë e këtyre vendeve filluan të çliroheshin nga bizneset që mund të menaxhoheshin më mirë nga privatët. Privatizimi synon të promovojë eficienten duke i nënshtruar bizneset nën peshën e konkurrencës në tregun e lirë. Përveç kësaj, disa qeveri kërkojnë të arrijnë objektiva socialë dhe me anë të privatizimit e kalojnë pronësinë e kompanive në duart e punëtorëve të tyre apo të publikut të gjerë. Megjithatë, në shumicën e rasteve, rezultatet e këtij privatizimi kanë qenë zhgënjyese. Monopolet shtetërore opake dhe mosllogaridhënëse u kthyen në monopole private opake dhe mosllogaridhënëse. Për shkak të korrupsionit, mungesës së transparencës, paaftësisë dhe ndikimit politik në procesin privatizues, disa asetë publike u blenë ose u shtinë në dorë nga individë apo kompani private vetëm për një fraksion të vlerës së tyre reale.
- Mungesa e mundësive për të tregtuar aksionet shpesh pengon rritjen e kapitaleve shitesë të nevojshme për zgjerim. Për më tepër, në disa vende, privatizimi ka qenë selektiv dhe i paplotë; shumë kompani të mëdha vazhdojnë të jenë në pronësinë e shtetit. Nuk ekziston një metodë e vetme e sigurt që të garantojë privatizim të suksesshëm. Privatizimi është një proces politikisht i diskutuar dhe kompleks që ndikohet nga kushtet vendore dhe karakteristikat specifike të entitetit që privatizohet.
- Disa perfundimee:
- ***Përfitimet e privatizimit.*** Privatizimi mund të rrit konsiderueshëm prodhueshmërinë e firmave, të prodhojë mirëqenie dhe të kontribuojë në rritjen e tregjeve të aksioneve Megjithatë, privatizimi mund të rezultojë në rritje të papunësisë në planin afatshkurtër. Vendet që i nënshtrohen procesit të privatizimit duhet të parandiejnë dhe të parapërgatiten që të përballojnë rritjen fillestare të papunësisë nëpërmjet rikualifikimit dhe praktikave të tranzitimit të punës. Nëse kryhet si duhet, benefitet afatgjata të privatizimit – edhe për sa i përket punësimit dhe pagave – tejkalojnë ndjeshëm efektet negative fillestare. Por kjo kërkon që procesi i privatizimit të jetë transparent dhe që të ekzistojnë institucionet mbështetëse ose ato të krijohen në planin afatshkurtër, ku përfshihet: mbrojtje e mjaftueshme nga shteti i së drejtës i pronësisë private, konkurrencës, sistemi i mirë i qeverisjes, tregtimi dytësor i aksioneve, kufizime të forta buxhetore dhe legjislacion i duhur.

- **Metodat e privatizimit.** Qeveritë privatizojnë kompanitë në tri mënyra kryesore: (1) privatizim me ndarje aksionesh, (2) shitje asetesh të një blerës i vetëm, dhe (3) privatizim masiv ku u lëshohen letra me vlerë punonjësve të ndërmarrjeve shtetërore ose publikut të gjerë, duke i bërë ata të interesuar në kompaninë e privatizuar, zakonisht falas ose me një çmim të ulët. Shumë ekonomistë besojnë se privatizimi me letra me vlerë është më pak efikas për nxitjen e zhvillimit ekonomik sesa qasjet e tjera. Ata argumentojnë se kur pronësia e kompanive shpërndahet shumë, menaxhimi i kompanisë priret të jetë më pak efikas për shkak se asnjë aksioner apo grup koheziv aksionerësh nuk ka fuqinë e mjaftueshme për t'i kërkuar llogari administratës menaxhuese.
- **“Politikat e privatizimit masiv...”** garantojnë premisat e një shtrese të gjerë aksionerësh, por përfundimisht varen nga tregjet e kapitalit për të arritur përqendrimin e aksioneve në duart e investuesve strategjikë që mund të marrin kontrollin.
- **Privatizim i pastër.** Privatizimi duhet të jetë në thelb lejimi i ndërmarrjeve shtetërore që të bëjnë kalimin e plotë në pronësi private, menaxhim të pavarur dhe konkurrencë në treg. Përfitimet e privatizimit vështirë të materializohen nëse qeveria planifikon (1) të mbajë një interes kontrollues në kompaninë e privatizuar, (2) të ndërhyjë në çështjet e saj sikur kjo kompani të ishte akoma ndërmarrje shtetërore, ose (3) të detyrojë kompaninë të kryejë funksione publike. Prandaj, nëse qeveritë mbajnë një pjesë të entitetit të privatizuar, kjo pjesë duhet të jetë më pak sesa pjesa kontrolluese. Aq më pak qeveria në fjalë nuk duhet të mbajë “të drejtat e aksioneve të arta” që i lejon ndikim më të madh në çështjet e kompanisë sesa aksionerët e tjerë.
- **Ristrukturim para privatizimit.** Zyrtarë shtetërore shpesh besojnë se po ta bëjnë kompaninë më prodhuese dhe më fitimprurëse përpara privatizimit, do të arrijnë ta shesin më shtrenjtë. Kjo normalisht do të thotë “ta shtrëngosh rripin” para se ndërmarrja të privatizohet, në mënyrë që t'i jepen avantazhe që mund t'i gëzojë sapo të privatizohet. Kjo gjë padyshim shtrembëron konkurrencën e tregut duke e anuar fushën e lojës. Për më tepër, meqë logjika e privatizimit është se qeveritë nuk janë menaxherët më të mira të biznesit, sapo merret vendimi për të privatizuar një ndërmarrje shtetërore, nuk ka kuptim që papritur të rehabilitosh firmën përpara se të privatizohet.
- **Privatizimi rast pas rasti kundrejt privatizimit në plan të gjerë.** Privatizimi mund të bëhet mbi bazën rast pas rasti, ose mund të aplikohet në mase për grupet e mëdha të ndërmarrjeve shtetërore. Normalisht qasja rast pas rasti jep rezultate më të mira.

- **Hapje ndaj pronësisë së huaj.** Përveç kufizimeve të ligjshme për pjesëmarrjen e huaj në të ashtuquajturit “sektorë strategjikë”, qëndrimi publik dhe dëshira e ndërmarrjeve vendëse për të shmangur konkurrencën e huaj, shpesh peshon kundër lejimit të firmave të huaja që të marrin pjesë në tendera privatizimi. Për më tepër, lejimi i investuesve të huaj që të blejnë aksione në entitetet e privatizuara mund të stimulojë investime të mëtejshme të huaja.
- **Përfundimi i konkurrentëve të huaj ngre probleme substanciale, sidomos në rastin e privatizimit masiv.** Kur një vend pasocialist bëhet gati për të privatizuar një pjesë të madhe të ekonomisë, pasuria brenda vendit është e pamjaftueshme për të siguruar një çmim shitjeje të lartë për asetet. Kështu që alternativa mbetet ose pronësia e shpërndarë, qoftë edhe për firmat e mëdha, ose privatizimi pa para të thata. E dyta mund të rezultojë në pronësi joefikase dhe/ose të ardhura të ulëta nga privatizimi, duke rezultuar në zhgënjim nga reformat.
- **Transparencë në procesin e privatizimit.** Procesi i privatizimit duhet të jetë pa konflikte interesi dhe duhet të kryhet në mënyrë të hapur, me njoftim të mjaftueshëm për publikun e të gjithave shtresave kryesore. Bërja transparente e procesit për të gjithë grupet e interesit, mund të jetë më shumë i tejzgatur në kohë sesa puna pas dyerve të mbyllura, por rreziqet e korrupsionit, nepotizmit, pengimi i investuesve të huaj, dhe reagimi i ashpër publik, të gjitha këto rritin paqartësinë e procesit të privatizimit.
- **Statusi i pasprivatizimit.** Kompanitë e privatizuara duhet të jenë objekt i ligjeve të njëjta, rregullave dhe akteve ligjore si kompanitë e tjera. Çfarëdo privilegji që një kompani gëzonte nga të qenit ndërmarrje shtetërore, nuk duhet të ekzistojë më pasi ajo privatizohet. Nëse kompania e privatizuar zë pozita dominuese në treg, ajo duhet t’i nënshtrohet të gjitha sanksioneve ligjore normale për abuzimin me pozitën. Kështu, një entitet i privatizuar që angazhohet në ndërshtetërisht, çmime monopol apo marrëveshje të dëmshme në shitjen e mallrave dhe shërbimeve, duket të jetë subjekt i të njëjtave sanksione si çdo ndërmarrje tjetër private. Qeveritë duhet të lejojnë entitetet e privatizuara të kenë sukses apo të dështojnë si çdo biznes tjetër, dhe kompanitë e privatizuara duhet të jenë subjekt i legjislativimit të falimentimit, përfshi mundësinë e riorganizimit të pavullnetshëm apo likuidimit. Entiteti i privatizuar duhet të ketë të njëjtën liri si kompanitë e tjera në punësimin apo pushimin e punëtorëve, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, dhe të reduktojë apo eliminojë linjat e biznesit. Entiteti nuk duhet të detyrohet të operojë me humbje që të mbajë çmimet e ulëta, të kryejë transferime të veçanta të teknologjisë, ose të bëjë investime të tjera të pakërkuara nga kompanitë e tjera.

Rekomandime

- **Politikat tatimore** (Per reformimin e sistemeve tatimore, qeverite duhet : te përpiqen të thjeshtojnë strukturat tatimore; të garantojnë rimbursim të shpejtë të TVSH-së për eksportin; dhe të ofrojnë skedim me anë të Internetit).
- **Politikat e punës** (Krahas mbrojtjes se te drejtave themelore te punetoreve, qeverite duhet te reduktojne pengesat e panevojshme për punësimin e pushimin e punëtorëve kur diktohet nga rrethanat e bizneseve. Punedhënesit duhet te kene te drejten te punesojne punetore me kontrata, me kohe te pjesshme apo të përkohshme, dhe të angazhojnë punëtorët me vullnetin e tyre që të punojnë orë shtesë në shkëmbim të një kompensimi të arsyeshëm. Qeverite duhet te garantojne qe kushtet e vendosura mbi punedhënesit per pagimin e taksave shoqërore dhe për trajnimin e punëtorëve, të jenë të arsyeshme dhe jo mbirënduese).
- **Politikat e infrastrukturës** (Qeverite duhet te perpiqen qe te krijojne infrastruktura moderne per transportimin, komunikimin, etj. Duke bërë këto, qeveritë duhet të kenë parasysh nëse partneriteti publik-privat mund të arrijë qëllimet e politikave të infrastrukturës. Me ndërtimin e infrastrukturave, ato duhen mirëmbajtur dhe kjo kërkon planifikim afatgjatë).
- **Politikat e investimeve njerëzore** (Qeverite duhet te investojne shume ne arsimin dhe formim profesional e teknik ne fushat që do t'i mbajnë qytetarët dhe vendet e tyre konkurrues në të ardhmen. Po ashtu, qe te rriten kapacitetet e komunikimit ne anglisht, njohurite e tregut dhe arsimin e specializuar në sipërmarrje).
- **Politikat rajonale tregtare per akses në tregjet e huaja.**
- **Politikat e privatizimit** (Per privatizimin e ndermarrjeve shtetërore, qeverite duhet: të transferojnë kontrollin e plotë dhe efikas të kompanisë së privatizuar te pronarët e saj privatë; të mos mbajë të drejta speciale të “aksioneve të arta” me anë të të cilave qeveria mund të bllokojë apo orientojë vendime të caktuara të kompanisë së privatizuar; të mos rehabilitojnë kompanitë përpara se të privatizohen; të lejojnë të huajt të konkurrojnë për pronësinë e kompanisë (përveç rasteve të “sektorëve strategjikë” si industria e mbrojtjes); dhe – të mos japin preferenca dhe as të vendosin kushte rënduese mbi pronarët e kompanive të sapoprivatizuara, por të lejojnë forcat e tregut dhe aftësitë administuresë të përcaktojnë suksesin apo dështimin e kompanisë).

Rëndësia e Ligjit dhe Rregullimeve në Zhvillimin Ekonomik

- Kur ekonomitë në tranzicion ndërmorën hapat e parë drejt ekonomisë së tregut në vitet 1990, çdo iluzion që kishin se lulëzimi ekonomik do të vinte shpejt dhe automatikisht, u venitën po aq shpejt. Ata e kuptuan që rivendosija e institucionit të pronësisë private nuk mund të çonte vetvetiu në krijimin e tregjeve efikase. Duheshin ngritur dhe ndërtuar një sërë institucionesh qeveritare, politike, shoqërore dhe kulturore. Një nga institucionet me nevojën më të madhe për rehabilitim, ishte sistemi ligjor kombëtar i çdo vendi.
- Për të arritur potencialin e plotë ekonomik, vendet duhet të kenë sisteme ligjore tregtare moderne dhe efikase për të mbrojtur interesat e bizneseve në lidhje me pronësinë personale dhe të tokës dhe, të sigurojnë garanci kundër- shpronësimit arbitrar apo të pakompensuar. Burokracitë e instancave rregullatore duhet të reduktohen. Për inkurajimin e zhvillimit të tregjeve të tokës, autoritetet duhet ta bëjnë të qartë se cilat ligje aplikohen të sigurojnë sisteme - regjistrimi moderne, dhe t'ia përkushtojnë burimet e duhura zhvillimit të profesioneve në lidhje me tregjet e tokës. Duhet të lejohet liria e plotë e kontratave ndërmjet entiteteve tregtare dhe kontratat duhet të ekzekutohen në kohë, në mënyrë të parashikueshme dhe efektive për kostot. Për të siguruar akses në fi nanca për zhvillimin ekonomik, qeveritë duhet të promovojnë qeverisjen korporative dhe duhet të adoptojnë sisteme moderne për transaksionet e siguruara dhe falimentimin, dhe për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregjeve të kapitalit dhe të bankave. Për stimulimin e zhvillimit ekonomik, vendet duhet të miratojnë legjislacion modern për të mbrojtur pronësinë intelektuale dhe për të inkurajuar zhvillimin e tregtisë elektronike. Regjimet ligjore për konkurrencën duhen modernizuar dhe prokurimi qeveritar duhet të bëhet transparent dhe jodiskriminues. Kontrollat dhe kufi zimet mbi shkëmbimin e huaj për rikthimin e fi timeve dhe kapitalit në vendin e origjinës, duhet të hiqen për të tërhequr investimet e huaja. Qeveritë gjithashtu duhet të garantojnë pavarësinë, trajnimin dhe financimin e duhur të gjyqësorit, si dhe duhet ta bëjnë arbitrazhin dhe format alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sa më të aplikueshme në mosmarrëveshjet tregtare.

Të drejtat dhe liritë e pronës private

- **Ekonomitë moderne të tregut e presupozojnë ekzistencën e pronës private. E drejta për përdorimin, transferimin, tregtimin dhe përjashtimin e të tjerëve nga përdorimi i pronës private, është jetike për një ekonomi dhe shoqëri të shëndetshme. Prona konsiston në pronën e paluajtshme (tokë) dhe në pronën personale (çdo pronë përveç tokës). Prona personale mund të jetë e prekshme (p.sh. makineri, automobila, artikuj, etj.) ose e paprekshme (të drejta kontraktuale, aksione të stokut të një kompanie, patenta, të drejta autori, etj.). Për stimulimin e zhvillimit ekonomik dhe të investimeve të huaja, vendet duhet të respektojnë dhe të mbrojnë të gjitha këto lloje të drejtash prone. Në mënyrë që një treg të funksionojë me efikasitet, të drejtat e pronës duhet të garantohen, domethënë të mbrohen kundër mashtrimit, vjedhjes dhe krimit. Prona gjithashtu duhet të mbrohet nga sekuestrimi i pakompensuar i qeverisë. Përveç kësaj, duhet të jetë e verifikueshme. Kjo do të thotë që identiteti i pronarit dhe statusi i pronësisë duhet të jetë i përcaktuar nga regjistrat dhe rregullat objektive ligjore. Prona, gjithashtu, duhet të jetë e transferueshme, dhe për të garantuar huadhënien e sigurt, pronarët e pronës duhet të kenë mundësinë të vendosin pronën e tyre si kolateral për kredi, dhe ta nënshtrojnë këtë kolateral për konfiskim, në rast të mospërmbushjes së kushteve kontraktuale.**

Mbrojtja ndaj shpronësimeve të pakompensuara

- **Sovraniteti i shtetit gëzon një të drejtë themelore: qeveritë mund të marrin pronën private për qëllime publike** brenda disa rrethanave të caktuara (ndërtimin e rrugëve kombëtare, kanaleve dhe aeroporteve, etj.). Ama, qeveritë duhet ta blejnë tokën private edhe kur pronarët nuk dëshirojnë ta shesin pronën, por me një çmim të arsyeshëm. Po ashtu, në disa emergjenca shëndetësore, qeveritë duhet të kenë fuqinë të vënë nën karantinë ose të shkatërrojnë gjënë e gjallë të fermerëve, në rastet kur ato përbëjnë rrezik për përhapjen e sëmundjeve. Por përveç këtyre rasteve të pranueshme, disa qeveri kanë konfiskuar prona për qëllime që nuk ishin plotësisht për interes të publikut: për arsye politike, në mënyrë arbitrare, me apo pa kompensim të përshtatshëm të pronarit. Krahas pronareve vendas edhe Investuesit e huaj shpesh janë bërë shënjestër politike të skemave shtetëzuese, kur politikanët kanë dashur të zgjojnë ksenofobinë ose pakënaqësitë populiste. Edhe kur këto masa kryhen pjesërisht apo gradualisht, ky përçmim për të drejtat e pronës private minon stabilitetin e nevojshëm për lulëzimin e ekonomisë së tregut.
- **Kufizimi ligjor i fuqisë për të marrë pronë private.** (Ky ligj duhet t'u sigurojë ish-pronarëve të pronës së shpronësuar kompensim nga shteti, madje ky ligj duhet ta thotë qartë që shpronësimi justifikohet vetëm atëherë kur bëhet për përdorim publik),
- **Përkufizimi i shpronësimit që i jep pronarit të drejtën e kompensimit.** (Qeveritë duhet të vendosin standarde ligjore për të përcaktuar kur ndodh shpronësimi, duke i dhënë automatikisht të drejtën pronarit për kompensim. Gjithashtu duhen bërë përpjekje për të qartësuar mire konceptin “përdorim publik”. Nga ana tjetër, shpronësimi mund të arrihet edhe nëpërmjet tatimit konfiskues, por kjo është e ndryshme nga ndërhyrja e pajustificuar e shtetit në ushtrimin nga ana e pronarit të të drejtave menaxhuese, shitjes, etj. dhe nëpërmjet “shpronësimit zvarritës” që ndodh në mënyrë graduale ose pak nga pak. Edhe kur veprimet e këtyre qeverive nuk cenojnë të drejtat formale të pronës, ato mund të shkatërrojnë vlerën ekonomike të pronës, si për shembull me anë të konfiskimit të plotë dhe të befasishtëm. Vendet mund të kërkojnë udhëzime për të bërë dallimin ndërmjet shpronësimit të drejtpërdrejtë dhe veprimeve normale rregullatore nga vendime të gjykatave të arbitrazhit dhe të tjera).
- **Përcaktimi i masës së kompensimit.** Ligji, gjithashtu, duhet të garantojë një shkallë të drejtë kompensimi për pronarin e pronës së shpronësuar. “Vlera e drejtë e tregut” mund të mos jetë e përshtatshme në çdo situatë: lloji i pronës në fjalë mund të mos jetë shumë i kërkuar në treg, saqë të gëzojë çmimin real aktual të tregut.
- **Ngritja e një mekanizmi të pavarur për shqyrtimin e vendimeve për shpronësim.** Agjencia shtetërore që shpronëson pronën private nuk duhet të ketë fjalën e fundit për ligjshmërinë e shpronësimit apo mjaftueshmërinë e kompensimit. Në një shtet që qeveriset nga shteti i së drejtës, vetë qeveria është objekt i ligjit dhe kompetencat e saj janë të kufizuara. Gjykatat duhet të kenë jo vetëm juridiksion teknik, ashtu edhe kompetenca reale për të shqyrtuar, dhe nëse është e nevojshme, për të përmbysur

-2-

- Po aq të rëndësishme sa janë garancitë kundër konfiskimit arbitrar të pronës për zhvillimin ekonomik edhe shpronësimi nuk është i vetmi veprim i qeverisë që mund të minojë të drejtat e pronës private. Rregullimi i tepruar, regjimet e komplikuar të licencimit dhe kërkesat e stërholluara për leje/autorizime, mund të jenë pengesa që paraqesin kosto financiare dhe kohore mbi të drejtat e investuesve dhe të sipërmarrësve. Ndërkohë që njëfarë shkalle rregullimi shtetëror është i pashmangshëm në ekonominë moderne. Rregullimi i tepruar kontribuon në një mjedis, ku mund të lulëzojë korruptimi i zyrtarëve. Një nëpunës shteti që kërkon ryshfet, mund të dalë garant për “të vajosur” procesin rregullator, duke çarë shpejt përmes hallkave burokratike, në shkëmbim të pagesave të paligjshme nga bizneset e rregulluara.
- *Zyrtarët qeveritarë që kërkojnë ryshfet, ua bëjnë të qartë bizneseve që u leverdis të paguajnë “nën dorë” sesa të paguajnë gjithë barrën e taksave zyrtare dhe gjobave. Qëndrimi në ekonomi informale është i kushtueshëm, por kalimi në ekonomi formale është edhe më tepër. Procedurat e komplikuar të dokumentimit për marrjen e licencës i detyrojnë bizneset që të hyjnë në labirinte burokratike. Koha e tepruar për procedura bën që kjo kohë të kthehet drejtpërdrejt në kosto në vend që të përdoret për aktivitetet fitimprurëse dhe prodhuese të biznesit.*
- Përveçse se minon besimin te sistemi shtetëror dhe ekonomik i një vendi, rregullimi i tepruar shpesh motivon bizneset në “ekonomi hije” apo jotatimpaguese. Për të stimuluar zhvillimin ekonomik, shumë vendeve u duhet të shkurtojnë për biznesin rregullimet e paqarta, të përsëritura dhe joefikase, që janë akumuluar përgjatë viteve. Përgjithësisht, rregullimet shpesh adoptohen me bazë ad hoc, pa shqyrtimin e duhur dhe pa konsideratën e mjaftueshme për barrën që imponon te bizneset. Po ashtu, për shmangien e “vajosjeve” duhet të theksohen **kufizimet ndaj aksesit të parasë**, pra shumica e vendeve kërkojnë që të gjitha transaksionet ndërmjet firmave të kryhen me transferta bankare. Tërheqja e parave nga ana e korporatave dhe e enteve të tjera ligjore ndonjëherë lejohet vetëm për pagimin e rrogave dhe të shpenzimeve të udhëtimit. **Kërkesa të tjera janë ato për dokumentacion doganor**, ku del i domosdoshëm dhe një sistem i kompjuterizuar i menaxhimit doganor që mbulon shumicën e procedurave të tregtisë me jashtë. Pengesa janë dhe **procedurat e gjata të regjistrimit dhe certifikimit**, që kur janë të sterzgjatura dekurajohen investuesit, deri duke krijuar vonesa apo humbje të pozitave në treg.

Pasuritë e paluajtshme

- **Akresi në toka/truall është i domosdoshëm për shumicën e bizneseve dhe tregjet e tokës janë vendimtare për zhvillimin e balancuar ekonomik.**
- ***Tregjet e tokës që lejojnë aksesin në tokë/truall dhe në ndërtesa – nëpërmjet të drejtave të sigurta të pronës, me çmime transparente, me procese efikase për lëshimin e lejeve dhe sistemeve tatimore për tokën, janë thelbësore për një klimë të mirë biznesi. Por krijimi i tregjeve të tilla mund të jetë i gjatë, kompleks, i ngarkuar politikisht, sidomos aty ku shumica e tokës dominohet nga shteti, pa titull pronësie dhe me pretendime konfliktuale.***
- **Evidentohen tri institucione thelbësore për zhvillimin e tregjeve të shëndetshme të tokës: (1) një sistem regjistrimi që siguron “*dëshmi ligjore të sakta, të lira se kush zotëron dhe mban të drejtat mbi tokën*”, (2) një kuadër ligjor për pronat e paluajtshme, dhe (3) një profesion që i kushtohet përdorimit të tokës (*Profesioni i pasurisë së paluajtshme*).**
- **Shtojme po ashtu se shumë vende të Evropës Lindore dhe të Azisë Qendrore mbajnë ligje dhe rregullime që e bëjnë të vështirë marrjen e tokës për përdorim tregtar apo industrial. Pa truall, bizneset nuk mund të vendosen për të operuar. Kompanitë që janë angazhuar për investime afatgjata dhe që po derdhin miliona euro për përdorimin e truallit, ndërtimin e mjediseve, punësimin e punëtorëve dhe pagimin e taksave, presin të përfitojnë nga pronësia mbi truallin. Përpjekjet për të vendosur kufizime të dala mode mbi kompanitë, nuk është një mënyrë efikase për të tërhequr investues apo për t’i bërë ndërmarrjet konkurruese, perfshire dhe proceduren e marrjes se tokës me qira afatgjatë. Po ashtu, shndërrimi i tokës bujqësore në truall tregtar apo industrial, është shpesh një proces i gjatë që kërkon pagimin e taksave dhe ndonjëherë kërkon një akt të parlamentit. Nëse ekonomitë vërtet dëshirojnë të tërheqin investime të huaja dhe të promovojnë zhvillimin e NVM-ve, atëherë ato duhet ta bëjnë tokën të disponueshme për bizneset dhe me çmime të përballueshme. Tradicionalisht trualli për banim është toka më e shtrenjtë, e ndjekur nga trualli tregtar, industrial dhe pastaj toka bujqësore. Tregjet në Evropën Lindore mund të shtrembërohen. Mungesa e tokës që klasifikohet si truall për përdorim tregtar apo industrial, ka bërë që çmimi për metër katror i truallit industrial të jetë i përafërt me atë të truallit për banim**

Të drejtat dhe liritë kontraktuale

Zhvillimi ekonomik dhe investimet e huaja kanë nevojë për liri dhe stabilitet në marrëdhëniet ekonomike. Kjo nevojë është veçanërisht e rëndësishme në marrëdhëniet kontraktuale. Investuesit dhe biznesmenët zakonisht duan lirinë, që të vendosin vetë kufijtë e një transaksioni me anë të negociatave dhe marrëveshjes, sesa t'u imponohen kushte nga shteti. Ata, gjithashtu, duan garancitë se me firmosjen e një marrëveshjeve, ajo do të zbatohet ashtu siç është shkruar, dhe jo të shpallet e pavlefshme, apo. në rast të mosmarrëveshjeve të modifikohet nga gjykata. Koncepti “liria e kontratës” – domethënë se palët kontraktuese mund “të jenë dakord për kufizimet e mundësive ligjore, në mënyrë që të nxjerrin benefite nga bashkëpunimi dhe shkëmbimi”. Është normale që të gjitha vendet vendosin disa kufizime në lirinë e kontratës. Shtetet kanë interes të ligjshëm që të ndalojnë marrëveshjet që shkelin politikat e rëndësishme publike. Disa ligje që kufizojnë lirinë e kontratës në mënyra konkrete – për shembull duke vendosur kriteret të orëve maksimale të punës dhe mosdiskriminimit në punë, duke e quajtur të paligjshëm mashtrimin dhe kamatën në transaksionet e mallrave të konsumit, apo ndalimin e fiksimit të çmimit mes konkurruesve – janë në linjë me zhvillimin e fuqishëm ekonomik dhe madje e konsolidojnë. Megjithatë, disa politika mund të jenë dëmtoese për rritjen ekonomike: ato që detyrojnë investuesit e huaj të hyjnë në partneriteti me kompanitë vendëse për shembull, ose që u lejojnë shteteve drejtpërdrejt ose jo që të përcaktojnë çmimet me të cilat një firmë mund të nënshkruajë kontratat e veta private. Dhe disa kufizime minojnë rritjen solide ekonomike: për shembull, ato që në mënyrë të panevojshme kufizojnë zgjedhjet e palëve, ose që kërkojnë të mbrojnë interesat vendëse në kurriz të të huajve, apo që u lejojnë gjykatave që të ndryshojnë ndjeshëm kushtet e kontratës mes palëve, bazuar në koncepte të vakëta drejtësie dhe barazie. Më poshtë paraqiten disa shembuj kufizimesh ndaj lirisë së kontratës.

- **- Forma të detyrueshme për disa kontrata.** (Ligjet e disa vendeve kërkojnë një formë strikte për transaksionet e caktuara tregtare dhe për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve në mënyrë të pandryshueshme).
- **- Pengesat për transaksionet tregtare.**
- **- Kufizime në marrëveshjet gjatë arbitrazhit për mosmarrëveshjet.** (Mundësia që palët të zgjidhin mosmarrëveshjet tregtare me anë të arbitrazhit, është një element i rëndësishëm i sistemeve moderne të legjislacionit tregtar).

Mënyrat e bërjes së biznesit

Në epokën paraindustriale, biznesi zakonisht kryhej nga individë që vepronin vetëm ose bashkë në një partneritet. Partneritetet e këtij lloji vazhdojnë të jenë tepër të rëndësishme në tregtinë bashkëkohore. Megjithatë, bërja e biznesit si individ apo partneritet në grup, normalisht përmban të paktën një problem potencial: individit ose partnerët janë të ekspozuar ndaj detyrimeve të pakufizuara: nëse biznesi rezulton i pasuksesshëm, pronarët do të jenë përgjegjës për të gjitha borxhet, edhe kur sasia e borxhit tejkalon shumën e investuar nga pronari në biznes. Për të inkurajuar investime më të mëdha dhe marrjen e riskut, qeveritë para shumë kohësh futën korporatën (e njohur edhe si anonyme société apo Aktiengesellschaft) – një entitet juridik që ekziston në ligj si i ndarë nga pronarët e vet. Në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme, maksimumi i asaj që ata që investuan në korporatë mund të humbasin, është sasia e parave, që paguan për aksionet e tyre. Për shkak të përgjegjësisë së kufizuar që ofrojnë, korporatat kanë qenë dhe mbeten një formë shumë popullore e të bërit biznes. Megjithatë, kompleksiteti i tregtisë moderne kërkon që investuesit e sotëm të kenë një rang alternativash për të zgjedhur formën sipas të cilës do të bëjnë biznes. Si rezultat, shumë vende kanë sajuar lloje të reja organizatash biznesi duke kombinuar disa attribute të korporatave dhe partneriteteve. Mes tyre janë francezet “société à responsabilité limitée” (SARL), gjermanet “Gesellschaft mit beschränkter Haftung” (GmbH), dhe amerikanet “limited liability company” (LLC). Disa nga këto organizata biznesi janë bërë format e preferuara për të bërë biznes me kapital ndërkombëtar të përbashkët (joint ventures). Në përgjithësi, qeveritë duhet të ofrojnë mundësitë për krijimin e një larmie organizatash biznesi, në mënyrë që investuesit të zgjedhin formën më të përshtatshme të organizimit sipas rrethanave të tyre. Përveç subjekteve të biznesit që përcaktohen qartë ligjërisht, qeveritë duhet të ofrojnë edhe një larmi formash kontraktuale për të bërë biznes; një prej tyre është ekskluziviteti (franchise) – një marrëdhënie e bazuar në kontratë ndërmjet përfituesit të ekskluzivitetit (franchisee) që zakonisht është një biznes i vogël, dhe dhënësit të ekskluzivitetit (franchisor) që zakonisht është një biznes më i madh, në të cilën i pari pranon të prodhojë (ekskluzivitet prodhues) apo të shpërndajë (ekskluzivitet shpërndarës) mallra apo shërbime sipas një “sistemi biznesi” të përcaktuar nga dhënësi i ekskluzivitetit. Nga ana e tij, dhënësi i ekskluzivitetit i siguron përfituesit të ekskluzivitetit mbështetje dhe këshillim të vazhdueshëm, licenca për markat, ndihmë për kërkimet shkencore dhe zhvillimin, si dhe asistencë në marketing dhe reklama. Përfituesi i ekskluzivitetit zakonisht i paguan një tarifë dhënësit të ekskluzivitetit për këtë marrëdhënie dhe mund të blejë mallra nga ky i fundit. Me miratimin e legjislacionit modern për biznesin e ekskluzivitetit, vendet e ndryshme nxisin investimet e brendshme, transferimin e teknologjisë, zhvillimin e standardeve të kontrollit të cilësisë dhe benefite të tjera, të cilat janë vendimtare për një mjedis të shëndoshë biznesi

Qeverisja korporative

- Një sistem qeverisje korporative (vargu i proceseve, zakoneve, politikave, ligjeve dhe institucioneve që ndikojnë në mënyrën se si drejtohen, administratorën dhe kontrollohen bizneset) është thelbesor për të inkurajuar investuesit dhe investimet. Por mund të shfaqen dhe probleme serioze:
- Mungesa e mbrojtjes së mjaftueshme ligjore do të thotë që interesat e aksionerëve në një kompani janë vulnerabël ndaj shpërdorimit apo keqpërdorimit të kompanisë nga ana e drejtuesve të kompanisë apo aksionerëve të tjerë.
- Kompania mund të humbasë asete çka është në dëm si të aksionerëve, ashtu edhe të kreditorëve. Drejtuesit e kompanisë mund të hyjnë në transaksione të ngushta me kompaninë apo të shkëmbejnë aksione për informacionet jopublike.
- Informacionet financiare të pasakta ose të paplota mund të frenojë huadhënësit që të shtojnë kreditë për kompanitë.
- Efektet negative të këtyre praktikave prekin jo vetëm aksionerët dhe kreditorët e ndikuar drejtpërdrejt. Përkundrazi, ato minojnë besimin në sistemin e biznesit në tërësi dhe rrjedhimisht pengojnë aftësinë e biznesit që të rrisin kapitalin dhe të tërheqin investime. Për më tepër, mungesa e qeverisjes korporative pengon tregtimin dytësor të letrave me vlerë, ku aksionet e lëshuara mund të rishiten, të blihen dhe të rishiten prapë. Kjo mund të ketë një ndikim negativ të vendet në tranzicion të cilat kanë privatizuar ndërmarrje shtetërore gjatë privatizimit masiv dhe kanë vendosur aksionet në duart e miliona shtetasve. Pa tregje të fuqishme dytësore, “është tepër e vështirë që nëpërmjet tregtimit të titujve të pronësisë të ndalojë dëmin e shkaktuar nga privatizimi fillestar ndaj pronarëve joefektivë”. Nga ana tjetër, procedurat dhe praktikat qeveritare që promovojnë zhvillimin e përshtatshëm dhe transparencën, mbrojtjen efikase të të drejtave të aksionerëve dhe kreditorëve, dhe ndarja e qartë e përgjegjësisë midis autoriteteve, mund të kontribuojë në krijimin dhe zgjerimin e tregjeve efçente dhe të fuqishme. Për adresimin e këtyre problemeve, OECD-ja ka zhvilluar një set parimesh të njohura: Parimet e Qeverisjes Korporative, gjithashtu e njohur si Parimet e OECDsë. Parimet e OECD-së vendosin themelet për kuadret ligjore, institucionale dhe rregullatore që rrisin besimin e investuesve dhe potencialin për zhvillim ekonomik.

-2-

- Subjektet e parimeve të OECD-së janë:
- - Trajtimi i drejte i te gjithë aksioneve (përfshi aksioneret e huaj dhe ata ne pakice)
- - Ndarja e qarte e kompetencave midis autoritetit mbikëqyrës dhe atij rregullator;
- - Bashkepunimi midis kompanise dhe grupeve te saj te interesit për të kontribuar për të mirën e përbashkët;
- - Transparence dhe hapje ndaj personave te interesuar për financat dhe veprimet e kompanisë;
- - Parandalimin e ujdive te brendshme;
- - Ushtrim eficient i roleve menaxhuese dhe mbikëqyrëse nga ana e drejtuesve të kompanisë dhe bordit të drejtorëve, përfshi llogaridhënien te aksionerët.
- Disa nga hapat pozitivë të ndërmarrë nga këto vende:
 - *Mbrojtja e të drejtave të aksionerëve.*
 - *Trajtim i barabartë i aksionerëve.* (të gjithë aksionerët e të njëjtës klasë aksionesh të kenë të njëjtën të drejtë vote).
 - *Inkurajim i bashkëpunimit ndërmjet kompanisë dhe aksionerëve.* (Ligjet e falimentimit lejojnë kreditorët të përfshihen në procesin vendimmarrës në procedurat e falimentimit. Përveç kësaj, shumë shtete inkurajojnë konsultimet midis drejtuesve të kompanisë dhe përfaqësuesve të punëtorëve.
 - *Transparenca dhe hapja e informacionit.*
 - *Ndalim të tregtimit të brendshëm dhe ujdive të fshehta abuzive.*
 - *Përgjegjësia e nëpunësve dhe drejtorëve.*

Prona private dhe sigurimi i transaksioneve

- **Shumë ekonomi vuajnë nga mungesa kronike e kredive. Kjo ndodh për shkak të frikës së huadhënësve se nuk do të paguhen. Kjo frikë mund të pakësohet me anë të transaksioneve të ekzekutueshme dhe të sigurta. Në një transaksion të sigurt borxhi, huamarrësi i transferon kredituesit të drejtat e pronës të cilat kredituesi mund t'i përdorë për garanci ndaj borxhit të huamarrësit. Hipotekimi i pasurive të paluajtshme është një formë e njohur e sigurisë së borxhit. Sidoqoftë, edhe prona personale ka vlerë, dhe lejimi i huamarrësve që të përdorin pronën private, për të siguruar borxhet e tyre, i hap rrugë të reja tregjeve kredituese dhe nxit përdorim të plotë ekonomik të pronës së tyre. Vënia e pronës private si kolateral mund të bëjë që kredia të jepet me kosto më të ulëta, duke pakësuar rrjedhimisht riskun e kreditorit për mospagim. Megjithatë, meqë karakteristikat e luajtshme të pronës personale ndryshojnë nga ato për pronën e paluajtshme, një sistem i veçantë kërkohet normalisht për sigurinë e pronës personale.**

Ligji për falimentimin

- Në mënyrë që huatë të jenë të gatshme për rritjen ekonomike, një sistem ligjor duhet të rregullojë me racionalizëm situatën kur një debitor jo vetëm që nuk arrin të paguajë një këst, por përgjithësisht e ka të pamundur të paguajë kredituesin për shkak se borxhi tejkalon asetet, dhe/ose problemet e qarkullimit të parasë dhe likuiditeteve. Ky është funksioni i ligjit për falimentimin, i cili vendos procedura në bazë të të cilave kreditorët mund të paguhen në mënyrë të rregullt në përputhje me mjetet që një person apo subjekt ka në dispozicion për pagim. Procesi i falimentit, gjithashtu, i garanton debitorit bashkëpunues “një fillim të ri” duke e shkarkuar debitorin nga shumica e detyrimeve financiare. Procedurat e falimentimit mund të marrin ose formën e likuidimit (e njohur si “winding up”), sipas të cilës asetet e debitorit shiten dhe fitimet u shpërndahen kredituesve, ose të riorganizimit në të cilën gjykatqa ndjek “riorganizimin” e detyrimeve kontraktuale dhe të borxhit të një individi apo subjekti biznesi në vështirësi. Një kompani “e riorganizuar” mund të dalë nga falimentimi e çliruar nga borxhet e mëparshme. Në këtë proces, pronarët e mëparshëm të kompanisë në vështirësi mund të humbasin kontrollin e saj, dhe në disa raste kredituesit bëhen pronarët e rinj. Parimi i riorganizimit është se, vlera e një biznesi në vështirësi është shpesh më e madhe, sesa vlera likuiduese e aseteve të saj, që do të thotë se kredituesit mund të përfitojnë më tepër para nga riorganizimi sesa nga likuidimi.
- Në një ekonomi tregu, është e pashmangshme që disa biznese të dështojnë. Në raste të tilla, huadhënësit rrezikojnë që huatë e tyre të mos u kthehen, dhe aksionerët mund të humbasin vlerën që kanë investuar në kompani. Për këto arsye, investuesit planifikojnë investimet e tyre me një sy nga minimizimi i riskut që shoqëron dështimin financiar. Sistemet funksionale të falimentit u sigurojnë investuesve mundësinë që të llogarisin këtë risk dhe të marrin vendime që janë më të matura dhe më të besueshme. Kjo promovon aksesin në financa – për borxhin dhe kapitalin e aksioneve – për të gjitha bizneset. Gjithashtu, ligjet e mira të falimentimit promovojnë “ristrukturimin e bizneseve të shëndetshme, mbylljen efiçente të bizneseve të dështuara, dhe transferimin e aseteve të tyre te përdorues tregu më efiçentë”. Ligjet e falimentimit ndërveprojnë, përforcojnë dhe përforcohen nga kuadri më i gjerë i ligjeve tregtare, përfshirë ato që lidhen me qeverisjen korporative, tregtimin e letrave me vlerë, tatimet dhe sektorin bankar. Shumica në mos të gjitha vendet evropiane kanë ligj falimentimi. Megjithatë, shumica e këtyre ligjeve janë shumë të thjeshta, dhe nuk mbulojnë të gjithë kompleksitetin e transaksioneve tregtare moderne.
- Pavarësisht ekzistencës së legjisllacionit për falimentimin, disa vende shumë rrallë për të mos thënë kurrë nuk kanë zbatuar apo aplikuar ligjet e tyre të falimentimit. Raportime të ndryshme tregojnë se disa qeveri kanë ndërmarrë ndërhyrje politike në disa raste falimentimi, duke mos lejuar gjykimin e pavarur dhe asnjans nga ana e gjykatave. E rëndësishme është dhe detyra e ruajtjes dhe administrimit e aseteve të debitorit gjatë procedimeve të falimentimit.

Tregu i kapitaleve

- Përveç mekanizmave ligjorë të mësipërm që synojnë stabilitetin dhe parashikueshmërinë e riskut në investime në mjete themelore dhe shtrirjen e kredisë, legjislacioni dhe rregullimi mund të kontribuojë në rritjen ekonomike duke mbështetur ngritjen dhe funksionimin eficient të tregut të kapitalit. Tregu i kapitalit është një mekanizëm që lejon tregtimin e aseteve afatmesme dhe afatgjata si për shembull stokun e përbashkët të aksioneve si dhe borxhin publik dhe privat me maturim që e kalon një vit. Këto tregje sigurojnë likuiditete për aksionet e përbashkëta, çka është e rëndësishme për zhvillimin aktual dhe të ardhshëm ekonomik, sepse “ritja e mundësisë për të tregtuar pronësinë e teknologjive prodhuese të një ekonomike lehtëson akordimin e burimeve, formimin e kapitalit fizik dhe rritje më të shpejtë ekonomike”. Mbrojtja e investuesit luan një rol kritik në funksionimin eficient të tregut të kapitalit. Për këto sistemi ligjor dhe rregullator duhet të vendosë një numër kërkesash. Konkretisht :
- - Sistemi duhet t’u garantoje investuesve zbulim te informacioneve në kohë.
- - Individet dhe firmat që janë aktive në çfaredo aspekt të biznesit të letrave me vlerë (përfshi lëshuesit, agjentët sigurues, shpërndarësit dhe firmat e menaxhimit të parave dhe firmave konsulente për investimet) duhet të marrin autorizim nga autoritetet përgjegjëse regullator përpara se të kryejnë këto aktivitete.
- - Pjesëmarrësve në industrinë e letrave me vlerë duhet t’u kërkohet që të kenë kapital të mjaftueshëm për llojin e biznesit që ndërmarrin.
- - Firmave të letrave me vlerë duhet t’u kërkohet që të ndajnë llogaritë e tyre dhe ato të punëtorëve nga llogaritë e klientëve të tyre.
- - Për të mbrojtur investuesit nga neglizhenca dhe krimet financiare të agjentëve, apo nga pamundësia për të paguar, duhen ngritur fonde garancie ose të ngjashme.
- - Kompensimi për agjentet duhet të bazohet në një sistem komisionesh konkurruese.
- - Cdo institucioni pjesëmarrës duhet t’i kërkohet që të kenë auditim të brendshëm dhe të jashtëm dhe mekanizma për të monitoruar respektimin nga ana e tyre e rregullimeve.
- - Investuesit duhet të kenë akses në një sistem me kosto të ulët – normalisht një formë arbitrazhi – për të paraqitur paditë kundër agjentëve, firmave konsulente për investimet, etj.

Ligji dhe politika e bankave

- Mbikëqyrja e duhur dhe ligji i bankave është esenciale për parandalimin e krimeve financiare dhe keqmenaxhimit. Kjo është, gjithashtu, e nevojshme për të krijuar besimin publik te bankat.
- I rëndësishëm është autoriteti mbikëqyrës të industrisë bankare, dhe sipas kuadrit legjislativ, identifikon aktivitetet e lejueshme për bankat, specifikon procedurat e licencimit, vendos rregullime të matura dhe kërkesa si kapitali minimal, menaxhimi i riskut dhe kontrollet e brendshme (për praktikën si huadhënia e brendshme dhe huadhënia me një huamarrës), dhe parandalimi i mashtrimit dhe pastrimit të parave. Kete autoritet mbikëqyrës e ka në shumicën e vendeve Banka Qendrore: Në detyrat e saj janë:
 - *Përcaktimi i përgjegjësive të qarta për mbikëqyrjen ndaj bankave.*
 - *Kompetencat ekzekutive të Bankës Qendrore.* (Banka Qendrore mund të ndërmarrë një numër veprimesh specifike, si për shembull: - të ndalojë bankën që të pranojë depozita apo të japë lehtësira kreditimi; - të marrë kontrollin e bankës; dhe - t'i heqë licencën bankës).
 - *Nivel kapitali të mjaftueshëm.* (kërkesa mbi bankat e nivelit të dytë që të mbajnë nivelin e kapitalit të mjaftueshëm)
 - *Huadhënie e brendshme me kufizimet perkatëse.*
 - *Dhënia e informacionit të Banka Qendrore.*

Riatdhesimi i fitimeve dhe kapitalit

- Disa vende e kufizojnë aftësinë e kompanive për të rikthyer në vendin e tyre të origjinës **kapitalin, fitimin apo dividendët**. Këto politika frenojnë investimet e huaja dhe inkurajojnë praktikat joefikase dhe jotransparente, si për shembull mosdeklarimin e çmimeve. Për inkurajimin e IHD-së, vendet duhet të garantojnë aftësinë për të rikthyer kapitalin dhe fitimin në vendin e origjinës. Shumë vende evropiane i kanë hequr këto kufizime tashmë për rikthimin e të ardhurave.

Ligji dhe politika e konkurrencës

- **Ekonomitë në tranzicion u është dashur të riorientojnë rrënjësisht të gjithë strukturën ekonomike dhe mënyrën e të menduarit. Pavarësisht përpjekjeve të lavdërueshme për të ngritur institucione të reja në mbështetje të konkurrencës si paradigme e re ekonomike, shumë prej këtyre vendeve u duhet ende të përballen në të gjitha nivelet e qeverisë dhe në shoqëri – me një kulturë të brumosur që pret ndërhyrje të fortë të shtetit në çështjet ekonomike. Por integrimi evropian ka imponuar harmonizimin e politikave kometare nga vendet e reja anetare, kandidatë apo pritese. Sistemi i BE-së, i bazuar kryesisht në ligjin gjerman për konkurrencën, është i detyrueshëm për të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Ai synon të hapë tregjet dhe të ndëshkojë abuzimet e pushtetit ekonomik me veprime të vendosura të shtetit. Shteti përgjithësisht supozohet se duhet të mos ndërhyjë dhe të lërë dorë të lirë. Sistemet ligjore për konkurrencën në Amerikën Veriore janë të ngjashme, edhe pse jo identike, me ato të regjimit të BE-së.**
- **Ekonomitë e tregut bazohen kryesisht në premisën që rezultatet e konkurrencës janë akoordimi eficient i burimeve dhe që është në të mirë të konsumatorit, duke prodhuar një përzierje optimale e cilësisë, mallrave dhe shërbimeve me çmimet më të ulëta³⁹. Qëllimet e detajuara të politikës së konkurrencës – duke maksimizuar mirëqenien e konsumatorit ose mirëqenien sociale, nxitjen e zhvillimit ekonomik e kështu me radhë – variojnë sipas vlerave politike të një vendi të caktuar apo grupimit rajonal ekonomik⁴⁰. Megjithatë, ka një konsensus të gjerë, se ligji për konkurrencën mund të shërbejë si kuadër ligjor për të garantuar, që forcat eficiente të tregut të operojnë në ekonomi. Vendet me ekonomi në tranzicion duhet të përcaktojnë qartë politikat për konkurrencën. Meqë kultura e konkurrencës nuk mund të ndërtohet tërësisht me ligje, rregulla dhe politika, këto vende duhet të organizojnë fushata edukuese për t'i shpjeguar publikut politikat e reja ekonomike në mënyrë që të lulëzojnë në mjedisin e ri. Politikat e konkurrencës duhet të ndalojnë qartë të ashtuquajturat “aktivitete kartel”¹ midis konkurruesve, si për shembull fiksimi i çmimit, fragmentimi i tregut, ndarja e klientëve dhe manipulimi i tenderëve, pasi ka pak në mos aspak justifikime ekonomike për praktika të tilla në rrethana normale.**
- **Nga ana tjetër, edhe pse bashkimet/ (shkrirjet) dhe blerjet mund të prodhojnë apo të rrisin eficientë, ato mund të jenë edhe një mjet për të krijuar pushtet monopol. Shumë ligje të konkurrencës i rregullojnë këto transaksione dhe mund të përdoren për t'i bërë të pavlefshëm ose për t'i parandaluar.**

-2-

- Në mënyrë që të ruhet natyra konkurruese e ekonomisë, shumë qeveri kanë miratuar ligje që ndalojnë abuzimet e monopolistëve, që pakësojnë marrëveshjet e fshehta midis firmave që duhet të jenë konkurrense, dhe që të mos lejojnë përqendrimit e padrejta të pushtetit të tregut që rezultojnë nga bashkimet apo blerjet. Ato reflektojnë realitetin që, ndërkohë që interesi vetjak i konkurrentëve mund të prodhojë rezultate konsistente me interesin publik, ajo që dëshiron çdo pjesëmarrës i tregut mund të mos jetë në të mirë të interesave të konsumatorit. **Ligjet moderne për konkurrencën zakonisht përmbajnë komponentët e mëposhtëm:** (1) rregullimet e përgjithshme, (2) ndalimin e marrëveshjeve të fshehta midis atyre që duhet të ishin konkurrentë, si për shembull fiksimi i çmimit, manipulimi i tenderëve dhe të tilla si këto, (3) ndalimi i abuzimit nga monopolet për shkak të pozitave dominuese në treg, (4) dispozita për ndërmarrjet me të drejta speciale dhe ekskluzive apo monopolet natyrale⁴⁴, (5) ndihma shtetërore, (6) kontrolli i bashkimeve, (7) konkurrenca e pandershme, (8) rregulla që përcaktojnë sjelljen e autoriteteve shtetërore të konkurrencës, (9) pasojat (gjobat, ndëshkimet, burgosja, dhe ose përgjegjësi civile) në rastet e shkeljes së ligjit për konkurrencën, dhe (10) një set aktesh të detajuara që merren me përjashtimet, procedurat dhe çështje të tjera të ndërlikuara.
- Se fundi, **autoritetet e ligjit për konkurrencën duhet t'i kushtojnë vëmendjen e duhur metodologjisë**, kufijve politikë, të dhënave dhe aspekteve të tjera që përbëjnë një treg kur duhet përcaktuar nëse një palë ka pozita dominuese në treg apo nëse disa veprime të caktuara do të kenë ndikim substancial ekonomik.

Prona intelektuale dhe legjislacioni për tregtinë elektronike

- Të drejtat e pronës intelektuale – që u japin autorëve, shpikësve dhe krijuesve të tjerë të veprave të dobishme dhe shprehëse të drejtën që të mos lejojnë të tjerët të përdorin krijimet e tyre – janë lënda e parë e jetës ekonomike moderne. E megjithatë, këto ligje në shumë vende janë kontradiktore. Futja dhe zbatimi rigoroz dhe me eficientë i ligjeve për pronën intelektuale, kërkon një çmim. Vendet me ligje të dobëta për patentat dhe kompani farmaceutike që prodhojnë pa patentë, kanë qenë në gjendje të gëzojnë me kosto më të ulëta benefitet e shpikjeve të kryera në vendet ku mbrojtja e rreptë e patentës u lejon kompanive farmaceutike që investimet e tyre për kërkime shkencore dhe zhvillim të quhen shpenzime të zbritshme. Ndryshimi i kësaj situata mund të jetë politikisht e papëlqyeshme dhe e vështirë.
- Por edhe moszbatimi i ligjeve për pronën intelektuale, ka koston e vet. Mbrojtja joefikase e pronës intelektuale po kthehet gjithnjë e më tepër në padi tregtare ndërmjet vendeve shumë të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim apo tranzicion. Vendet me ligje të dobëta të pronës intelektuale gjithashtu, humbasin të ardhura në formën e tarifave doganore dhe taksave që paguhen nga pronarët e regjistruar të pronës intelektuale. Për më tepër, shumë kërkime sugjerojnë se mbrojtja e duhur e pronës private, e shoqëruar me liberalizimin e tregut dhe politikat pro konkurrencë, është një element vendimtar në strategjitë kombëtare për nxitjen e investimeve të huaja dhe zhvillimit ekonomik. Disa ekonomistë kanë vërtetuar se dobësia e ligjeve për pronën intelektuale i nxit kompanitë të investojnë në vende të tjera ku mbrojtja e pronës intelektuale është më e fortë, dhe të kufizojnë ose të mos fusin teknologji të reja në vende me mbrojtje më të paktë.
- Mbrojtja e duhur e pronës intelektuale është, gjithashtu, një parakusht për të hyrë në OBT, e cila u kërkon anëtarëve që të aderojnë në Marrëveshjen për Aspektet e të Drejtave të Pronës Intelektuale që lidhen me Tregtinë (Marrëveshja TRIPS). Marrëveshja TRIPS vendos nivele cilësore mbrojtjeje në fushat e patentave, markave, të drejtës së autorit, dizenjimeve gjeografike, konceptimit të qarqeve të integruar, sekreteve tregtare, praktikave anti-konkurrencë në licencim dhe zbatim.

- **Gjetja e balancës.** Gjatë hartimit të politikave për pronën intelektuale, vendet duhet të balancojnë nevojën për shpërblimin e novatorëve me nevojën e publikut për akses të lirë në informacion. Patentat, të drejtat e autorit, të drejtat e mbarështuesve të bimëve (kultivues të llojeve të reja bimësh) dhe të drejtat që lidhen me pronën intelektuale bazohen në besimin se duke u dhënë njerëzve të drejtën ekskluzive për shfrytëzim ekonomik të krijimeve të tyre për një kohë të kufizuar, stimulon shumë novacionin dhe krijueshmërinë. Nga ana tjetër, p.sh., pas skadimit të patentës (normalisht 20 vite pas dorëzimit të aplikimit të patentës), shpikja mund të përdoret nga kushdo, pa tarifë, dhe i gjithë informacioni i zbuluar bëhet pjesë e domenit publik. Ndërkohë që shtetet rishikojnë këto të drejta, duhet të mbajnë parasysh nevojën e mbajtjes së mbrojtjes efektive, pa sakrifikuar domenin publik të fuqishëm.
- **Mosdiskriminimi.** Marrëveshja TRIPS, Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronës Industriale, Konventa e Bernës për Mbrojtjen e Punimeve Artistike dhe Letrare, si dhe traktate të tjera të rëndësishme për pronën intelektuale, zakonisht u kërkojnë vendeve anëtare të trajtojnë pronarët e pronës intelektuale nga vende të tjera anëtare, me të njëjtën shkallë favorizimi që trajtojnë shtetasit e tyre. Ky është një parim i shëndoshë që duhet të pasqyrojë realitetin e zbatimit të të drejtave të pronës intelektuale.
- **Përdorimi si kolateral.** Si të gjitha asetet, të drejtat e pronës intelektuale kanë vlerë ekonomike që matet objektivisht. Në fakt, asetet më të çmuara të shumë kompanive sot, janë krijimet e tyre intelektuale. Sidoqoftë, sistemet e sigurta të huadhënies shpesh nuk garantojnë plotësisht vënien e këtyre të drejtave si kolateral për hua. Kjo ngjall pasiguri në transaksionet huadhënëse ose rritje të panevojshme të kostove. Legjislacioni duhet t'u garantojë pronarëve të pronës intelektuale të përdorin këtë pronë si kolateral.
- **Marrëdhënia me ligjin për konkurrencën.** Marrëdhënia ndërmjet ligjit të pronës intelektuale dhe ligjit për konkurrencën shpesh është e paqartë.
- **Çështjet e zbatimit.** Në zbatim të detyrimeve të Marrëveshjes TRIPS, shumë shtete anëtare të OBT-së kanë miratuar ligje që teknikisht janë në linjë me standardet TRIPS. Megjithatë, kronologjia e zbatimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale në disa nga këto vende ka qenë e dobët.
- **Fusha e veprimit e ligjit të patentave.** Patenta është një e drejtë që shteti i jep pronarit të një shpikjeje për të mos lejuar të tjerët që të riprodhojnë, të përdorin, të importojnë apo të shesin shpikjen për një numër të caktuar vitesh. Marrëveshja TRIPS kërkon që mbrojtja e patentës të ekzistojë për çdo shpikje, qoftë produkt apo proces, në të gjitha fushat e teknologjisë, mjafton që shpikja të jetë e re dhe të ketë evoluar një shkallë më lart dhe që është e dobishme për përdorim industrial. (por, ama, vlen të konsiderohen *dhe disa çështje etike-morale: (1) proceset për klonimin e qenieve njerëzore, (2) proceset për modifikimin e identitetit gjenetik të embrionit të qenieve njerëzore, (3) përdorimi i embrioneve njerëzore për qëllime industriale apo tregtare, (4) proceset për modifikimin e identitetit gjenetik të kafshëve që u shkakton atyre vuajtje pa ndonjë benefit substancial mjekësor për njerëzit apo kafshët, si dhe kafshët që rezultojnë nga këto procese.*
- **Cilësia e patentave,** dhe mbi të gjitha kontrolli i tyre.

- **Modelet utilitare.** Regjistrimi i një modeli utilitar është një e drejtë ekskluzive që në disa vende jepet për shpikje të vogla ose përmirësime të teknologjive ekzistuese. Mbrojtja e modelit utilitar zakonisht kërkon më pak doza novacioni sesa mbrojtja e patentës, dhe kohëzgjatja e mbrojtjes së një modeli utilitar është shpesh shumë më e shkurtër sesa për patentën. Përdoret për të mbrojtur mjetet dhe instrumentet që janë të dobishme dhe praktike, por që nuk përfaqësojnë një hap teknik përpara.
- **Sekretet tregtare.** Neni 39.2 i TRIPS-it u kërkon shteteve anëtare të OBT-së të garantojnë mbrojtje për sekretet tregtare, domethënë për informacion të pazbuluar që s'para dihet nga personat e ditur të fushës, që ka vlerë tregtare meqë është sekret dhe personi që kontrollon informacionin merr masa të arsyeshme për ta mbajtur këtë sekret. Mbrojtja e sekreteve tregtare është thelbësore jo vetëm për ekzistencën dhe lulëzimin e bizneseve të teknologjisë së lartë, por edhe për çdo ndërmarrje që ka konkurrentë.
- **E drejta e autorit.** E drejta e autorit u jep autorëve të veprave origjinale – qofshin letrare, artistike dhe shkencore si për shembull librat, dramat, muzika, shkrimet, filmat, skicat arkitekturore dhe programet kompjuterike - të drejtën që të mos lejojnë të tjerët të kopjojnë, performojnë publikisht, transmetojnë, shfaqin apo shfrytëzojnë për qëllime tregtare veprën në një mënyrë tjetër. E drejta e autorit ka rëndësi disa herë më shumë për tregtinë me bazë Internetin. Tregtia në Internet shpesh përfshin shitjen dhe licencimin e pronës private. Për të promovuar këtë tregti, shitësit duan siguri që prona e tyre intelektuale nuk do të vidhet dhe blerësit duan siguri që produktet janë autentike. Për të realizuar tregtinë elektronike, shpërndarjen e të gjitha llojeve të produkteve të informacionit, nga bota e spektaklit të arsimit, nga softuerët e biznesit deri te bazat e të dhënave për kërkime shkencore, shitësit kërkojnë garanci se produktet e tyre nuk do të piratohen.
- **Marka tregtare** është një fjalë, emër produkti, simbol apo mjet që përdoret për të identifikuar mallrat apo shërbimet e një ndërmarrjeje, për t'i dalluar nga mallrat dhe shërbimet e tjera. Ndryshe nga patenta, e drejta e autorit dhe modeli utilitar, qëllimi primar i të drejtave të markave tregtare nuk është stimulimi i shpikjes, zbulimit, apo krijimit. Falsifikimi i produkteve nëpërmjet përdorimit të markave tregtare, është një nga format e mashtrimit të konsumatorit. Cenimi i markave tregtare ka pasoja negative edhe për bizneset e ligjshme.
- **Markat kolektive.** Marka kolektive është një markë tregtare apo markë shërbimi e veçantë për përdorim ekskluziv nga anëtarët e një kooperative, shoqate, sindikate apo lloj grupimi tjetër apo organizatë. Kur një markë kolektive aplikohet te një produkt apo shërbim, përdorimi i markës i rezervohet për përdorim vetëm anëtarëve të saj, të cilët e përdorin markën për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e tyre dhe për t'i dalluar nga ato të atyre që nuk janë anëtarë.
- **Markat e certifikimit.** Markat e certifikimit janë pjesë integrale e skemave certifikuese të produktit që ngrihen për të verifikuar që produktet janë konform disa kërkesave të caktuara p.sh. nuk janë OMGJ (organizama të modifikuara gjenetikiisht)
- **Mbrojtja e emrit të domeinit të Internetit**
- **Dizenjot industriale.** Nenet 25 dhe 26 të Marrëveshjes TRIPS u kërkojnë vendeve anëtarë të OBTsë që të miratojnë ligje që mbrojnë dizenjot e reja dhe origjinale industriale për të paktën 10 vjt. Kjo lloj mbrojtjeje aplikohet vetëm për elementët jo-funksionalë të dizenjos së objekteve industriale. Vendet në zhvillim dhe në tranzicion, nuk duhet të nënvlerësojnë mbrojtjen e dizenjove industriale, si një mjet që garanton se mjeshtrit dhe dizenjuesit të kontribuojnë me tërë potencialin e tyre në PBB.
- **Legjislacioni në mbështetje të zhvillimit të tregtisë elektronike.** “Legjislacioni elektronik” inkurajon zgjerimin e përdorimit të transaksioneve digjitale duke ngritur një kuadër ligjor që u lejon qeverive, kompanive dhe individëve që pa frikë të ofrojnë dhe blejnë mallra dhe shërbime nëpërmjet Internetit.

Prokurimet nga qeveria

Mallrat dhe shërbimet e blera nga qeveritë përbëjnë një përqindje të madhe të PBB-së. Në shumë vende, qeveria është blerësi më i madh i mallrave dhe shërbimeve. Por në mjaft shtete, fatkeqësisht, procesit të prokurimit i mungon transparenca dhe është i mbyllur ndaj konkurrencës së huaj. Sistemet prokuroese të mbyllura ose jotransparente mund të nxisin mashtrimin, shpërdorimin dhe korrupsionin. Ndërkohë që ka rrethana nën të cilat një vend ligjërisht mund të kontraktojë vetëm furnizues vendës, një politike e përgjithshme diskriminimi ndaj firmave të huaja në prokurime, mund të çojë në inefiçencë të lartë dhe në njollosje të reputacionit të vendit për investimet e huaja. Përpjekjet për harmonizimin e legjislacionit për prokurimet me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare, kanë qenë vetëm pjesërisht të suksesshme. Marrëveshja e OBT-së për Prokurimet Qeveritare kërkon mosdiskriminim e kompanive të huaja në radhët e qeverisjes qendrore dhe vendore të cilat blejnë dhe, transparenca në rregulla dhe procedura. Gjithashtu kërkon që qeveritë të vendosin procedura vendëse – të njohura ndryshe si “protesta oferte”, – me anë të të cilave furnizuesit e zhgënjyer mund të reklamojnë vendimet e prokurimit dhe të rifitojnë të drejtat, nëse vendimet e tilla kanë cenuar rregullat e marrëveshjes. Megjithatë, Marrëveshja e Prokurimit Qeveritar përkufizohet si marrëveshje “shumëpalëshe”: vendet e OBT-së nuk janë të detyruara të aderojnë. Deri më sot, vetëm 28 vende – mes tyre 25 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian – kanë nënshkruar Marrëveshjen e Prokurimit. Vendet e OSBE-së që po negociojnë për aderim, janë Shqipëria, Bullgaria, Gjeorgjia, Republika e Kirgizistanit dhe Moldavia. Shumë vende të OSBE-së janë vëzhguese të Marrëveshjes për Prokurimet, përfshirë Shqipërinë, Armeninë, Bullgarinë, Kroacinë, Gjeorgjinë, Republikën e Kirgizistanit, Moldavinë dhe Rumaninë.

Zbatimi dhe mbrojtja e ligjit për të drejtat private

- Një sistem ligjor efikas nuk e bëjnë vetëm ligjet e mira. Në fakt, miratimi i ligjeve është ndoshta aspekti më pak i vështirë i krijimit të institucioneve ligjore. Pa ekzekutimin e shpejtë dhe eficient të ligjeve dhe të të drejtave të pronësisë nga ana e gjykatave, legjislacioni bëhet joefikas dhe zhvillimi ekonomik vuan.
- Aktiviteti ekonomik vazhdon edhe në mungesë të sistemeve ligjore efikase për vënien në zbatim të të drejtave dhe detyrimeve. Ndërmarrjet që bëjnë biznes të suksesshëm me njëra-tjetrën për periudha të gjata, krijojnë marrëdhënie besimi çka e bën të panevojshme nevojën për ndërhyrjen e gjykatave. Gjithashtu shumë marrëveshje janë vetëzbatuese, në kuptimin që secila palë përfiton nga vazhdimi i marrëdhënies dhe rreziku se mos tregtia mes tyre ndalon, i nxit palët të përmbushin detyrimet. Reputacioni është gjithashtu një motivim i fortë që palët të respektojnë marrëveshjet, pasi askush nuk dëshiron të bëjë biznes me një ndërmarrje që njihet si shkelëse e premtimeve⁷⁸. Në disa rrethana, këto metoda informale zbatuese, janë efikase.
- Parimi latin “pacta sunt servanda” – kontratat duhet së pari të zbatohen sipas kushteve – është parimi themeltar i të gjitha ligjeve për kontratat. Edhe pse është objekt përjashtimesh për kontratat e njollosura nga paligjshmëria apo mashtrimi, gabimi i ndërsjellë e të tjera si këto, parimi i përgjithshëm që palët janë të detyruara nga marrëveshja mes tyre, është absolutisht i nevojshëm për të garantuar siguri dhe parashikueshmëri në marrëdhëniet tregtare. Mekanizmat formale të zbatimit të të drejtave, janë të rëndësishëm për një ekonomi të shëndoshë.
- *Gjykata efikase, asnjëse dhe të pavarura.* Në çështjet e përditshme të biznesit, shpesh lindin mosmarrëveshje. Palët ndonjëherë nuk bien dakord për të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në një ligj, kontratë, akt pronësie, apo instrument tjetër, pavarësisht se dokumenti është shkruar me shumë kujdes. Gjykatat luajnë rol vendimtar në zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve, por rëndësia e tyre në këtë aspekt shkon shumë përtej numrit të mosmarrëveshjeve të zgjidhura me vendim të prerë.
- *Kontributi i gjykatave në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nuk matet thjesht me numrin e çështjeve të zgjidhura. Kontributi kryesor i gjykatave... është të sigurojnë një plan normash dhe procedurash mbi të cilin të shtrihen negociatat dhe rregullimet private dhe shtetërore. Ky kontribut përfshin, midis të tjerave komunikimin potencial për mosmarrëveshjet, pasojat, në rast se njëri prej tyre kërkon të çojë çështjen në gjykatë.*
- Forcimi i gjykatave mund të kërkojë reforma strukturore dhe proceduriale, si dhe teknika për menaxhimin e gjyqit.
- *Mundësitë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.* Arbitrazhi është një mënyrë jogjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duke ia lënë në dorë një apo shumë personave asnjëse që të marrin një vendim të prerë dhe detyrues. Arbitrazhi favorizohet si metodë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare për disa arsye: 1) Procedurat janë private dhe konfidenciale; 2) U lejon palëve që për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të zgjedhin persona me njohuri të specializuara; 3) Procedura e arbitrazhit është shpesh më fleksibël se procedura gjyqësore dhe mund të modifikohet sipas nevojave specifike të palëve; 4) Vendimet e arbitrazhit nuk apelojnë, por janë përfundimtare dhe detyruese, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme; 5) Arbitrazhi është më i shpejtë dhe më pak i kushtueshëm se procedimi gjyqësor; 6) Arbitrazhi perceptohet si mënyrë për të pakësuar pabarazitë e një pale nga një vend i huaj; 7) Në çështjet ku shteti është palë në mosmarrëveshje, arbitrazhi redukton aftësinë e palës Shtet që të ushtrojë ndikim të padrejtë në marrjen e vendimit; dhe 8) Një numër traktatesh arbitrazhi tashmë i bëjnë vendimet e arbitrazhit plotësisht detyruese për vendet nënshkruese.

- **Pavarësisht arsyeve pse palët në transaksione ndërkombëtare shpesh zgjedhin arbitrazhin si mjet të parapëlqyer për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, disa qeveri dekurajojnë mekanizmat private të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Kjo armiqësi ndaj arbitrazhit manifestohet në disa mënyra, përfshi rregullime ligjore që diktojnë procedura detyruese për kryerjen e procedimeve të arbitrazhit, ose duke kufizuar kriteret se kush mund të shërbejë si arbitër, si dhe ligjet që lejojnë gjykatën “të refuzojë pezullimin e procedimit gjyqësor që ka nisur në shkelje të një marrëveshjeje arbitrazhi, nëse ajo beson se ka ‘arsye të mjaftueshme pse’ procedimi nuk duhet kaluar në arbitrazh”. Këto kufizime ndaj mundësisë së referimit dhe efikasitetit të një arbitrazhi, janë dekurajuese për investimet e huaja dhe për kontraktimet ndërkombëtare nga bizneset vendëse që kërkojnë të eksportojnë produktet dhe shërbimet, apo të bashkëpunojnë në ndërmarrje ndërkufitare me kapital të përbashkët. Shtetet duhet të lejojnë palët private të zgjidhin mosmarrëveshjet tregtare nëpërmjet arbitrazhit, me sa më pak kufizime të mundshme. Ato duhet të angazhohen që të aderojnë, nëse akoma nuk kanë aderuar, në Konventën për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve për Investimet Ndërmjet Shteteve dhe Shtetasve të Shteteve të Tjera e cila përcakton procedurën për arbitrimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet investuesve të huaj dhe qeverive të vendeve ku ato investojnë. Arbitrazhi është shpesh mënyra e preferuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të specifikuar në traktate dypalëshe për investimet. Për më tepër, vendet duhet të angazhohen që të nënshkruajnë Konventën e Nju Jorkut për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit, e vitit 1958, e cila njihet si Konventa e Nju Jorkut. Objekt i përjashtimeve të caktuara, Konventa e Nju Jorkut u kërkon vendeve anëtare të respektojnë vendimet e arbitrazhit, të marra në një tjetër vend anëtar.**
- **Përveç arbitrazhit, ka edhe forma të tjera alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që janë ndërmjetësimi dhe paqësimi. Këto terma shpesh përdoren në vend të njëri-tjetrit dhe të dy i referohen procesit ku palët në konflikt kërkojnë të zgjidhin diferencat nëpërmjet diskutimeve dhe jo gjyqit. Paqësimi zakonisht ndodh (ashtu si ndërmjetësimi) me ndihëm e një lehtësuesi, i cili asiston në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ndryshe nga arbitrazhi, këto procedura kërkojnë të zgjidhin mosmarrëveshjen pa marrë një vendim në lidhje me meritat që i takojnë pretendimeve, argumenteve apo mbrojtjes të cilësdo palë. Kombet që inkurajojnë përdorimin e të gjitha këtyre llojeve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, u heqin gjykatave të tyre një barrë të madhe dhe për më tepër lejojnë që më tepër burime ekonomike t’u përkushtohen aktiviteteve vërtet prodhuese, sesa në procedime ligjore që kushtojnë kohë dhe para**

Përfundime dhe rekomandime

- **Elementet e shumtë të strategjisë së suksesshme për zhvillimin ekonomik janë tepër të pavarura dhe efikasiteti i saj pengohet kur ka disbalancë në rëndësinë që u jepet komponentëve të saj. Ky konstatim është sidomos i vërtetë për sistemet ligjore në të cilat faktorët joligjorë si historia, kultura, arsimi dhe burimet financiare ndikojnë në zbatimin dhe shkallën e pranimi të ligjit. Për më tepër, themelet ligjore solide – si rregullat bazë për pronën; kontratat; liritë ekonomike dhe politike; dhe aksesin në drejtësi – janë të domosdoshëm për funksionimin e duhur të sistemeve ligjore më të detajuara si për shembull rregullimi i funksionimit të tregjeve të bursës. Pikat e forta dhe të dobëta të një pakete ligjesh dhe aktet, gjithashtu mund të kenë impakt të drejtpërdrejtë në funksionimin e legjislativitetit në fusha të tjera. Për të gjitha këto arsye, rrallëherë është taktikë e zgjuar apo efikase që të marrësh ligjet e një vendi dhe t'i imponosh në një vend tjetër pa pasur asnjë konsideratë për kushtet e vendit.**
- ***Të drejtat e pronës dhe të kontratave***
- ***Reforma rregullatore***
- ***Ligji për tregtinë, korporatat dhe letrat me vlerë***
- ***Të drejtat e kreditorëve***
- ***Ligji dhe politika bankare***
- ***Çështjet e parave.***
- ***Ligji dhe politika për konkurrencën***
- ***Prona intelektuale dhe tregtia elektronike***
- ***Prokurimi nga qeveria***
- ***Zbatimi i kontratave dhe të drejtave të tjera private***

Nxitja e investimeve

- **Shumë vende kanë shënuar sukses në tërheqjen e investimeve nëpërmjet përdorimit të Agjencive për Nxitjen e Investimeve (IPA-t). IPA-t kryejnë një numër funksionesh të rëndësishme, përfshi plotësimin e nevojave të investuesve, mbrojtjen e politikave miqësore ndaj biznesit, dhe kultivimin dhe projektimin e imazhit të favorshëm të një vendi si destinacion investimi. Përveç përdorimit të IPA-ve, aplikimi i kujdesshëm i incentivave për investimet – si për shembull ulja e taksave të korporatave, incentivat për zonat e pafavorizuara dhe parqet industriale – ndihmojnë në përmirësimin e klimës së biznesit, me kusht që ato të mos krijojnë diskriminim ndërmjet investuesve dhe që të mos marrin vendin e reformave institucionale të rekomanduara në këtë Udhëzues. Në vendet ku elementet kyçe të klimës së mirë të investimeve nuk janë ende plotësisht funksionale, instrumentet si garancitë sovrane dhe sigurimi i riskut politik mund të ndihmojnë investuesit të kapërcejnë ngurrimin e tyre për të bërë biznes.**

Agjencitë e nxitjes së investimeve

- Agjencitë e nxitjes së investimeve janë një mekanizëm i rëndësishëm për tërheqjen e IHD-së. Nxitja e investimeve të brendshme ose agjencia për investimet hyrëse është hallka lidhëse për zhvillimin e imazhit të një vendi si një destinacion investimi, përmirësimin e klimës së investimeve dhe rekrutimin aktiv të investuesve të huaj. Suksesi i një agjencie promovuese të investimeve matet në fund me shkallën se deri ku arrin objektivin madhor: rritjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta. Investimet grinfilld (urbanizimi i tokave) duhet të jenë kryefjala e përpjekjeve të IPA-s. Një IPA e arrin objektivin madhor kur: arrin një impakt të prekshëm dhe domethenës në heqjen e barrierave ndaj investimeve, dhe duke përmirësuar mjedisin e biznesit pasi përpiqet të kuptojë kërkesat e investuesve dhe duke hartuar politika dhe alternativa me programe, mbrojtjen e politikave miqësore ndaj investimeve dhe komunikimin e bashkëpunimit efikas me organet e tjera të qeverisë; zhvillon imazhin e vendit si një destinacion tërheqës investimi duke vënë në përdorim praktikatat më të mira të nxitjes dhe gjenerimit të investimeve; lehtëson gjenerimin e investimeve duke u dhënë investuesve të mundshëm informacion të dobishëm mbi biznesin sa më shpejt që u nevojitet, dhe duke ngritur një “rast biznesi” efektiv për vendin si destinacion për investime; konsolidon identitetin e vet si pike referimi për investuesit aktualë për të ndërmjetësuar me qeverinë dhe për t’iu dhënë informacion rreth nismave të tyre dhe “shërbimeve të përkujdesjes” për shtyrjen përpara të investimeve duke rritur përmasat e investimit ekzistues dhe rekruton përkrahjen e investuesve ekzistues në nxitjen e imazhit, vepron si agjensi e pavarur pa orientim politik dhe e fokusuar te cilësia, shërbimi ndaj klientit dhe rritja e investimeve.
- **Cilat janë aktivitetet kryesore të një IPA?**
- ***Përkrahja e politikave/heqja e barrierave ndaj investimeve:*** Duke mbajtur vazhdimisht qëndrim të pavarur dhe jopolitik, një IPA përpiqet të përkrahë politikatat ekonomike që stimulojnë investimet dhe që janë në linjë me normat dhe standardet ndërkombëtare. Roli i një IPA në heqjen e barrierave për investimet, bazohet në tri fusha:
- - ***Identifikimi i barrierave më të mëdha për investimet duke u konsultuar me investuesit e huaj.*** Në mënyrë që të arrijë ndikime të dukshme në klimën e investimeve, reformat duhet të jenë me vend dhe të kenë impakt të ndjeshëm. Një IPA përvetëson këndvështrimin e investuesit të huaj për të identifikuar barrierat më të mëdha dhe “më të zgjidhshme” ndaj biznesit. IPA i paraqet qeverisë rekomandime specifike për politika dhe programe, bazuar në inputin që merr nga investuesit e huaj.

- - **Përkrahja e përpjekjeve për pakësimin e barrave rregullatore.** Fakti që profesionistët e IPA-s e kuptojnë nevojën për një mjedis rregullator më praktik, do të thotë që ata këmbëngulin në arritjen e përmirësimeve në fusha si regjistrimi i ndërmarrjeve dhe licencimi, si dhe administrimi tatimor. IPA mund të asistojë në përcaktimin e praktikave të mira dhe ideve novatore nga investuesit e huaj, reformave rregullatore efikase, dhe mund të vlerësojë sa kanë mbetur të kënaqur grupet e interesit nga ndryshimet.
- - **Nxitja e imazhit pozitiv.** IPA luan rol kryesor në nxitjen e imazhit të një vendi si destinacion tërheqës për investimet. Disa nga detyrat janë ndihma për të krijuar konceptimin e imazhit, krijimi dhe shpërndarja e mesazheve kryesore. Temat e mundshme për mesazhet mund të jenë: **Rritja e përgjithshme në stabilitetin politik dhe makroekonomik, Aksesi në treg, Tregu i brendshëm, Burimet natyrore, Integrimi rajonal dhe ndërkombëtar, Kostot konkurruese/fitimet për investimet.**
- Në mjetet e siguruar nga IPA zakonisht përfshihen: **Prezantimet, Materialet e marketingut, Faqja e internetit, Marrëdhënie me mediat, Prania në komunitet (sponzorizimet), Udhëheqje aktive, Gjenerimi i investimeve, Asistencë informative, Gjenerim i kontakteve, Mbështetje për institucionet e tjera qeveritare, Misionet investuese, Shënjestrim i investuesit, Ofrimi i shërbimeve investuese, etj.**
- Përveç nxitjes së IHD-së të investuesit potencialë, IPA jep informacion dhe shërbime për klientin. Mes këtyre shërbimeve përfshihet dhe Agjencia për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe. P.sh., Kjo agjenci shërben si “one-stop-shop” për investuesit, duke dhënë miratime për investime, regjistrim të kompanive dhe siguron licenca dhe leje të tjera, që nevojiten për të nisur operacionet konkrete.
- **Asistenca për regjistrimin e ndërmarrjeve.** Stafi i IPA-s shpjegon procesin e regjistrimit të ndërmarrjes, gjen forma për të filluar procesin dhe udhëzojnë investuesit për pikënisjen e duhur.
- **Informacion për zgjedhjen e vendit.** IPA ofron informacion (demografi, rrjete transporti, kosto, etj) për rajonet në një vend, për t'i asistuar investuesit në kërkimin e tyre për gjetjen e një vendi të mirë.
- **Asistencë për zgjerimin e investimit.** IPA u siguron informacione investuesve potencialë që kërkojnë burime të financave, partnerë biznesi, ofrues shërbimesh, shitës, apo mundësi për të rritur dhe zgjeruar investimet e tyre.
- **Ndërmjetësim me ofruesit e shërbimeve dhe infrastrukturë.** Në disa rrethana, investuesit që e kanë përfunduar procesin e autorizimeve dhe licencimit, duhet të presin muaj para se të nisin aktivitetin ekonomik për shkak se nuk ka ende lidhje të elektricitetit apo ngaqë një rrugë nuk është ndërtuar. IPA kontakton me ofruesit si për shembull kompanitë e shpërndarjes së energjisë, drejtuesit e ujësujellës-kanalizimeve, departamentet e punëve publike, nëse investuesi ka probleme me aksesin në këto shërbime.
- **Gjurmimi i investuesit.** IPA monitoron progresin e investimeve, duke u siguruar që investimet aktuale dhe investuesit aktualë të ndiqen në bazë të fushës së interesit, vendit të origjinës, kohës, përmasave të investimit, etj. Kështu shihet edhe si po ecën investimi.
- **Baza e të dhënave për mundësitë investuese.** IPA shpesh vepron si pikë kontakti qendrore për përgatitjen e një baze të dhënash për mundësitë e investimeve.
- **Raportimi.** IPA raporton te qeveria, publiku i gjerë dhe media për lajmet rreth investimeve, statistikave dhe gjendjen e mjedisit të biznesit.
- **Kërkesat për informacion.** IPA plotëson kërkesat për informacion rreth investimeve, nga anëtarë të medias, OJF-ve, qeverive të huaja, institucioneve akademike, dhe organizatave të tjera që kërkojnë informacion mbi investimet e huaja të drejtpërdrejta.

Incentivat për investimet

- **Roli i incentivave për investimet:** Nëse incentivat për investimet nuk menaxhohen me kujdes, ato krijojnë një mjedis biznesi të pabalancuar dhe diskriminues, kështu që duhen mbajtur në minimum. Megjithatë, disa incentiva mund të përshpejtojnë IHD-në kur përdoren si duhet. Sidoqoftë incentivat nuk mund të shërbejnë si recetë e parë për përmirësimin e klimës së biznesit dhe investimeve, dhe se incentivat duhet të shihen si shtesa të klimës së favorshme ekzistuese. Disa mekanizma incentivash potenciale janë paraqitur më poshtë, të shoqëruara nga praktikat më të mira.

Incentivat fiskale

Qeveritë u ofrojnë investuesve incentiva fiskale ose tatimore, zakonisht investuesve të huaj, për ta bërë vendin e tyre më tërheqës si destinacion investimi. Disa nga incentivat më të përhapura janë:

- - Reduktimi i taksave mbi të ardhurat
- - Aftësia për të zbritur fitimet që investohen serish në zgjerimin e aktivitetit të kompanisë, nga taksat e korporatës;
- - Perjashtim nga taksat në të cilat kompanitë nuk detyrohen të paguajnë taksë mbi fitimin apo sigurime shoqërore për një periudhë kohore të specifikuar;
- - Aftësia për të mbartur humbjet e pesuara në fazat e para të investimit, në vitet e mëvonshme;
- - Detyrim tatimor i reduktuar ose zero për punësimin e personave të papunë, të sapodiplomuarit në universitet, efektivët ish-ushtarakë, etj.;
- - Perjashtim ose shtyrje e pagimit të TVSH-se
- - Shtyrje e pagimit të TVSH-se deri në fillimin e aktivizimit të biznesit;
- - Rimbursim i shpejtë i TVSH-se
- - Perjashtim ose shtyrje apo e tarifave doganore për investimet kapitale;
- - Zbritje e vlerës ose një pjesë të vlerës së investimit kapital nga taksat mbi të ardhurat;
- - Zhvlerësimi i pershpejtuar i investimeve kapitale
- - Perjashtim nga taksat në rastin e kthimit të tokës bujqësore në tokë industriale; dhe
- - Grante për nisma trajnuese apo hapjen e vendeve të punës në zonat e pafavorizuara.

Është e vështirë të renditen incentivat sipas një rendi efikasiteti. Efikasiteti i tyre krahasues varet nga faktorë të tillë si tipi dhe sektori i investimit, koha që investimi të përfundojë, pasuria relative kombëtare e vendit dhe aftësia e qeverisë për të menaxhuar incentivat. Estonia ka arritur sukses të konsiderueshëm me incentivën e riinvestimit të fitimit. Kroacia ka tërhequr investime me anë të përjashtimit nga taksat. Etj. Sidoqoftë incentivat duhet të jenë transparente, të hapura për investuesit vendës dhe të huaj, të paspecifikuara sipas industrive dhe të thjeshta për t'u menaxhuar. Incentivat duhet të zbatohen në përputhje me një paketë rregullash dhe të mos u ofrohen investimeve individuale në bazë, rast pas rasti. Po ashtu, qeveritë duhet të analizojnë efikasitetin e kostove të incentivave mbi bazë vjetore, nderkohe që koha totale e tyre është e kufizuar, me datë të qartë skadimi. OECD rekomandon një periudhë jo më të gjatë se 5 vite, e cila edhe kaq dhe është shumë e gjatë.

- Qeveritë, gjithashtu, janë të këshilluara që të mbajnë një strukturë tatimore mbi të ardhurat që i ndihmon të gjitha bizneset duke vënë theksin më tepër në thjeshtësia dhe nivelin e ulët të taksave, sesa skemat e ndërlikuara të incentivash që synojnë të ulin tatimin mbi të ardhurat për investuesit e huaj. Skemat e ndërlikuara të incentivave janë të vështira për t'u menaxhuar si nga qeveria, ashtu edhe për bizneset, krijojnë zhbalancime në treg dhe hapin më shumë mundësi për korrupsion.

Zonat e pafavorizuara

- Dhënia e incentivave në zona të pafavorizuara është një metodë tradicionale për zhvillimin ekonomik. Ngritja e zonave të ndërmarrjeve urbane në zona të pafavorizuara është deri diku e suksesshme. Në Shtetet e Bashkuara, zonat e ndërmarrjeve urbane janë përdorur për dekada për të ringjallur zonat urbane në rënie. Bizneseve iu dhanë incentiva që të blejnë tokën, të investojnë në biznes dhe të punësojnë punëtorë. Cilësimi si zonë e pafavorizuar e zonave të varfra pa infrastrukturë, gërryen konkurrueshmërinë e përgjithshme duke i dhënë avantazhe zonave jokonkurrese dhe nuk është një mënyrë e mirë për zhvillimin ekonomik. Incentivat përfundimisht nuk mund të tërheqin investuesit apo bizneset e reja në zona që janë tejet jotërheqëse

Zonat e lira/zonat ekonomike speciale

- E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ngritjen e zonave të lira apo zonave ekonomike speciale, të cilat duhet të ngrihen në vende që ofrojnë një destinacion konkurrues për investuesit. Zonat e lira janë zona me incentiva të veçanta, zakonisht përjashtim nga detyrimet e TVSH-së dhe detyrimet doganore, por mund të kenë edhe më tepër incentiva si për shembull zbutje e standardeve të mjedisit dhe punës.
- Vlera e këtyre zonave vazhdon të jetë temë debati. Nga njëra anë, duke ofruar kushte të privilegjuara tregtare për eksportet prodhuese, zonat ekonomike speciale mund të tërheqin investimet dhe shkëmbimet e huaja, të nxisin punësimin, dhe të inkurajojnë përmirësimin e teknologjive dhe infrastrukturës. Por, ama, zonat ekonomike speciale mund të tërheqin investime vetëm sepse ofrojnë incentiva shtrembëruese, më tepër sesa duke ofruar kushte konkurruese. Bile, këto incentiva krijojnë barrë fiskale të tatimpaguesit dhe dëmtojnë standardet e mjedisit dhe punës, kostot e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta për mbajtjen e privilegjeve të zonave të tilla, nuk shkojnë në të mirë të pjesës tjetër të ekonomisë, çka çon në enklava të lulëzuara.
- Për momentin operojnë 3 000 zona ekonomike speciale në 120 vende, me një total prej më shumë se 600 miliard dollarë amerikanë në eksporte dhe 50 milion vende pune të drejtpërdrejta. Disa nga epersitet e tyre lidhen me ***vendndodhjen inteligjente*** (fuqi punëtore të bollshme, cilësi të mire jete, ekonomi në rritje, etj.) , ***me planifikim transportimi*** (infrastruktura transporti dhe komunikimi, etj.), ***me infrastrukturen dhe shërbimet në pergjithësi me procedurat konkrete dhe një burokraci minimale., me një menaxhim inteligjent të incentivave,*** etj.

Parqet industriale

- Parku industrial mund të përkufizohet si një copë toke posaçërisht për përdorim dhe zhvillim industrial. Parqet/zonat industriale kanë tre modele kryesore pronësie:
 - - **Park industrial i autoritetit shteteror;**
 - - **I sektorit privat;**
 - - **Partneriteti public-privat apo ndermarrje me kapital të përbashkët ndërmjet shtetit dhe sektorit privat.**
- Parqet industriale zakonisht ngrihen në zona me komunikacion dhe infrastrukturë transporti shumë të mirë, akses në energji dhe me fuqi punëtore. Edhe pse parqet industriale mund të kenë shumë emra – zona industriale, zona eksport-prodhuese, parqe biznesi, parqe të teknologjisë së lartë, zona të zhvillimit industrial, apo parqe eko-industrialë – ato kanë dy karakteristika të përbashkëta. Së pari, ato mirëpresin një numër firmash brenda një parcele toke e veçuar për këtë qëllim, të cilat përdorin së bashku infrastrukturën, shërbimet bazë të ujit, kanalizimeve, zjarrfikësve dhe të sigurisë, si dhe zonat e përbashkëta. Parqet industriale gjithashtu kanë një strukturë të përbashkët menaxhimi që mbikëqyr aktivitetet në park. Parqet industriale të standardit ndërkombëtar, zakonisht u ofrojnë bizneseve gjërat e mëposhtme:
 - - Cmim tregu per tokat industriale si per qiradhënie, ashtu edhe për shitje;
 - - Akses ne fuqi punetore nga zonat fqinje;
 - - Transport (me zona te rendesishme si zonat urbane, aeroportet, terminallet e trenave, portet detare dhe terminallet e kontenierëve), lidhje transporti publik si stacione autobusi apo vendparkime, etj.;
 - - Rrjet efektiv telekomunikimi. Internet dhe shërbime të tjera të përparuara.
 - - Parcela toke të pajisura me rrugë, kanale kulluese, kanalizime ujërash, elektricitet dhe ujë;
 - - Trajtim i barabarte ibizneseve ndërmjet investuesve vendës dhe të huaj.
- **Pra, me to lidhen vendndodhja, disponibiliteti i fuqisë punëtore të kualifikuar dhe me kosto të arsyeshme, shërbimet e infrastrukturës apo menaxhimi.**
- **Avantazhi i parqeve industriale është se përshpejtojnë zhvillimin e një projekti investimi, ose fillimin e operacioneve fitimprurëse për një NVM. Meqë shërbimet zakonisht përdoren bashkërisht, kostoja totale e operacioneve është më e ulët në parqet industriale dhe NVM-të përfitojnë nga grumbullimi i bizneseve. Parqet industriale të organizuara mirë mund të ndihmojnë biznesin të përballojë çështjet e lejeve dhe licencimit, rregullimet ligjore dhe aksesin në shërbime bazë. Për më tepër, suksesi i tyre mund të rrisë konkurrueshmërinë ekonomike duke tërhequr kompani shumëkombëshe dhe duke inkurajuar zhvillimin e NVM-ve; këto të fundit mund të ndihmojnë në mjedisin e biznesit. Duhet të theksohet se parqet industriale nuk mund të jenë recetë zëvendësuese për mjedisin e favorshëm të biznesit. Megjithatë, thithja e kompanive të mëdha shpesh “e shtyn” më lart cilësinë e klimës së biznesit, p.sh. ne Sllovaki.**

Garancitë për investimet dhe sigurimi i riskut politik

- Në situata të caktuara, kompanitë analizojnë premiset e një investimi dhe zbulojnë që fitimet janë të përshtatshme dhe se janë në gjendje të financojnë investimit. Megjithatë, mund të shqetësohen se klima e investimeve në vend dhe mjedisi politik do të krijojnë risk tepër të lartë për të vazhduar me investimin. Me qëllim që të promovohen investimet në këto rrethana, vendet ofrojnë atë që njihet si “**garancia sovrane**”. Me një garanci sovrane, qeveria i siguron garanci financiare, domethënë kompenson humbjet apo mospagimet që vijnë si rezultat i situatave politike dhe ligjore.
- Krizat sociale, kolapsi ekonomik, dorëzimet e pushtetit me konflikt, shpronësimet nga shteti të aseteve dhe shkelja e kontratave, janë ngjarje që pengojnë përfundimin e investimit dhe që mund të kërkojnë një garanci sovrane. Garancitë jepen jo për të mbrojtur bizneset nga taktikat e dobëta të biznesit, por për t’i ndihmuar që të realizojnë taktika të zgjuara biznesi në një mjedis të paparashikueshëm. Shumë investues ngurrojnë të pranojnë një garanci sovrane nga qeveritë me klimë të pafavorshme biznesi dhe investimesh. Në këtë rast, investuesi kërkon garanci te një palë e tretë ose blen sigurim për riskun politik. Nën këto rrethana, pala e tretë garantuese që zakonisht është një bankë zhvillimi, do të ofrojë një garanci pavarësisht garancisë sovrane, ose ofron një “garanci mbështetëse” mbi garancinë sovrane të ofruar nga shteti. BERZH dhe Banka Botërore u ofrojnë garanci investuesve për projektet në ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion. Për momentin, programi i garancisë i Bankës Botërore nuk po përdoret sa duhet dhe po kërkon pjesëmarrës shtesë. Ama, garancitë kanë kosto. Një përqindje e shumës së garancisë, i ngarkohet investuesit. Ky interes është zakonisht i arsyeshëm, me shifra të vogla teke. Megjithatë, përdorimi i garancive rrit kostot e investimit: një tjetër konfirmim i parimit që klima e favorshme e biznesit ul kostot e hyrjes në treg.
- Sigurimi i riskut politik është produkt që investuesit e blejnë për të siguruar projektet e tyre kundër humbjeve që lidhen me: kufizimet në transferimin e valutes, shpronësimin, lufterat apo trazirat civile, shkeljen e kontratës. Ndërkohë që sigurimi i riskut politik shton kostot e një projekti, nëse një investues kërkon financime, sigurimi i riskut politik favorizon investuesin sepse ai mund të marrë financim me kushte më të favorshme pasi risku i projektit është i zvogëluar. Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA) dhe Kompania e Investimeve Private (OPIC), janë dy nga ofruesit më të mëdhenj të sigurimeve të riskut politik.
- Se fundi, disa nga praktikatat më të mira të rekomandueshme janë: ***nxitja e investimeve, incentivat e investimeve, parqet industriale, etj.***

Zhvillimi dhe nxitja e tyre

- ***Rritja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) është komponent thelbësor i zhvillimit ekonomik. NVM-të zakonisht janë burim i konsiderueshëm punësimi dhe ndihmojnë në stimulimin e novacionit, dinamizmit ekonomik dhe konkurrencës. Ky kapitull i kushton vëmendje të veçantë impaktit të NVM-ve në zhvillimin ekonomik dhe social të shteteve dhe rëndësisë së klimës së favorshme të biznesit dhe investimeve për zhvillimin e suksesshëm të këtij sektori. Gjithashtu, disa veprime specifike për NVM-të nga ana e qeverisë në fushat e financës, arsimit dhe mbështetjes për ndërmarrjet, mund të zhvillojnë sektorin e NVM-ve, pa shkaktuar shtrembërime të tregut.***

Rëndësia e zhvillimit të NVM-ve. Ndikimi ekonomik i NVM-ve

- **Rritja e NVM-ve është një komponent thelbësor i zhvillimit ekonomik.** Mbi 90% e bizneseve janë NVM, dhe përgjithësisht shërbejnë si motori më i madh i hapjes së vendeve të punës në ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion, shpesh duke përfaqësuar mbi 60% të vendeve të punës. Shumica e kompanive kanë personel më pak se 100 vetë. Një studim për 60 000 persona me të ardhura të pakta në më tepër se 50 shtete, tregoi se hapja e një biznesi të ri konsiderohej si metoda më efikase për t'i shpëtuar varfërisë.
- **Zhvillimi i ndërmarrjeve të reja sjell njerëz të rinj në fuqinë punëtore, shton tatimpagues të rinj, produkte dhe shërbime në tregjet vendëse, rajonale dhe globale.** “NVM-të janë burim punësimi, konkurrence, dinamizmi ekonomik dhe novacioni; ato stimulojnë shpirtin sipërmarrës dhe përhapjen e aftësive. Për shkak se gëzojnë prani gjeografike më të gjerë sesa kompanitë e mëdha, NVM-të kontribuojnë edhe në shpërndarjen më të mirë të të ardhurave”.
- **Ne tabelat e mëposhtme shihet roli jetik që luan sektori i NVMve, bile NVM-të japin kontributin më të lartë në PBB dhe punësim në shumicën e vendeve të zhvilluara të botës si SHBA, Japonia, Gjermania, Franca, Italia dhe Britania e Madhe.** Ndërsa në ekonomitë në tranzicion, ndikimi i NVM-ve është më pak dinamik dhe luajnë një rol më pak të rëndësishëm në PBB dhe punësim. Vendet që gjykohen se po bëjnë progres të ngadaltë në tranzicionin ekonomik, kanë përqindjen më të ulët të NVM-ve si përqindje e PBB-së për frymë (28%) dhe në punësim total (29%). Sipas ekspertëve në mënyrë që sektori i NVM-ve të japë kontribut të ndjeshëm në ekonomi, vende pune dhe siguri, “duhet të kalohet pragu rreth 40% i aksioneve të ndërmarrjeve të vogla në punësim dhe vlerë të shtuar, në mënyrë që ndërmarrjet e reja të përthithin burimet e çliruara nga sektori i vjetër dhe të kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme. Vetëm numri i lartë i ndërmarrjeve të vogla produktive, nuk mjafton. Me përjashtim të rasteve kur kombinohet me rritjen e shpejtë në përqindjen e punësimit, sektori i bizneseve të vogla nuk do të zhvillojë atë masë vendimtare për të çuar në rritje ekonomike agregate”.

Zvogëlimi i efektit të NVMve si rezultat i ekonomisë informale

- Përmasat dhe tërheqja e “ekonomisë informale” krahasuar me “ekonominë formale” zvogëlon impaktin ekonomik të NVM-ve. Në figuren e mëposhtme përshkruhet situata në vendet me të ardhura të ulëta në të cilat punësimi dhe prodhimi nga sektori informal, është më i madh sesa në sektorin NVM. Zhvendosja e aktivitetit ekonomik nga ekonomia informale në biznese të ligjshme, është përcaktuese për zhvillimin ekonomik.
- Punësimi në ndërmarrje të ligjshme garanton që një përqindje më e madhe e fuqisë punëtore të mbulohet me pensione, standarde sigurie dhe kontribute shëndetësore; kjo vlen veçanërisht për femrat dhe të rinjtë, të cilët përbëjnë 75% të punëtorëve në sektorin informal. Përfundimisht, punësimi i ligjshëm rrit përfitimin financiar nga kontributet shoqërore nëpërmjet rritjes së mbledhjes së taksave.


Rritja e potencialit të NVMve nëpërmjet përmirësimit të klimës së biznesit

- **Spektori i NVM-ve ka një potencial të pallogaritshëm për të kontribuar në rritjen ekonomike, hapjen e vendeve të punës dhe zbutjen e varfërisë. Pergjithesisht, ndërmarrrjet e reja kanë aftësi transformuese. Sidoqoftë, që NVM-të të japin efektet e dëshiruara, sipërmarrësit duhet të jenë të motivuar që të ngrenë ndërmarrrje të ligjshme dhe që sipërmarrjet e tyre të mund të mbijetojnë. Faktori më i rëndësishëm për të bindur sipërmarrësit që të punojnë në mënyrë të ligjshme dhe për t'i ndihmuar që të mbijetojnë, është klima e biznesit. Nëse barra tejkalon fitimet potenciale, bizneset e ndiejnë shumë pak stimulin për t'u larguar nga ekonomia informale. Madje edhe në mjediset më të mira të biznesit, shumica e bizneseve të reja dështojnë. Mjedisi i pafavorshëm me taksa të larta, korrupsion dhe burokraci shtypëse, kompromenton më tej premisat për sukses. Kufizimet më të mëdha që i bëhen zhvillimit të NVMve janë: - ligji i tepruar dhe kontradiktor i biznesit, administrata e burokratizuar (regjistrim, licencim, taksa, etj.) , korrupsioni dhe veshtiresite ne zbatimin e kontratave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Nderkohe, disa barriera që kanë lidhje me NVM apo SME-të janë: mungesa e kapitalit për hapje biznesi dhe rritje të tij; tatim i larte, aksesit i kufizuar ne asete dhe mungtesa e aftesive drejtuese.**

Zvogëlimi i barrierave për NVM-të

Klima e pafavorshme e biznesit ka ndikim më të madh mbi NVM-të sesa mbi bizneset e mëdha, sepse NVM-të kanë më pak ndihm politik dhe fluks të pamjaftueshëm parash për të ndërmarrë apo për të mbijetuar procedimeve ligjore, si dhe burime të pamjaftueshme për t'iu bindur rregullimeve. Një studim i kryer në 11 vende të OECD-së konstatoi se kostot e bindjes administrative për punëtor, ishin mbi pesë herë më të larta për NVM-të më të vogla sesa për ato më të mëdhatë. Firmat e vogla nuk kryejnë veprime të shumta administrative që t'u mudësojë shpërndarjen e kostove.

Kostot vjetore administrative për punëtor



Burimi: OECD (2001), Pikëpamjet e Biznesit për Burokracinë

OECD, *Nxitja e Sipërmarrjes dhe NVM-ve novatore në një Ekonomi Globale: Drejt një Globalizimi Më të Zgjuar dhe Më Përfshirës*, (2004), <www.oecd.org/searchResult/>

Masat për reduktimin e vështirësive specifike për NVM-të

- **Veprimet dhe politikat e qeverisë që përmirësojnë klimën e biznesit që ndikojnë te investuesit e huaj dhe kompanitë e mëdha, janë njësoj si vështirësitë që mendojnë NVM-të. Me ndihmën e USAID-it, BE-së dhe organizatave të tjera, shumë vende po ndërmarrin masa për lehtësimin e vështirësive të bizneseve. Dy vështirësitë specifike që ndikojnë më tepër te NVM-të janë procesi i regjistrimit të biznesit dhe inspektimet shtetërore të NVM-ve. Për një korporatë të madhe që investon 50 milion euro për një fabrikë që kërkon dy vite planifikim dhe ndërtim, kostot e procesit 30-ditor të regjistrimit si dhe tarifat për konsulentët dhe avokatët, janë relativisht të ulëta. Për një NVM që prët të angazhohet në projektin e parë, kostot e regjistrimit dhe vonesat mund të jenë fatale. Disa nga problemet:**
- ***Regjistrimi i biznesit.*** Hyrja pa vonesa në treg është e rëndësishme veçanërisht për mikrondërmarrjet e reja. Koha e kërkuar për regjistrimin e një ndërmarrjeje shpesh konsiderohet si një tregues domethënës i cilësisë së mjedisit të biznesit. Vendet më të përparuara i regjistrojnë bizneset për një ditë, ndërsa në vendet e tjera, kjo gjë mund të kërkojë edhe disa muaj. Një praktikë e mire për përsheptimin e regjistrimit të bizneseve është modeli one-stop-shop. Në këtë model, një pronari biznesi i kërkohet vetëm që të dorëzojë shkresat e regjistrimit në një vend. Pra, kemi vetëm në një kontakt të vetëm te sipërmarrësit me regjistruesin shtetëror, i cili pranon aplikimet dhe kryen të gjitha funksionet e regjistrimit dhe raportimit në një kohe të shkurtër (disa ditore)
- ***Inspektimet shtetërore.*** Inspektimet u kushtojnë shumë kohë dhe kosto NVM-ve. Përgjithësisht, NVM-të e kanë më të vështirë të menaxhojnë humbjen e prodhueshmërisë gjatë auditimit fiskal apo inspektimeve. NVM-të s'mund të përballojnë pagimin e personelit të zgjeruar financiar dhe ligjor, dhe nuk kanë stafin administrative për të asistuar inspektorët. Zakonisht janë vetë pronarët me të ardhurat e tyre, që angazhohen me auditimet e shumta fiskale, inspektimet shëndetësore, inspektimet për mjetet kundër zjarrit dhe gjëra të tilla.
- ***Vlerësimi i ndikimit rregullator miqësor për NVM-të.*** Përveç faktit që shumë vende nuk arrijnë të kompletojnë këtë vlerësim para futjes së rregullimeve të reja ligjore, të gjitha këto ndryshime duhet të mbajnë më parasysh NVM-të, pasi ato shpesh kanë ndikim më të madh mbi NVM-të sesa bizneset më të mëdha.

Krijimi i një programi mbështetës shtetëror për zhvillimin e NVM-ve

- Per përmirësimin e klimës së biznesit dhe investimeve kerkohet te thellohen perpjekjet mbi heqjen e rregullimeve të panevojshme, përmirësimin të ligjeve, transparencës e kështu me radhë, sesa të synohen incentiva apo programe të shtrenjta qeveritare. Qëllimi final është konkurrueshmëria ekonomike, sepse një ekonomi konkurruese tërheq IHD dhe inkurajon sipërmarrjen. Në nivelin makro, prania e NVM-ve e rrit konkurrueshmërinë e ekonomisë. Në nivelin makro, NVM-të mund të kenë vështirësi për të konkurruar me ndërmarrjet më të mëdha. Ndërkohë që NVM-të rriten dhe pihen deri në pikën kur bëhen konkurruese, ato mund të kenë nevojë për mbështetjen shtetërore, por fokusi i kësaj mbështetje nuk duhet të jetë mbajtja me doemos në punë e NVM-ve. Ekonomitë e tregut nuk mbështesin bizneset joefiçente, por krijojnë një kuadër me barra të arsyeshme rregullatore, akses në financa dhe akses në njohuri. Në momentin kur ndërmarrjet e arrijnë konkurrueshmërinë, ato nuk gëzojnë më të drejtën e këtyre përfitimeve.

Përfitimet nga taksat për NVM-të

- Të gjitha ndërmarrjet, të mëdha apo të vogla, duhet të paguajnë taksat që u takojnë. Me qëllim që të ndihmohen bizneset e vogla që të rriten dhe të zhvillohen si tatimpagues të mirëfilltë, mund t'ia vlejë që qeveritë t'u akordojnë NVM-ve lehtësira të kufizuara tatimore.
- ***Taksat e thjeshtuara.*** Sistemet administrative tatimore që janë të ndërlikuara, janë barrë për NVM-të. Pagimi i taksave të ndërlikuara që kërkon ekspertizë të kushtueshme, redukton fitimprurjen e NVM-ve. Reduktimi i ndërlikimeve të raportimit tatimor u mundëson NVM-ve që të përqendrohen në zhvillimin e ndërmarrjes. Për ndërmarrjet me disa limite si numri i punëtorëve apo xhiroja vjetore, shumica e sistemeve tatimore bazohen në një përqindje të thjeshtë të të ardhurave apo xhiros.
- Në Shqipëri, një përqindje fikse aplikohet për mikrondërmarrjet me xhiro vjetore deri në 2 milion lek (14 000 USD). Ndërmarrjet e vogla me xhiro vjetore nga 2 milionë deri në 8 milion lek, paguajnë vetëm një nivel tatimi që është 4% e xhiros.
- Qeveritë, kur u ofrojnë NVM-ve skema tatimore të thjeshtuara, duhet të kenë kujdes nga kompanitë që artificialisht ndahen në ndërmarrje të vogla me qëllim që të qëndrojnë brenda pragut tatimor dhe që të përfitojnë nga trajtimi preferencial tatimor.

Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe rritja e kulturës së sipërmarrjes

- **Burimet njerëzore janë faktor esencial për rritjen dhe zhvillimin ekonomik dhe kërkojnë njohuri dhe aftësi, përveç të tjerave, në çështje ekonomike, biznesi, administrative, ligjore dhe specifike. Me vendosjen e një kuadri ligjor dhe rregullator, duhet të ketë kapital njerëzor të disponueshëm që ndërmarrjet të kenë mundësi të kenë sukses në atë kuadër. Perfshirja e trajnimit mbi biznesin dhe sipërmarrjen në sistemet kombëtare arsimore është një pjesë integrale për të garantuar që ndërmarrjet të kenë kapitalin njerëzor të nevojshëm që të mbijetojnë dhe të lulëzojnë.**
- ***Edukimi mbi sipërmarrjen.*** Shumë vende, në etapa të ndryshme të zhvillimit ekonomik, e kanë njohur rëndësinë e edukimit rreth sipërmarrjes dhe kanë ngritur programe kombëtare për këtë qëllim. Aktualisht po shfaqet prirja për proces shtese edukimi për sipërmarrjen nepermjet lëndëve me zgjedhje, diku dhe lëndë të detyrueshme.
- ***Zhvillimi i aftësive profesionale.*** Bizneset e mesme shpesh përmendin “mungesën e krahut të kualifikuar të punës” si vështirësinë kryesore drejt aksesit, sesa “aksesin në financa”. Shumë NVM nuk kanë burime për trajnim dhe arsimim profesional, prandaj shumë vende janë aktive në nxitjen e aftësive profesionale mes të rinjve. Një shembull i një programi të tillë është Programi Kombëtar i Trajnimit në Shqipëri. Objektivi i programit është të zhvillojë kulturën për sipërmarrjen, të përmirësojë kapacitetet e ofruesve të mbështetjes për biznesin, dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve ekzistuese. Programi konsiston në module bazë dhe të përparuara të biznesit, module sektoriale/klasterave/specifike dhe në konsultim.

Barrierat për financimin e NVM-ve

- **Për t'u rritur, NVM-të kanë nevojë për kapital. Atyre u duhet të marrin me qira mjedise, të blejnë pajisje dhe të punësojnë punëtorë. Barrierat kryesore për NVM-të në marrjen e financimeve janë:**
- **- Bankat po i perceptojne aktualisht investimet si shume te rrezikshme apo me kosto të lartë kohe për shumën e vogël të huasë;**
- **- Interesat e larta dhe kolaterali i larte qe kerkojne bankat;**
- **- Mungesa e “biografise” apo e planeve te biznesit;**
- **- Perceptimi kur drejtimi eshte profesional;**
- **- Perqendrimi gjeografik i bankave ne qytetet e mëdha, redukton aksesin e NVM-ve në rajonet periferike.**
- **Për shkak se NVM-të kanë vështirësi për të fituar akses në linjat tradicionale të kreditimit, qeveritë dhe organizatat donatore kanë ndihmuar në zhvillimin e mekanizmave alternative të financimit të NVM-ve.**

Mekanizmat alternative të financimit

- ***Programet e mikrofinancave.*** Industria e mikrofinancave është relativisht e re, krahasuar me sistemin bankar tradicional – në fakt është më pak se 20 vjeçare. Megjithatë, mikrofinanca ka vërtetuar se është një prej mjeteve më efikase për të arritur të mikrosipërmarrësit të cilët e kanë të pamundur aksesin në kreditë e bankave. Institucionet e mikrofinancave përfshijnë fonde shtetërore për zhvillimin e NVM-ve, organizata të mikrofinancës me financim të donatorëve, si dhe kooperativa të kreditimit. Institucionet e mikrofinancave kanë zhvilluar huadhënien robuste dhe teknikat vëzhguese, si dhe kanë raportuar për nivele të larta pagimi të huave nga ana e mikroklientëve. Programet e mikrofinancave janë instrumente efikase për gjenerimin e zhvillimit ekonomik dhe zbutjen e pavarësisë. Financimi mikro dhe rural mbështet zhvillimin e qëndrueshëm dhe të orientuar drejt tregut duke punuar me atë pjesë të popullsisë që tradicionalisht është jashtë rrezes së ekonomisë së tregut. Duke vënë theksin te të varfrit dhe me zgjerimin e mundësive nëpërmjet kredive dhe mbështetjes për bizneset, këto programe gjallërojnë njerëzit duke i ndihmuar që të rrisin të ardhurat. Rritja e numrit të vendeve të punës krijon akses më të gjerë në mjetet e jetesës.
- Institucionet e mikrofinancave shpesh kërkojnë mbështetje fillestare nga qeveria dhe donatorët (përveç kooperativave të kreditit) për të siguruar portofolin fillestar të huave, trajnimin e stafit, blerjen dhe përmirësimin e softuerëve për zyrat e financave dhe menaxhimit, harduer, kasaforta, orendi dhe trajnim. Megjithatë, në planin afatgjatë, institucionet e mikrofinancave duhet të jenë të shëndetshme nga ana operative dhe tregtare, në mënyrë që shërbimet financiare që u jepen subjekteve të pafarovizuara të jenë afatgjata, duke rezultuar në rritje substanciale dhe të qëndrueshme në volumin dhe rangun e shërbimeve financiare për mikrondërmarrjet. Për të arritur këtë, duhet të merren masat e mëposhtme:
 - - Ngritja e nje kuadri ligjor per institucionet e financave në mënyrë që të jenë të afta të kryejnë operacionet e marrjes së depozitave dhe të huadhënies.
 - - Zgjidhje problemesh per kolateralin si pranimi i formave më fleksibël të kolateralit, sidomos për NVM-të me asete të fiksuara të pakta, ose përdorimin e garancive në grup;
 - - Theks me i madh i duhet kushtuar fluksit te parase, sesa bilanceve në vlerësimin e kapaciteteve huamarrëse;
 - - Metodologji efektive dhe transparente per vlerësimin e aplikimeve për hua.

- **Banka të specializuara për mikrokreditë.** Në 15 vitet e fundit, organizatat e mëdha ndërkombëtare financiare dhe zhvilluese kanë vendosur një numër bankash të specializuara për mikro-kredi në shumë vende në tranzicion. Ato po ashtu krijojnë mjaft presion konkurrues mbi bankat e mëdha që të ulin pragun minimal në treg, të zgjerojnë operacionet me pakicë dhe t'u ofrojnë produkte të pranueshme bizneseve mikro dhe të vogla.
- **Skemat e garancisë së huave.** Garancitë janë një prej instrumenteve për t'u dhënë kredi bizneseve të vogla, prona e të cilave është e pamjaftueshme për të shërbyer si kolateral në bankë. Garancitë mund të jepen nga qeveria, shoqatat e biznesit dhe/ose bankat private. Ato mbulojnë 50% deri në 90% të shumës së kredisë, me komision garancie që varion nga 1% në 5%. Garancitë që i lëshohen bankës mund të jenë në formën e një letre garancie, letrave me vlerë dhe/ose depozitave bankare. Garancitë shtetërore zakonisht menaxhohen nga një fond garancie apo fond NVM-sh.
- Paratë që emigrantët dërgojnë në shtëpi - remitancat – përbëjnë një burim të rëndësishëm të ardhurash jo vetëm për familjet e emigrantëve, por edhe për vendin e emigrantëve: për vendet në zhvillim remitancat janë të dytat për IHD-në si burim financash të jashtme, dhe për pesë vitet e fundit remitancat kanë tejkaluar ndjeshëm përmasat e flukseve ndërkombëtare të ndihmës. Remitancat mund të përdoren për konsum, por edhe për investimeve si ndërtimi i shtëpive dhe hapja e bizneseve.
- **Zyra e garancive për NVM-të operon në BE që në vitin 1998. Ky institucion u jep garanci bankave që të mbulojnë huatë për NVM-të dhe garanci shitesë për skemat kombëtare dhe rajonale për garancitë. Në fund të vitit 2003, ky institucion nënshkroi kontrata me 48 ndërmjetës financiarë, me një shumë totale prej 208 milioën eurosh. Në fund të 2003-shit, numri kumulativ i NVM-ve që përfituan nga kjo zyrë ishte 166 279, kundrejt 127812 të vitit paraardhës. Përfituesit përfundimtarë me jo më shumë se 10 punëtorë, përbënin 93% të numrit total të NVM-ve; numri total i përfituesve përfundimtarë me më pak se 50 punëtorë preventive 97% të numrit total të NVM-ve11.**

- ***Inkubatorët e biznesit.*** Inkubator biznesi përkufizohet një organizatë që krijon kushte të favorshme për kompanitë e reja. Inkubatori ndihmon bizneset që të fitojnë akses te huadhënësit dhe investuesit, pajisjet e zyrës, shërbimet konsulente dhe programet e trajnimit. Koncepti i inkubatorit të biznesit është zhvilluar në 30 vitet e fundit. “Brezi i parë” i inkubatorëve të biznesit (vitet 1980) ofronin hapësira me çmim të arsyeshëm dhe ambiente të përbashkëta për një grup sipërmarrësish të përzgjedhur me shumë kujdes. Në vitet 1990, inkubatorët shtuan në shërbimet e tyre edhe konsulencën, rritjen e aftësive profesionale dhe shërbimet e rrjetit për sipërmarrësit brenda mjediseve dhe filialet e tyre jashtë. Ato, po ashtu, japin informacione për partnerët e biznesit, për klimën e biznesit në rajon dhe për legjislacionin, tatimet, rregullat e financave dhe raportimin; ndihmojnë në përgatitjen e kontratave dhe dokumentacionit, japin mbështetje ligjore në negociata dhe regjistrim, si dhe organizojnë kurse dhe seminare se si të drejtohet biznesi.
- ***Qendrat e novacionit.*** Novacioni është një faktor përcaktues në konkurrueshmërinë e firmave si në sektorët e teknologjisë së avancuar që po njohin rritje të shpejtë, ashtu edhe në sektorët më tradicionalë. Aftësia e shumicës së bizneseve për të mbijetuar, për t’u rritur dhe për të gjeneruar punë të reja cilësore, varet gjithnjë e më shumë nga kapacitetet e tyre që të vënë novacionin në qendër të strategjisë së tyre të biznesit.
- Nga ana tjetër, firmat e vogla novatore luajnë një rol jetik në nxitjen e potencialit rritës duke siguruar vitalitetin e sistemeve rajonale dhe kombëtare të novacionit. Ciklit mesatar novator i duhen pesë deri në shtate vite përpara se të prodhojë një produkt të tregtueshëm. Edhe ndërmarrjet me kapital të përbashkët dhe me risk të lartë, nuk do të mbështesnin etapat fillestare të novacionit. Qeveritë mund të mbështesin fillimin e novacioneve dhe të përfshijnë partnerët privatë në etapën e komercializimit të teknologjisë.

Aksesi në tregje dhe zhvillimi i klasterave

- Një mundësi e re për të shfrytëzuar benefitet potenciale të tregtisë globale përbën edhe integrimi i NVM-ve në zinxhirin ndërkombëtar të prodhimit në etapa të ndryshme të vlerës së shtuar, nëpërmjet vendosjes së hallkave lidhëse me firma më të mëdha dhe filiale të huaja. Për NVM-të, këto hallka përfaqësojnë një mënyrë për të aksesuar në burime të munguara, më të rëndësishmet nga të cilat janë tregjet ndërkombëtare, financat, teknologjia, aftësitë menaxhuese dhe njohuritë. NVM-të mund të komplementojnë firmat e mëdha në zinxhirët e vlerës, duke shfrytëzuar avantazhet e fleksibilitetit dhe kostove më të ulëta të transaksioneve, për shkak të kontaktit më të afërt me konsumatorët dhe vendimarrjes më të shpejtë, ndërkohë që ndërmarrjet e mëdha shfrytëzojnë avantazhet e madhësisë.
- Konkurrueshmëria në këtë kuptim do të thotë të kesh përzierjen e duhur të firmave të mëdha dhe të vogla si dhe ndarjen e përshtatshme të punës, që kombinon ekonominë e shkallëzuar me fleksibilitetin dhe avantazhet e specializimit.
- **Klasterat e NVM-ve.** Një tjetër praktikë e mirë është inkurajimi i lidhjeve ndërmjet NVM-ve dhe ndërmarrjeve shumëkombëshe. Në këtë ndëryprim mes tyre, shpesh rezultati është zhvillimi i rrjeteve furnizuese vendëse, klasterat dhe përhapja e teknologjisë. Qeveritë mund të lehtësojnë lidhjet duke dhënë informacion të përgjithshëm për bizneset që “puqen”.
- **Inkurajimi i Lidhjeve ndërmjet Kompanive të Vogla dhe të Mesme dhe Ndërmarrjeve Shumëkombëshe** është një deshmë konkrete se qasja e klasterave të NVM-ve mund të rrisë zhvillimin rajonal nëpërmjet efikasitetit kolektive. Rrjeti në klastera ofron një mënyrë të rëndësishme për NVM-të individuale që njëkohësisht të adresojnë problemet e tyre dhe të përmirësojnë pozitën konkurruese. Sipas rezultatit, nismat për klastera deshmohet se rrjeti ka më shumë mundësi për sukses kur ndërmarrjet operojnë në afërsi me njëra-tjetrën dhe bashkojnë interesat e biznesit si për shembull tregjet për produktet, kërkesat e infrastrukturës apo nevojën për të sfiduar konkurrencën që vjen nga jashtë. Brenda grupeve të tilla, ose klasterave, nismat e përbashkëta të ndërmarrjeve janë më të fuqishme për shkak të numrit të palëve të interesuara, janë më efektive në kosto për shkak të kostove fikse të ndara mes tyre, dhe janë më të lehta për t’u koordinuar, ngaqë afërsia nxit familjaritetin dhe besimin e ndërsjellë
- **Atributet kryesore të krahinave industriale apo të klasterave, janë si më poshtë: afërsia gjeografike e NVM-ve; specializimi sektorial; mbizoterimi i firmave të vogla dhe të mesme dhe mbështetja e tyre qeveritare qendrore apo vendore; bashkëpunimi i ngushtë midis firmave dhe konkurrenca për inovacion; etj.**
- **Qendrat e shërbimeve konkrete.** Në nxitjen e rajoneve industriale italiane, elementët që kanë tërhequr mjaft vëmendje, janë “shërbimet konkrete” që u ofrojnë bizneseve shërbime mbështetëse të cilat janë tepër specifike për traditën industriale të zonës. Mbi 130 qendra shërbimesh të vërteta u evidentuan në 56 krahina industriale. Këto qendra ofrojnë një mori shërbimesh, disa prej të cilave janë: garanci kredie, sigurim për eksportet, organizim panairësh tregtare, informacion për tregjet dhe cmimet, konsulence e trajnim, menaxhim të mbetjeve dhe kontroll të ndotjeve, certifikim cikesor dhe dhenie markash tregtare, testim prodhimi apo blerje me shumicë, mbështetje për inovacion, etj. Këto qendra zotërohen publikisht nga shoqata të prodhuesve, pushteti vendor ose agjenci për mbështetjen e NVM-ve, apo nga një kombinim i të gjithë këtyre në partneritet.

Disa rekomandime

Duke ditur rëndësinë e NVM-ve në krijimin e vendeve të punës, zbutjen e pavarësisë, rritjes ekonomike dhe novacionit, qeveritë duhet të marrin përgjegjësi për stimulimin e zhvillimit të NVM-ve. Masat e mëposhtme u rekomandohen qeverive që kërkojnë të zhvillojnë një mjedis ligjor, rregullator dhe administrativ “miqësor për NVM-të”:

- ***Në fushën e politikave dhe programeve të NVM-ve:*** me synim mbeshtetjen dhe ndihmen e NVM-ve, por pa shtrembëruar strukturat e tregut apo krijuar barriera ndaj konkurrencës, si dhe vlersimi i programeve për efikasitet dhe efikasitet, rritja e aftësisë së NVM-ve që të konkurrojnë për prokurime shtetërore; akses të shpejtë në konsulencë dhe informacion; dhe përmirësimi i lidhjeve me NVM-ve të tjera dhe firma të mëdha për të inkurajuar lindjen dhe zhvillimin e klasterave novatorë.
- ***Në fushën e legjislacionit të biznesit:*** ngritja e nje sistemi tatimor te thjeshte, transparent dhe me kosto te uleta, duke i kushtuar vëmendje tatimit të reduktuar apo të thjeshtuar për mikrondërmarrjet, thjeshtim i sistemit regjistruar, perfshire dhe regjistrimin me internet; koordinimin e kriterëve per licencimin e bizneseve, etj.
- ***Në fushën e shërbimeve financiare:*** rregullimin e sektorit financiar (bankar, sigurimeve, qiradhenies) dhe futjen e instrumenteve të përshtatshme ligjore dhe rregulluese për t’u mundësuar NVM-ve që të përdorin asetet si kolateral;
- ***Në fushën e kulturës së biznesit, arsimit dhe trajnimit:*** zhvillimit te kultures se siper marrjes, rritjen e imazhit pozitiv të sipërmarrjes; dhe perfshirjen e tyre ne organizime rajonale apo nderkombetare.

Zhvillimi ekonomik i qëndrueshem dhe mbrojtja e mjedisit

- Qeveritë duhet të ndjekin qasje afatgjata për zhvillimin ekonomik, dhe nuk duhet t'i kthejnë shpinën së ardhmes për hir të benefiteve afatshkurtra. Filozofia e zhvillimit të qëndrueshëm synon që të përmbushë nevojat e së tashmes, pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm të bëjnë të njëjtën gjë. Midis të tjerash, kjo do të thotë **mbrojtje e mjedisit fizik ndaj ndotjes**, shpyllëzimit dhe shkretimit, dhe ndaj humbjes së diversitetit biologjik. Në planin afatgjatë, zbatimi i dobët i rregullave për mbrojtjen e mjedisit e bën një vend më pak tërheqës si destinacion investimi. Rregullimet mjedisore duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të zbatohen pa diskriminim ndërmjet ndërmarrjeve në çfarëdo fushe. Vendet me rezerva të mëdha natyrore duhet të kërkojnë transparencë dhe dhënie llogarie nga industritë nxjerrëse dhe agjencitë që i rregullojnë. Pa shtrënguar kompanitë, qeveritë mund të bëjnë hapa pozitivë për nxitjen e përgjegjësisë sociale, duke inkurajuar fi rmat që të angazhohen për të operuar në një mënyrë që i tejkalon në sensin e mirë standardet etike, ligjore, tregtare dhe publike që pret shoqëria prej tyre. Qeveritë, gjithashtu, mund të përmirësojnë sjelljet e njerëzve duke punuar me fi rmat për zhvillimin e kodeve jodetyruese të sjelljes industriale, që kërkojnë respekt me bazë të gjerë.
- ***Zhvillimi i qëndrueshëm***
- Nje problem me vete eshte qëndrueshmërinë e investimeve që tërheqin dhe zhvillimin ekonomik që pason. Ndërkohë që qeveritë duhet të kufizojnë rolin e tyre si aktorë apo menaxherë të aktivitetit të biznesit, ato prapëseprapë duhet të monitorojnë aktivitetin e biznesit, për të garantuar që shoqëria dhe mjedisi janë të mbrojtur. Tre elementët e mëposhtëm citohen shpesh si tri shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm:
 - **Rritja ekonomike**
 - **Mbrojtja e mjedisit**
 - **Zhvillimi social**

Mbrojtja e mjedisit

- **Ashtu si me klimën e biznesit**, janë vendet më të pasura dhe më konkurruese si vendet nordike, që kanë politika të cilat quhen politika të shëndosha mjedisore. Qeveritë duhet të mendohen dy herë përpara se të ulin standardet e ligjshme apo të bëjnë kompromis në zbatimin e tyre në mënyrë që të tërheqin IHD. Ndërkohë që ulja e standardeve mjedisore mund të joshë disa industri ndotëse që të largohen nga ekonomitë me rregulla të rrepta mjedisore, kjo është një praktikë që në mënyrë të pashmangshme kërcënon qëndrueshmërinë kombëtare në planin afatgjatë. Sidomos në rastin e ekonomive të bazuara në bujqësi, ndotja urbane në shkallë të gjerë ka pasoja shkatërrimtare në ekosistemin e agrorajoneve rrethuese, pa përmendur shëndetin e popullsisë në përgjithësi. Në zonat bregdetare, impiantet e pamjaftueshme për trajtimin e mbetjeve industriale mund të dëmtojnë seriozisht industrinë vendëse të peshkimit. Edhe industria e turizmit varet nga mbrojtja mjedisore. Është e vështirë të gjendet ekuilibri ideal ndërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe progresit ekonomik dhe teknologjik. Megjithatë, kërkesa që vlerësimi i riskut për mjedisin të bazohet në shkencë, është një praktikë e shëndetshme që do të mbrojë mjedisin, pa cenuar zhvillimin ekonomik. Por qeveritë duhet gjithashtu, të shmangin rregullimet dhe ndërhyrjet detyruese që janë në raport tejet të zhdrejtë me riskun e perceptuar të një aktiviteti. Rregullimet mjedisore duhet të aplikohen pa diskriminim për të gjitha ndërmarrjet që merren me të njëjtin tip aktiviteti. Nëse standarde të rrepta mjedisore aplikohen jo vetëm për një grup të caktuar aktorësh – kompanitë e huaja, për shembull – ato standarde minojnë të gjithë strukturën e mbrojtjes mjedisore, mbysin zhvillimin ekonomik dhe krijojnë gjasa për stimulimin e korrupsionit dhe favorizimit. Aplikimi universal nga ana tjetër, promovon fushë loje të barabartë mbi të cilën konkurrenca – themeli i ekonomisë së tregut – mund të lulëzojë.
- **Mbrojtja dhe qëndrueshmëria mjedisore sjellin mundësi për investimet.** Vendet mund të tërheqin projekte industriale të teknologjisë së lartë që reduktojnë karbonin nëpërmjet mekanizmave tregtare ndërkombëtare për shkarkimet. Vendet që kanë ratifikuar Protokollin e Kiotos gëzojnë të drejtën që të ata të zbatohen projekte të Mekanizmave për Zhvillimin e Pastër.
- **Degradimi i mjedisit, rrallimi i burimeve, shpërndarja e pabarabartë e burimeve natyrore apo bollëkut të burimeve, po shfaqen si fitila potencialë apo faktorë përshpejtues të tensioneve brenda dhe midis vendeve.** Dëmtimi i mjedisit dhe mungesa e burimeve janë dy elementë në një rrjetë të ndërlikuar fatkeqësish në të cilën ndërthuren një gamë e gjerë problemesh socialekonomike. Degradimi i mjedisit dhe rrallimi i burimeve natyrore janë njëkohësisht shkaqet dhe pasojat e këtyre problemeve social-ekonomike ose intensifikohen prej tyre.

Zhvillimi social

- Nëse qeveritë duan të përmirësojnë dhe të forcojnë klimën e biznesit, ata duhet të inkurajojnë – dhe jo thjesht të drejtojnë – bizneset që të njohin përgjegjësitë e tyre sociale. Bashkëpunimi ndërmjet qeverive dhe bizneseve përshpejton zhvillimin social.
- Lideret e bizneseve po behen gjithnjë e më të ndërgjegjshëm për nevojën për përgjegjësi sociale. Kjo është ajo që quhet dhe *përgjegjësi sociale të komunitetit (PSK)*. Cili është përkufizimi i PSK-së? Përgjegjësitë sociale të komunitetit përkufizohen si një lëvizje globale në të cilën kompanitë dhe organizatat integrojnë me dëshirë shqetësime sociale dhe mjedisore në operaciones e tyre të biznesit dhe praktikat raportuese². Disa nga forcat më të fuqishme lëvizëse të PSK-së janë mundësia e forcimit të avantazheve konkurruese, “menaxhimi i reputacionit”, ushtrimi i presionit në grup dhe politikat e konsumatorit, ligji apo frika nga ligji dhe ndryshime në mënyrën si po organizohet globalisht prodhimi dhe marketingu.
- **Parimet e Përgjithshme Globale të Kombeve të Bashkuara**
- **Të drejtat e njeriut**
- Parimi 1: Biznesi duhet të mbështesë dhe të respektojë mbrojtjen e të drejtave njerëzore të shpallura botërisht brenda sferës së tyre të influencës; dhe
- Parimi 2: Sigurohuni që ata të mos jenë pjesëmarrës në abuzimet e të drejtave të njeriut.
- **Puna**
- Parimi 3: Bizneset duhet të respektojnë lirinë e shoqërizimit dhe njohjen efikase të të drejtës për marrëveshje kolektive;
- Parimi 4: Të eliminohen të gjitha format e punës me detyrim apo dhunë;
- Parimi 5: Të dënohet ligjërisht puna e fëmijëve; dhe
- Parimi 6: Të eliminohet diskriminimi në bazë të punësimit apo profesionit.
- **Mjedisi**
- Parimi 7: Bizneset duhet të mbështetin masat parandaluese për sfidat mjedisore;
- Parimi 8: Të merren nisma për nxitjen e rritjes së përgjegjësisë për mjedisin; dhe
- Parimi 9: Të inkurajohet zhvillimi dhe përhapja e teknologjive miqësore ndaj mjedisit.
- **Antikorrupsioni**
- Parimi 10: Bizneset duhet të punojnë kundër korrupsionit të të gjitha formave, përfshi zhvatjen dhe rryshfetin.

PSK dhe sektori publik

- Qeveria apo sektori publik të ofrojë dy kontribute kyçe: (1) rregullime të qarta, standardet minimale që kërkohen nga të gjitha firmat, dhe (2) parashikueshmërinë e ndërhyrjes së qeverisë. Praktikën vullnetare PSK të ndërmarrjeve private nuk janë dhe nuk mund të jetë zëvendësuese efikase për qeverisjen e mirë. Përderisa PSK nga vetë natyra është diçka vullnetare, është thelbësore që qeveritë të mos ushtrojnë presion – dhe të mos perceptohen si ushtruese presioni – për të shtrënguar kompanitë që të ndërmarrin PSK-në. Kjo dëmton klimën e biznesit dhe rrit spektrin e korrupsionit. Mënyra më e mirë që qeveritë të promovojnë PSK-në është krijimi i klimës së favorshme të biznesit. Qeveria që vepron në mënyrë të përgjegjshme jep shembullin e sjelljes së mirë dhe promovon sjelljen e mirë nga ana e kompanive në të gjitha nivelet: ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor. Qeveritë mund të mbështesin më mirë dhe të forcojnë klimën e biznesit jo duke bërë të detyrueshëm apo duke menaxhuar aktivitetin PSK, por duke inkurajuar një mjedis ku kompanitë zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme dhe veprojnë me përgjegjshmëri. Qeveritë mund t'u ofrojnë incentiva kompanive në industri me energji intensive për të diversifikuar rezervat e energjisë dhe të ndërmarrin masa për efikasitetin e energjisë që do të ketë implikime financiare pozitive dhe do të ulë “gjurmën ekologjike”.
- **PSK: rasti i studimit.** Rasti i biznesit për PSK-në po bëhet gjithnjë e më i dukshëm “sepse të bësh mirë dhe të të ecë mirë, janë dy gjëra gjithnjë e më të nevojshme dhe reciprokisht përforcuese”. Koncepti i konkurrueshmërisë së përgjegjshme ku bizneset shpërblehen sistematikisht për më tepër praktika të përgjegjshme dhe ndëshkojnë për të kundërtën, po bëhet normë. Shumë studime tregojnë se mënyra se si një kompani menaxhon çështjet sociale dhe të mjedisit, është shpesh një tregues i mirë i nivelit të përgjithshëm të rrezikut dhe cilësisë menaxhuese ; të dy janë faktorë përcaktues në suksesin afatgjatë të kompanisë. **BE-ja promovon sipërmarrjen e përgjegjshme dhe PSK midis bizneseve të mëdha dhe NVM-ve në veçanti.** Për NVM-të mund t'ia vlejë që të ndjekin PSK-në: ato mund të japin mundësi të reja biznesi, rrisin sensin e kënaqësisë dhe besnikërinë e konsumatorit, zhvillojnë stafe më të motivuara, përmirësojnë marrëdhëniet me komunitetin vendor dhe autoritetet publike, kursejnë kostot dhe konsolidojnë reputacionin e kompanisë.

Perfundime

- Zhvillimi i qëndrueshëm është i pamundur pa një klimë të fuqishme biznesi dhe investimesh. Duhet të ketë një kuadër të përshtatshëm për rregullimin dhe qeverisjen në mënyrë që firmat të mbijetojnë dhe të veprojnë me përgjegjshmëri. Rregullimi mjedisor është një fushë ku qeveria duhet të sigurojë rregullim të balancuar që të mbrojë interesat kombëtare si edhe qëndrueshmërinë e ndërmarrjeve. Me vendosjen e një kuadri të përshtatshëm, qeveritë mund të nxisin qëndrueshmërinë afatgjatë të klimës së biznesit duke inkurajuar – dhe jo me detyrim apo presion – ndërmarrjet që të veprojnë me përgjegjshmëri. Përgjegjësia sociale e komunitetit është vendim që i takon ndërmarrjes. Firmat e përfshira në aktivitete PSK priren të jenë më fitimprurëse. Praktikrat më të mira në këtë fushë përfshijnë edhe miratimin e kodeve të sjelljes në industri si dhe inkurajimin e punonjësve që të marrin pjesë në punë vullnetare.